Akte, publikimi i të cilave është i domosdoshëm

# Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 Tetor 2000 Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave

Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian,

Duke patur parasysh Marrëveshjen për krijimin e Komunitetit Evropian, dhe në veçanti nenin 175(1) nga ku,

Duke patur parasysh propozimin e Komisionit175[1],

Duke patur parasysh mendimin e Komisionit Ekonomik dhe Social[2],

Duke patur parasysh mendimin e Komisionit të Rajoneve[3]

Duke vepruar në përputhje me procedurat e vendosura nga neni 251 i Marrëveshjes[4], dhe në dritën e tekstit të përbashkët të miratuar nga Komisioni i Rregullimit më 28 korrik 2000,

Duke patur parasysh që:

(1) Uji nuk është një produkt tregtar si gjithë të tjerët, por në të vërtetë është një trashëgimi e cila duhet të ruhet, mbrohet dhe trajtohet si e tillë.

(2) Përfundimet e Seminarit Ministror të Komunitetit të Politikave të Ujërave në Frankfurt në vitin 1998, theksojnë nevojën për një legjislacion të Komunitetit që të merret me cilësinë ekologjike. Këshilli në rezolutën e tij të datës 28 Qershor 1998[5] i kërkon Komisionit të dorëzojë propozime për të përmirësuar cilësinë ekologjike të ujërave sipërfaqësorë të Komunitetit Evropian.

(3) Deklarata e Seminarit Ministror për ujërat nëntokësorë, e zhvilluar në Hagë në vitin 1991,vuri në dukje nevojën për të ndërmarrë veprime për të parandaluar një përkeqësim afatgjatë të cilësisë dhe sasisë së ujërave të ëmbla dhe kërkoi zbatimin e një programi veprimesh në vitin 2000 duke patur si qëllim menaxhimin dhe mbrojtjen e qëndrueshme të burimeve të ujit të pijshëm. Në rezolutën e datës 25 Shkurt 1992[6], dhe atë të datës 20 Shkurt 1995[7], Këshilli kërkoi një program veprimi për ujërat nëntokësorë2 dhe një rishikim të Direktivës së Këshillit 80/68/EEC të datës 17 dhjetor 1979 për mbrojtjen e ujërave nëntokësorë nga ndotja e shkaktuar prej një seri substancash[8] të rrezikshme, si pjesë e një politike të përgjithshme për mbrojten e ujërave të ëmbla.

(4) Ujërat në Komunitetin Evropian janë nën një trysni në rritje si rezultat i rritjes së vazhdueshme të kërkesës për sasi të mjaftueshme uji të një cilësie të mirë për të gjitha qëllimet. Më 10 Nëntor 1995, Agjencia Evropiane e Mjedisit në raportin "Mjedisi në Bashkimin Evropian - 1995" paraqiti një panoramë të përditësuar të raportit për mjedisin ku theksohej nevoja për ndërmarrjen e veprimeve për të mbrojtur

[1] OJ C 184, 17.6.1997, fq.20,
OJ C 16, 20.1.1998, fq.14 dhe
OJ C 108, 7.4.1998, fq. 94
[2] OJ C 355, 21.11.1997, fq. 83
[3] OJ C 180, 11.6.1998, fq. 38
[4] Mendim i Parlamentit Evropian i datës 11 Shkurt 1999 (OJ C 150, 28.5.1999, fq. 419), e konfirmuar më 16 Shtator 1999, dhe Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit i datës 22 Tetor 1999 (OJ C 343, 30.11.1999, fq.1). Vendim i Parlamentit Evropian i datës 7 Shtator 2000 dhe Vendim i Këshillit i datës 14 Shtator 2000

5

[6] OJ C 59, 6.3.1992, fq.2
[7] OJ C49, 28.2.1995, fq.1
[8] OJ L 20, 26.1.1980, fq. 43. Direktiva siç është amenduar nga Direktiva 91/692/EEC (OJ L, 377, 31.12.1991, fq.48)

ujërat e Komunitetit si përsa i përket sasisë, ashtu edhe cilësisë së tyre.

(5) Më 18 dhjetor 1995, Këshilli miratoi përfundimet ku kërkohej përveç të tjerave edhe hartimi i një Direktive të re ***kuadër*** e cila do të vendoste parimet bazë për një politikë të qëndrueshme të ujërave në Bashkimin Evropian duke e ftuar Komisionin të hartonte një propozim.

(6) Më 21 shkurt 1996 Komisioni miratoi një komunikatë drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit për politikën e ujërave të Bashkimit Evropian duke vendosur kështu parimet për një politikë të Komunitetit Evropian për ujërat.

(7) Më 9 shtator 1996 Komisioni paraqiti një propozim për një Vendim të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi një program veprimi për mbrojtje dhe menaxhim të integruar të ujërave nëntokësorë[1]. Në atë propozim Komisioni vinte theksin në nevojën të përcaktoheshin procedura për rregullimin e shfrytëzimit dhe monitorimin cilësor dhe sasior të ujërave të ëmbla.

(8) Më 29 maj 1995 Komisioni miratoi një komunikatë drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit për përdorimin e kujdesshëm dhe konservimin e kënetave, nëpërmjet së cilës vihej në dukje roli i rëndësishëm që ato luajnë për mbrojtjen e burimeve ujore.

(9) Është e nevojshme të zhvillohet një politikë e integruar e Komunitetit Evropian për ujin.

(10) Këshilli më 25 qershor 1996, Komisioni i Rajoneve më 19 shtator 1996, Komisioni Ekonomik dhe Social më 26 shtator 1996 dhe Parlamenti Evropian më 23 tetor 1996, të gjithë i kërkuan Komisonit të paraqiste një propozim për një Direktivë të Këshillit, e cila të përcaktonte kuadrin e nevojshëm për politikën evropiane të ujit.

(11) Ashtu sikurse përcaktohet në nenin 147 të Traktatit, politika komunitare për mjedisn duhet të kontribuojë në përmbushjen e objektivave për ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, në përdorimin me kujdes dhe me racionalizëm të burimeve natyrore si dhe dhe të bazohet në parimin parandalues dhe në parimet që veprime parandaluese që duhet të ndërmerren, dëmtimi i mjedisit si një përparësi duhet të korrigjohet që në burimin e tij dhe ndotësi duhet të paguajë.

(12) Në bazë të nenit 174 të Traktatit, në përgatitjen e politikës së tij për mjedisin, Komuniteti Evropian duhet të marrë parasysh edhe të dhënat teknike dhe shkencore të disponueshme, kushtet mjedisore në rajone të ndryshme të Komunitetit, zhvillimin ekonomik dhe social të Komunitetit si një i tërë dhe zhvillimin e baraspeshuar të rajoneve të tij si dhe përfitimet dhe kostot e mundshme të veprimeve ose mungesën e veprimeve.

(13) Kushtet dhe nevojat e Komunitetit janë të ndryshme dhe kërkojnë zgjidhje të ndryshme. Kjo shumëllojshmëri duhet të merret parasysh në planifikimin dhe zbatimin e masave për të siguruar mbrojtje dhe qëndrueshmëri në përdorimin e ujit në kuadër të baseneve (pellgjeve) ujore të lumenjve. Vendimet duhet të merren sa më pranë vendeve, ku uji përdoret dhe është ndotur. I duhet dhënë përparësi veprimit brenda përgjegjësisë së shteteve anëtare përmes hartimit të programeve të masave, të rregulluara sipas kushteve rajonale dhe vendore.

(14) Suksesi i kësaj Direktive mbështetet në një bashkëpunim të ngushtë dhe veprime koherente në nivel komuniteti,shtetesh anëtare dhe nivel lokal si dhe në informacionin, këshillimin dhe përfshirjen e publikut duke përfshirë edhe përdoruesit.

(15) Furnizimi me ujë është një shërbim me interes të përgjithshëm, ashtu sikurse është përcaktuar në komunikatën e Komisionit për shërbimet e interesit të përgjithshëm në Evropë[2].

(16) Integrimi i mëtejshëm i mbrojtjes dhe i menaxhimit të qëndrueshëm të ujit në fusha të tjera të politikës komunitare si atë të energjisë, transportit, bujqësisë, peshkimit, politikës rajonale dhe turizmit është i nevojshëm. Kjo Direktivë duhet të japë një ndihmesë të rëndësishme në fusha të tjera të bashkëpunimit midis shteteve anëtare, ndër

[1] OJ C 355, 25.11.1996, fq.1

[2] OJC281, 26.9.1996, fq. 3

të tjera edhe në Perspektivën Evropiane të Zhvillimit Hapësinor ( PEZHH - ESDP).

(17) Një politikë efektive dhe koherente e ujërave duhet të marrë parasysh dobësinë e ekosistemeve ujore që ndodhen pranë bregut dhe grykëderdhjeve ose në gjire apo dete relativisht të mbyllura, pasi baraspesha e tyre ndikohet fuqishëm nga cilësia e ujrave tokësore që derdhen në to. Mbrojtja e statusit të ujit brenda baseneve ujëmbledhës të lumenjve do të sjellë përfitime ekonomike duke kontribuar në një mbrojtje të popullatave të peshqve ku përfshihen edhe popullatat e peshqve të vijës bregdetare.

(18) Politika Komunitare e ujit kërkon një kuadër ligjor transparent, efektiv dhe koherent. Kjo Direktivë duhet të sigurojë një kuadër të tillë dhe të koordinojë, integrojë, dhe në një përspektivë më afatgjatë, të zhvillojë më tej parimet dhe strukturat e përgjithshme për mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të ujit në komunitet, në përputhje me parimet e subsidiaritetit.

(19) Kjo Direktivë synon ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor në komunitet. Ky qëllim ka të bëjë pikësëpari me cilësinë e ujërave për të cilat bëhet fjalë. Kontrolli i sasisë është një element ndihmës për të siguruar cilësi të mirë uji dhe si rrjedhim duhet të merren masat e nevojshme për sasinë, që t’u shërbejnë objektivave për sigurimin e një cilësie sa më të mirë.

(20) Situata sasiore e një zone ujore nëntokësore mund të ndikojë në cilësinë ekologjike të ujërave sipërfaqësorë dhe të ekosistemeve tokësore të lidhura me atë zonë ujërash nëntokësorë.

(21) Komuniteti dhe shtetet anëtare janë palë në marrëveshje të ndryshme që përmbajnë detyrime të rëndësishme për ruajtjen e ujërave detare nga ndotja, në veçanti Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Zonës së Detit Balltik, e firmosur në Helsinki më 9 prill 1992 dhe e miratuar me Vendimin e Këshillit 94/157/EC[1], Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Atlantikut Veri-Lindor, firmosur në Paris më 22 shtator 1992 dhe miratuar me Vendimin e Këshillit 98/249/EC[2] dhe Konventa për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja, e firmosur në Barcelonë më 16 Shkurt 1976 dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit 77/585/EEC[3], dhe Protokolli i tij për Mbrojtjen e Detit Mesdhe prej Ndotjes me Burim Kontinental, firmosur në Athinë më 17 Maj 1980 dhe miratuar me Vendim të Këshillit 83/101/EEC[4]. Kjo Direktivë ka për qëllim të kontribuojë në dhënien e mundësive komunitetit dhe shteteve anëtare për të përmbushur ato detyrime.

(22) Kjo Direktivë ka për qëllim të kontribuojë në zvogëlimin progresiv të derdhjeve të substancave të rrezikshme në ujë.

(23) Parime të përbashkëta nevojiten me qëllim që të koordinohen përpjekjet e shteteve anëtare për përmirësimin e mbrojtjes së ujërave komunitare përsa i përket sasisë dhe cilësisë, për promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të ujit, të kontribuojnë për kontrollin e problemeve të ujërave ndërkufitarë, mbrojtjen e ekosistemeve ujore, ekositemeve tokësore dhe kënetave që drejtpërdrejt varen nga ato, si dhe të ruajë dhe zhvillojë përdorimet e mundshme të ujërave komunitare.

(24) Cilësia e mirë e ujit do të kontribuojë në sigurimin e nevojave për ujë të pijshëm të popullsisë.

(25) Përkufizime të përbashkëta të gjendjes së ujit përsa i përket cilësisë dhe aty ku është e nevojshme për qëllime të mbrojtjes së mjedisit, sasia duhet të sigurohet. Duhet të vendosen objektiva mjedisore për të siguruar një gjendje të mirë të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në të gjithë Komunitetin Evropian dhe që përkeqësimi i gjendjes së ujërave duhet të parandalohet në nivel komunitar.

(26) Shtetet anëtare duhet të synojnë të arrijnë objektivat e të paktën një gjendje të mirë të ujit dhe të zbatojnë masat e nevojshme brenda programit të integruar të masave, duke marrë parasysh kërkesat ekzistuese të komunitetit. Aty ku gjendja e mirë e ujit ekziston, ajo duhet të vazhdojë të ruhet e

[1] OJ C 73, 16.3.1994, fq.19

[2] OJ L 104, 3.4.1998, fq.1

[3] OJ L 240, 19.9.1977, fq.1

[4] OJ L 67, 12.3.1983, fq. 1

tillë. Për ujërat nëntokësorë, përveç kërkesës për një gjendje të mirë, çfarëdo lloj prirje e rëndësishme apo e qëndrueshme në rritje në lidhje me përqëndrimin e ndonjë ndotjeje duhet të identifikohet dhe të veprohet menjëherë për normalizimin e situatës.

(27) Qëllimi final i kësaj Direktive është arritja e zhdukjes të substancave parësore të rrezikshme dhe të kontribuojë për arritjen e niveleve të pranueshmë të përqëndrimit në mjedisin detar në nivelin e vlerave bazë për substancat të cilat natyrshëm ndodhen në mjediset e ndotura nga veprimi human.

(28) Ujërat siperfaqësorë dhe ata nëntokësorë janë në parim burime natyrore të rinovueshme. Në veçanti, detyra e sigurimit të gjendjes së mirë të ujërave nëntokësorë kërkon veprime të hershme dhe planifikim të qëndrueshëm afatgjatë të masave mbrojtëse, falë intervalit kohor natyral në formimin dhe rinovimin e tyre. Një interval kohor i tillë për përmirësim duhet të merret parasysh në afatet kohore të masave për arritjen e nivelit të pranueshëm të ujërave nëntokësorë dhe vlerësimi i çfarëdolloj prirjeje të rëndësishme apo të qëndrueshme në rritje, në lidhje me përqëndrimin e një ndotësi në ujërat nëntokësorë.

(29) Duke synuar të arrijnë objektivat e vëna në këtë Direktivë dhe për të përcaktuar një program me masa për këtë qëllim, Shtetet Anëtare duhet të ndajnë në faza zbatimin e programit të masave me qëllim që të shpërndajnë edhe kostot e zbatimit.

(30) Me qëllim që të sigurojnë një zbatim të plotë dhe të qëndrueshëm të kësaj Direktive, çdo shtyrje afati duhet të bëhet në bazë të kritereve transparente, të duhura, të qarta dhe duhet të justifikohen nga shtetet anëtare në planet e menaxhimit të baseneve ujëmbledhës.

(31) Në rastet kur një zonë uji është shumë e prekur nga aktiviteti i njeriut ose kur kushtet e saj natyrale që mund të kërkojnë shpenzime të paparashikueshme dhe paarsyeshme për të arritur një gjendje të mirë, objektiva mjedisore më pak shtrënguese duhet të vihen mbi bazën e kritereve të duhura dhe transparente, të gjitha hapat praktike duhet të ndermerren për të parandaluar një përkeqësim të mëtejshëm të siutatës së ujërave.

(32) Mund të bëhen për përjashtime nga kërkesat për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm dhe për të arritur gjendjen normale në kushte specifike, nëse dështimi është përfundim i rrethanave të veçanta ose të paparashikuara, kryesisht përmbytjet dhe thatësirat, ose për arsye të interesave madhore të publikut, të modifikimeve të reja të karakteristikave fizike të sipërfaqes së një zone uji sipërfaqësor ose ndryshimit të nivelit të zonave të ujërave nëntokësorë.Është kusht që të gjitha hapat praktike të jenë ndërmarrë për të zvogëluar efektin e kundërt për gjendjen e zonës së ujit.

(33) Objektiva e përfitimit të një niveli optimal uji duhet të ndiqet për çdo basen ujëmbledhës, kështu që masat për ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë që i përkasin të njëjtit sistem ekologjik, hidrologjik dhe hidrogjeologjik të mund të koordinohen.

(34) Për mbrojtjen e mjedisit lind nevoja për një integrim më të madh të aspekteve sasiore dhe cilësore si të ujërave sipërfaqësore ashtu dhe atyre nëntokësorë, duke marrë parasysh kushtet e rrjedhjes natyrale të ujit brenda ciklit hidrologjik.

(35) Brenda një baseni ujëmbledhës ku përdorimi i ujit mund të ketë efekte ndërkufitare, kërkesat për arritjen e objektivave mjedisore të përcaktuara nga kjo Direktivë, dhe në veçanti të gjitha programet e masave, duhet të koordinohen për të gjithë rajonin e basenit ujëmbledhës. Për basenet ujëmbledhës që shkojnë përtej kufijve të Komunitetit Evropian, shtetet anëtare duhet të përpiqen të sigurojnë koordinimin e nevojshëm me shtetet joanëtare. Kjo Direktivë duhet të kontribojë në zbatimin e detyrimeve të komunitetit që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare për mbrojtjen dhe menaxhimin, kryesisht Konventa e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen dhe përdorimin e rrjedhjeve ndërkufitare të ujërave dhe liqeneve ndërkombëtare, miratuar me Vendim të Këshillit 95/308/EC[1] dhe çfarëdolloj marrëveshje të suksesshme për zbatimin e saj.

---
[1] OJ L 186,5.8.1995, fq. 42

(36) Është e rëndësishme të ndërmerren analiza të karakteristikave të një baseni ujëmbledhës dhe efektet e aktivitetit të njeriut si dhe analiza ekonomike për përdorimin e ujit. Zhvillimi, përsa i përket situatës së ujit, duhet të monitorohet nga shtetet anëtare, në baza sistematike dhe krahasuese në të gjithë Komunitetin Evropian. Ky informacion është i nevojshëm me qëllim që të sigurojë një bazë të saktë për shtetet anëtare, me qëllim që këto të zhvillojnë programe për marrjen e masave që synojnë arritjen e objektivave të përcaktuara nga kjo direktivë.

(37) Shtetet anëtare duhet të identifikojnë ujërat e përdorura për përfititmin e ujit të pijshëm dhe të sigurojnë përputhshmëri me Direktivën e Këshillit 80/778.EEC të datës 15 korrik 1980 në lidhje me cilësinë e ujit të caktuar për konsumim njerëzor[1].

(38) Përdorimi i instrumenteve ekonomike nga shtetet anëtare mund të jetë i përshtatshëm si pjesë e një programi masash. Parimi i kthimit të kostove të shërbimeve të ujit, ku përfshihen edhe kostot mjedisore dhe ato të burimeve që janë të lidhura me dëmtimin ose ndikimin negativ në mjedisin ujor, duhet të merren parasysh veçanërisht bazuar në parimin "ai që ndot, paguan". Një analizë ekonomike e shërbimeve të ujit, e bazuar në parashikime afatgjata të ofertës dhe kërkesës për ujin në rajonin e basenit ujëmbledhës, do të jetë e nevojshme për këtë qëllim.

(39) Ndjehet nevoja për të parandaluar ose zvogëluar ndikimin e incidenteve në të cilat uji mund të ndotet aksidentalisht. Masat që duhet të merren për këtë qëllim duhet të përfshihen në programin e masave.

(40) Përsa i përket parandalimit dhe kontrollit të ndotjes, politika për ujërat komunitarë duhet të bazohet në një trajtim të kombinuar duke mbajtur nën kontroll ndotjen që në burim, nëpërmjet përcaktimit të vlerave kufitare të shkarkimit dhe standarteve të cilësisë mjedisore.

(41) Në lidhje me sasinë e ujit, duhet të përcaktohen parime të përgjithshme të kontrollit për marrjen dhe grumbullimin, me qëllim që të sigurohet një qëndrueshmëri mjedisore e sistemeve ujore të prekura.

(42) Standardet e përbashkëta mjedisore të cilësisë dhe vlerat kufitare të shkarkimit për grupe apo familje të veçanta të ndotësve duhet të përcaktohen si kërkesa minimale në legjislacionin e Komunitetit Evropian. Duhet të sigurohen dispozitat për miratimin e standardeve të tilla në nivel komuniteti.

(43) Ndotja, si rezultat i shkarkimit, lëshimit ose humbjeve të substancave të rrezikshme parësore duhet të ndalet ose të mënjanohet gradualisht. Parlamenti Evropian dhe Këshilli duhet që, me propozim të Komisionit, të bien dakord mbi substancat që duhet të konsiderohen për veprim si prioritet dhe mbi masat specifike që duhet të merren kundër ndotjes së ujërave nga këto substanca, duke marrë parasysh të gjitha burimet kryesore dhe duke identifikuar nivelin e leverdisshëm dhe të ***përpjesshëm*** si dhe kombinimin e kontrolleve.

(44) Në identifikimin e substancave parësore të rrezikshme duhen llogaritur parimet parandaluese, duke u bazuar në veçanti në përcaktimin e efekteve të mundshme të pafavorshme të produktit si dhe në vlerësimin shkencor të rrezikut.

(45) Shtetet anëtare duhet të miratojnë masa për të shmangur ndotjen e ujërave sipërfaqësore nga substancat kryesore dhe në mënyrë progresive të pakësojë ndotjen nga substancat, çka do të privonte gjithashtu shtetet anëtare nga arritja e objektivave për zonën e ujërave sipërfaqësorë.

(46) Për të siguruar pjesëmarrjen e publikut të gjerë, përfshi këtu edhe përdoruesit e ujit në hartimin dhe përditësimin e planeve menaxhuese të baseneve ujëmbledhës, është e domosdoshme të sigurohet informacioni i përshtatshëm i masave të planifikuara dhe të raportohet për progresin e bërë për zbatimin e tyre me synim përfshirjen e një publiku të gjerë, para se të merren vendimet përfundimtare për masat e nevojshme.

(47) Direktiva duhet të sigurojë mekanizmat që do të trajtojnë pengesat për të ecur përpara në përmirësimin e gjendjes së ujërave kur këto janë jashtë fushës së legjislacionit komunitar për ujërat, me qëllim zhvillimin e

[1] OJ L 229,k 30.8.1980, fq.11. Direktiva siç është amenduar nga Direktiva 98/83/EC (OJ L 330, 5.12.1998, fq. 32).

e strategjive të përshtatshme të Komunitetit Evropian për t'i kapërcyer ato.

(48) Komisioni duhet të paraqesë çdo vit një plan të përditësuar të nismave të cilat ai synon të propozojë në sektorin e ujërave.

(49) Specifikimet teknike duhet të përcaktohen për të siguruar një trajtim koherent në komunitet si pjesë e kësaj Direktive. Kriteret për vlerësimin e gjendjes së ujit janë një hap i rëndësishëm përpara. Përshtatja e elementëve të caktuar teknikë me zhvillimin teknik dhe standardizimi i monitorimit, kampionizimit dhe metodave të analizave duhet të miratohet nëpërmjet procedurave të komisionit. Për të promovuar një kuptim sa më të thellë dhe aplikim të qëndrueshëm të kritereve për karakterizimin e rajoneve të basenit ujëmbledhës dhe vlerësimit të gjendjes së ujit, Komisioni mund të miratojë udhëzime për aplikimin e këtyre kritereve.

(50) Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj Direktive duhet të miratohen në përputhje me Vendimin e Këshillit 1999/468/EC të datës 28 qershor 1999, i cili përcakton procedurat për ushtrimin e të drejtës së zbatueshmërisë të akorduar Komisionit[1].

(51) Zbatimi i kësaj direktive duhet të synojë arritjen e një niveli mbrojtjeje të ujërave të paktën të njëvlerëshme me atë që përcaktohet në akte të tjera të mëpërparshme, të cilat duhet si rrjedhim të zëvendësohen menjëherë sapo dispozitat përkatëse të kësaj direktive të zbatohen plotësisht.

(52) Dispozitat e kësaj Direktive marrin përsipër kuadrin për kontrollin e ndotjes nga substanca të rrezikshme, siç përcaktohet nga Direktiva 76/464/EEC[2]. Ajo Direktivë duhet si rrjedhim të zëvendësohet menjëherë, sapo dispozitat përkatëse të kësaj Direktive të zbatohen plotësisht.

(53) Duhet të sigurohet që legjislacioni ekzistues mbi mjedisin për mbrojtjen e ujërave të jetë plotësisht i zbatueshëm dhe shtrëngues. Është e nevojshme të sigurohet gjithashtu aplikimi i duhur i të gjitha dispozitave me zbatimin e kësaj Direktive në të gjithë komunitetin nëpërmjet gjobave përkatëse të përcaktuara në legjislacionin e shteteve anëtare.Këto gjoba duhet të jenë efikase, të përpjestueshme dhe të kenë aftësi parandaluese,

KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

## Neni 1

## Qëllimi

Qëllimi i kësaj Direktive është ngritja e një kuadri ligjor për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësorë të brendshëm, ujërave të përkohshëm, ujërave bregdetarë dhe ujërave nëntokësorë dhe e cila:

(a) Parandalon përkeqësimin e mëtejshëm, ruan dhe forcon gjendjen e sistemeve ujore, në lidhje me nevojën e tyre për ujë, ekosistemet tokësore dhe kënetat drejtpërdrejt të varura nga ekosistemet ujore;

(b) Promovon përdorimin e vazhdueshëm të ujit, bazuar në mbrojtjen afatgjatë të burimeve ujore të disponueshme;

(c) Ka për qëllim forcimin e mbrojtjes dhe përmirësimin e mjedisit ujor, përveç të tjerash nëpërmjet masave specifike për një reduktim progresiv të shkarkimeve, derdhjes dhe humbjeve të substancave parësore dhe ndalimin ose menjanimin e ngadaltë të shkarkimeve, lëshimeve dhe humbjeve të substancave të rrezikshme parësore;

(d) Siguron një reduktim progresiv të ndotjes së ujërave nëntokësorë dhe parandalon ndotjen e mëtejshme të tyre, si dhe

(e) Kontribuon në zvogëlimin e pasojave të përmbytjeve dhe të thatësirave, ndaj kontribuon në:

– Sigurimin e sasisë së mjaftueshme të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë të një cilësie të mirë, ashtu siç nevojitet për një përdorim të qëndrueshëm, të baraspeshuar dhe të barabartë të ujit,
– Një reduktim të qenësishëm të ndotjes së ujërave nëntokësorë

---
[1] OJ C 184, 17.7.1999, fq. 23
[2] OJ L 129, 18.5.1976, fq.23. Direktiva siç është amenduar nga Direktiva 91/692/EEC (OJL 377, 31.12.1999, fq.48).

- Mbrojtjen e ujrave territoriale dhe detare, si dhe
- Në arritjen e objektivave të marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare, ku përfshihen edhe ato që synojnë parandalimin dhe zhdukjen e ndotjes së mjedisit detar, nëpërmjet ndërhyrjes së Komunitetit Evropian bazuar në Nenin 16 (3) për të ndaluar ose mënjanuar gradualisht shkarkimet, derdhjet dhe humbjet e substancave parësore të rrezikshme, me qëllimin përfundimtar të arritjes së përqëndrimeve në mjedisin detar afër normavebazë për substancat me origjine natryrore dhe çuarjen në zero të substancave sintetike të prodhuara nga njeriu.

**Neni 2**

**Përkufizimet**

Për qëllimet e kesaj direktive duhet te aplikohen përkufizimet e mëposhtme:

1.'Ujëra sipërfaqësorë' janë ujëra të brëndshme, përveç ujit nëntokësor; ujëra të përkohshme dhe uëjra bregdetare, me përjashtim të statusit kimik për të cilin ai duhet të përfshijë gjithashtu ujërat territoriale.

2. 'Ujëra nëntokësorë' do të thotë i gjithë uji i cili është nën sipërfaqen e tokës në zonën ujëmbajtëse dhe në kontakt të drehtpërdrejtë me tokën ose tabanin.

3. 'Ujëra të brendshme' do të thotë te gjitha ujërat e ndenjura ose ujërat e rrjedhshme mbi sipërfaqen e një terreni, dhe gjithë ujrat nëntokësore në drejtim të themelit të tokes mbi të cilën është matur gjerësia territoriale e tyre.

4. 'Lumë' do të thotë një masë e ujërave të brëndshme rrjedhëse, në pjesën më të madhe mbi sipërfaqen e truallit, por mund të rrjedhë dhe në pjesën nëntokësore të shtresës së tij.

5. 'Liqen' do të thotë një masë e ujërave sipërfaqësore të brendshme të ndenjura.

6. 'Ujëra të përkohshme' janë masat e sipërfaqes ujore në rrethinat e grykëderdhjeve të cilat janë pjesërisht të kripura natyrshëm, si rrjedhojë e afërsisë së tyre me ujërat bregdetare, por të cilat janë ndikuar kryesisht nga rrjedhjet e ujërave të ëmbla.

7. 'Ujëra bregdetare' do të thotë sipërfaqe ujore mbi vijën bregdetare të tokës, çdo pikë e së cilës ndodhet një milje detare larg prej vijës bregdetare nga pika më e afërt e vijës bazë, nga e cila është matur gjërësia e ujërave territoriale, duke u shtrirë në mënyrë të përshtatshme deri në kufirin e jashtëm të ujërave të përkohshme.

8. 'Masë ujore artificiale' do të thotë një masë uji sipërfaqësor e krijuar nga një aktivitet njerëzor.

9. 'Masë ujore tejet e modifikueshme' do të thotë një masë uji sipërfaqësor e cila si rezultat i ndryshimeve fizike prej aktiviteteve njerëzore ka ndryshuar në mënyre thelbësore në përmbajtje, siç është projektuar nga shtetet anëtare, në përputhje me dispozitat e Shtojcës II.

10. 'Masë uji sipërfaqësor' do të thotë një element i veçantë dhe i rëndësishëm i ujit sipërfaqesor të tillë si një liqen, rezervuar, një rrymë, lumë ose kanal, pjesë të një rryme, lumë ose kanal, ujë i përkohshëm ose një shtrirje e ujërave bregdetare.

11. 'Horizont ujor' do të thotë një shtresë nënsipërfaqësore, shtresa të një shkëmbi ose shtresa të tjera gjeologjike të një poroziteti të mjaftueshëm dhe një depërtueshmërie për të lejuar një rrjedhje të konsiderueshme të ujërave nëntokësore ose shkëputjen e sasive të konsiderueshme të tyre.

12. 'Masë e ujërave nëntokësore' do të thotë një vëllim i qartë i ujërave nëntokësore brenda një horizonti ujëmbajtës ose horizonteve ujëmbajtëse.

13. 'Pellg ujor' do të thotë sipërfaqja e tokës nga e cila e gjithë sipërfaqja derdhëse rrjedh përmes një sekuence të rrymave, lumenjve dhe, mundësisht, liqeneve për në det sipas një grykderdhje të vetme, grykderdhje të gjerë ose ***delte***.

14. 'Nënpellg' do të thotë sipërfaqja e tokës nga e cila gjithë ajo derdhëse rrjedh përmes një serie rrymash, lumenjsh dhe, mundësisht liqenesh tek një pikë e veçantë në një shtresë uji(normalisht një liqen ose një bashkërrjedhje lumore).

15. 'Rajon baseni ujëmbledhës' do të thotë zona e tokës dhe deti, krijuar prej një ose më shumë basene ujëmbledhës të lumenjve fqinjë së bashku me ujërat mbledhës nëntokësorë dhe ujërat

bregdetarë, i cili është identifikuar sipas nenit 3(1) si njësia kryesore për menaxhimin e baseneve ujëmbledhës.

16. 'Autoriteti kompetent' do të thotë një autoritet ose autoritetet e identifikuara sipas nenit 3(2) ose 3(3).

17. 'Gjendja e ujërave sipërfaqësore' është një shprehje e përgjithshme e gjendjes së një mase të ujërave sipërfaqësore, përcaktuar me anë të gjendjes së tij më të varfër ekologjike dhe kimike.

18. 'Gjendje optimale e ujërave sipërfaqësore ' do të thotë gjendje optimale e arritur në një mase ujore sipërfaqesore kur të dyja, si gjendja ekologjike dhe kimike janë të paktën 'mirë'

19. ' Gjendja e ujërave nëntokësorë' është një shprehje e përgjithshme e gjendjes së një mase të ujrave nëntokësorë, përcaktuar me anë të nivelit minimal sasior dhe statusit kimik.

20. 'Gjendja e mirë e ujërave nëntokësore ' do të thotë gjendje e arritur me anë të një mase ujërash nënujore, kur të dyja, si gjendja e tij ekologjike dhe kimike, janë të paktën 'mirë'.

21. ' Gjendja ekologjike' është një shprehje e cilësisë së një strukture dhee funksionimit të ekosistemit ujor shoqëruar me ujërat sipërfaqësore, klasifikuar në përputhje me Shtojcën V.

22. ' Gjendja ekologjike e mirë' është gjendja e një mase të një sipërfaqe ujore, klasifikuar në përputhje me Shtojcën V.

23. ' Potencial ekologjik i mirë' është gjendja e një mase ujore artificiale ose tejet të modifikuar, klasifikuar të tilla në përputhje me dispozitat përkatese të Shtojcës V.

24. ' Gjendja kimike e mirë e ujërave sipërfaqësore ' do të thotë gjendja kimike e nevojshme për të plotësuar objektivat mjedisore për ujërat sipërfaqësore vendosur në Nenin 4(1)(a), që është gjendja kimike e arritur me anë të një mase uji sipërfaqesor në të cilën përqëndrimi i ndotësve nuk tejkalon standardet e cilesise mjedisore të vendosur në Shtojcën IX dhe Nenin 16(7), dhe sipas legjislacioneve të tjera përkatëse duke vendosur standardet e cilesisë mjedisore në nivel komuniteti.

25. ' Gjendja kimike e mirë e ujërave nëntokësore' është gjendja e një mase të ujërave nëntokësore, e cila plotëson të gjitha kushtet e vendosura në tabelën 2.3.2 të Shtojcës V.

26. ' Gjendja sasiore' është një shprehje e shkallës në të cilën një masë e ujërave nëntokësore është e ndikuar nga shkëputjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta.

27. ' Burime të vlefshme ujore' do të thotë që norma mesatare vjetore afatgjatë e rimbushjes së plotë të një mase të ujërave nëntokësore është më pak se norma vjetore afatgjatë e rrjedhjes së kërkuar për të arritur objektivat ekologjike të cilësisë për ujrat e sipërfaqeve mbledhëse specifikuar në Nenin 4, për të shmangur ndonjë pakësim të konsiderueshëm në gjendjen ekologjike të ujërave të tilla dhe për të shmangur ndonjë dëmtim të konsiderueshëm të ekosistemeve tokësore të bashkuara.

28. 'Gjendje e mirë sasiore' është gjendja e përkufizuar në tabelën 2.1.2 të Shtojcës V.

29. ' Substanca të rrezikshme' do të quhen substancat ose grupet e substancave që janë toksike, të përhershme dhe të rrezikshme të bio-akumulueshme, dhe substanca të tjera ose grup substancash të cilat rrisin shqetësimin deri në një nivel të barasvlefshëm.

30. ' Substanca prioritare' do të thotë substanca të identifikuara në përputhje me Nenin 16(2) dhe të renditura në Shtojcën X. Midis këtyre substancave gjenden ' substancat e rrezikshme parësore' e cila do të thotë substancat e identifikuara në përputhje me Nenin 16(3) dhe (6) për të cilën masat duhet të merren në përputhje me Nenin 16(1) dhe (8).

31. ' Ndotës' quhet çdo substancë e rrezikshme që shkakton ndotje, të renditura në veçanti në Shtojcën VIII.

32. ' Shkarkim direkt tek ujërat nëntokësore' do të thotë shkarkim i ndotësve në drejtim të uëjrave nëntokësore pa filtrim, nëpërmjet dheut dhe nënshtresave.

33. ' Ndotje' do të thotë futje drejtpërdrejt ose tërthoras, si rezultat i nje aktiviteti njerëzor, i substancave ose nxehtësisë në ajër, ujë ose tokë e cila mund të jetë e dëmshme për shëndetin njerëzor ose cilësinë e ekosistemeve ujore ose ekosistemeve tokësore që varen direkt nga

sistemet ujore, të cilat rezultojnë në dëmtimin e pasurisë materiale, ose të cilët përkeqësojnë ose pengojnë me mjete dhe të tjerë që ligjërojnë shfrytëzimin e mjedisit.

34. ' Objektiva mjedisore' do të thotë objektivat e vedosura në Nenin 4.

35. ' Standarde të cilësisë mjedisore' do të thotë përqëndrimi i ndotësve të veçantë ose i grupit të ndotësve në ujë, sedimente ose biota e cila nuk duhet të tejkalohet me qëllim që të mbrojmë shëndetin njerëzor dhe mjedisin.

36. ' Trajtim i kombinuar' do të thotë kontroll i shkarkimeve dhe i derdhjeve në ujërat sipërfaqësore, sipas trajtimit të vendosur në Nenin 10.

37. ' Ujë i caktuar për konsum njerëzor' ka të njëjtin kuptim si në Direktivën 80/778/EEC, siç është ndrequr me Direktivën 98/83/EC.

38. 'Shërbimet e ujit' do të thotë të gjitha shërbimet të cilat sigurojnë për ekonominë shtëpiake, institucionet publike ose ndonjë aktivitet ekonomik:

(a) shkëputje, mbledhje, grumbullim, trajtim dhe shpërndarje të sipërfaqes ujore dhe ujërave nëntokësore,

(b) mjetet e trajtimit dhe grumbullimi i ujërave të zeza që rrjedhimisht shkarkohen në ujerat sipërfaqësore.

39. ' Përdorimi i ujit' do të thotë shërbimet e ujit së bashku me ndonjë aktivitet tjetër identifikuar sipas Nenit 5 dhe Shtojcës II duke pasur një impakt të rëndësishëm mbi statusin e ujit.

40. ' Vlefta kufitare e shkarkimit' do të thotë masa, e shprehur në termat e parametrave specifikë të sigurtë, përqëndrimi dhe/ose niveli i shkarkimit, i cili mund të mos tejkalohet gjatë një ose më shumë periudhave kohore. Vlefta kufitare e shkarkimit mund të përgatitet gjithashtu për një grup të caktuar, familje ose kategori substancash, dhe në veçanti për ato të identifikuara në Nenin 16.

Vlerat e lejueshme të shkarkimit të substancave duhet të zbatohen normalisht deri në çastin kur kryhet shkarkesa, duke e bërë tretësirën të papërfillshme me vendosjen e tyre. Në lidhje me shkarkimet jo të drejtpërdrejta në ujë, impianti i trajtimit të ujërave të zeza mund të merret në konsideratë kur përcaktohen vlerat e lejueshme të shkarkimit të instalimeve të përfshira, duke siguruar që është garantuar një nivel ekuivalent për mbrojtjen e ambjentit si një e tërë dhe duke siguruar që kjo nuk shpie në nivele të larta të ndotjes së ambientit.

41. ' Kontrollet e shkarkimit' janë kontrollet që kërkojnë një kufi specifik të shkarkimit, për shembull një vleftë kufi të shkarkimit, ose ndryshe specifikimin e kufijve ose kushteve për efektet, natyrën ose karakteristika të tjera të një ***emisioni*** ose kushtet vepruese të cilat ndikojnë shkarkimet. Përdorimi i termit 'shkarkim' në këtë Direktivë sipas dispozitave të ndonjë Direktive tjetër nuk duhet të kuptohet si një riinterpretim të dispozitave të tyre në ndonjë formë.

**Neni 3n**
**Koordinimi i masave administrative brenda rajoneve të baseneve ujëmbledhës**

1. Shtetet anëtare duhet të identifikojnë shtrirjen e veçantë të baseneve ujëmbledhës brenda territorit kombëtar të një vendi dhe, për qëllimet e kësaj Direktive, t'i përcaktojnë ato sipas rajoneve të veçanta të baseneve ujëmbledhës. Basenet ujëmbledhës mund të kombinohen me basene ujëmbledhës të mëdhenj ose të lidhen me basene ujëmbledhës të vogla fqinje për të krijuar basebe ujëmbledhës të veçanta aty ku është e përshtatshme. Aty ku ujërat nëntokësore nuk ndjekin plotësisht një basen ujëmbledhës të veçantë, ato duhet të identifikohen dhe transferohen për tek rajoni më i afërt dhe i përshtatshëm i basenit ujëmbledhës. Ujërat bregdetare duhet të identifikohen dhe transferohen për tek rajoni ose rajonet ujore më të afërta ose të përshtatshme të lumit.

2. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë masat e përshtatshme, duke përfshirë identifikimin e Autoritetit Kompetent të përshtatshëm, për zbatimin e rregullave të kësaj Direktive brenda çdo rajoni të basenit ujëmbledhës, të shtrirë brenda territorit të tyre.

3. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që një basen ujëmbledhës që mbulon territorin e më shumë se një prej shteteve anëtare të përcaktohet sipas rajonit ndërkombëtar të basenit ujëmbledhës. Me kërkese të shteteve anëtare pjesëmarrëse, Komisioni duhet të veprojë për të lehtësuar përcaktimin e rajoneve të tilla ndërkombëtare të baseneve ujëmbledhës.

Çdo shtet anëtar duhet të sigurojë masa të përshtatshme administrative, duke përfshirë identifikimin e përshtatshëm të autoritetit kompetent, për zbatimin e rregullave të kësaj Direktive brenda pjesës së rajonit ndërkombëtar të basenit ujëmbledhës që shtrihet brenda territorit të këtij vendi.

4. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që kërkesat e kësaj Direktive për arritjen e objektivave mjedisore të vendosura sipas Nenit 4, dhe në veçanti të gjithë programet e masave janë të koordinuara për të gjithë rajonin e basenit ujëmbledhës. Për rajonet ndërkombëtare të baseneve ujëmbledhës shtetet anëtare të interesuara duhet të sigurojnë së bashku këte koordinim dhe munden për këtë qëllim, të përdorin strukturat ekzistuese që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare. Me kërkesë të ahteteve anëtare pjesëmarrëse, Komisioni duhet të veprojë për të ndihmuar hartimin e programeve të masave.

5. Aty ku rajoni i basenit ujëmbledhës kalon kufijtë përtej territorit të komunitetit, shtetet anëtare ose shtetet anëtare të interesuara duhet të përpiqen për të krijuar koordinimin e përshtatshëm me shtetet joanëtare përkatëse, për arritjen e objektivave të kësaj Direktive në të gjitha anët e rajonit të basenit ujëmbledhës lumor .Shtetet anëtare duhet të sigurojnë zbatimin e rregullave të kësaj Direktive brenda territorit të tyre.

6. Shtetet anëtare mund të identifikojnë një organ ekzistues kombëtar dhe ndërkombëtar si një autoritet kompetent për zbatimet e kësaj Direktive.

7. Shtetet anëtare duhet të identifikojnë autoritetin kompetent sipas datës së përmendur në Nenin 24.

8. Shtetet anëtare duhet të pajisin Komisionin me një listë të autoriteteve të tyre kompetente dhe të autoriteteve kompetente e të gjitha organizmave ndërkombëtare ku ata marrin pjesë në gjashtë muajt e fundit pas datës së përmendur në Nenin 24. Për çdo autoritet kompetent do të sigurohet informacioni i paraqitur në Shtojcën I.

9. Shtetet anëtare duhet të informojnë Komisionin për ndonjë ndryshim të informacionit, të siguruar sipas paragrafit 8 brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ndryshimeve.

**Neni 4**

**Objektivat mjedisore**

1. Për kryerjen sa më vepruese të programeve të masave të specifikuara në planet e menaxhimit të baseneve ujëmbledhës lumorë:

(a) për ujërat sipërfaqësore

(i) Shtetet anëtare duhet të zbatojnë masat e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e gjëndjes të gjithë shtretërve të sipërfaqeve ujore, subjekt i aplikimit të paragrafëve 6 dhe 7 dhe pa paragjykimin e paragrafit 8.

(ii) Shtetet anëtare duhet të mbrojnë, rrisin dhe restaurojnë të gjithë shtretërit e sipërfaqeve lumore, subjekt i zbatimit të nënparagrafit 8

(iii) Për shtretërit ujorë artificialë dhe tejet të modifikuar, me qëllim arritjen e një statusi të mirë të sipërfaqes ujore në 15 vjetët e fundit pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Shtojcën V, subjekt i zbatimit të shtesave të përcaktuara në përputhje me paragrafin 4 dhe të zbatimit të paragrafeve 5,6 dhe 7 pa paragjykimin e paragrafit 8;

(iv) Shtetet anëtare duhet të zbatojnë masat e nevojshme në përputhje me Nenin 16 (1) dhe (8), me qëllim zvogëlimin progresiv të ndotjes nga substancat prioritare dhe ndërprerjen ose mënjanimin e shkarkimeve, lëshimeve dhe humbjeve të substancave të rrezikshme prioritare pa paragjykimin e marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare, mbështetur Nenit 1 për palët e interesuara.

(b) për ujërat nëntokësore

(i) Shtetet anëtare duhet të zbatojnë masat e nevojshme për të parandaluar ose kufizuar inputet e ndotësve në ujërat nëntokësore dhe të parandalojnë prishjen e gjendjes së shtretërve të gjithë ujërave nëntokësore, subjekt i zbatimit të paragrafëve 6 dhe 7 dhe pa paragjykimin e paragrafit 8 të këtij Neni dhe subjekt të zbatimit të Nenit 11(3)(j);

(ii) Shtetet anëtare duhet të mbrojnë, përforcojnë dhe restaurojnë të gjithë shtretërit e ujërave nëntokësore, të sigurojnë një baraspeshë midis rrjedhjes dhe rimbushjes së ujërave nëntokësore, me qëllim arritjen e një gjëndje të mirë të ujërave nëntokësore në 15 vjetët e fundit pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Shtojcën V, subjekt i zbatimit të shtesave të përcaktuara në përputhje me paragrafin 4 dhe të zbatimit të paragrafeve 5,6 dhe 7 pa paragjykimin e paragrafit 8 të këtij Neni dhe subjektin e zbatimit të Nenit 11(3)(j);

(iii) Shtetet anëtare duhet të zbatojnë masat e nevojshme për të ndryshuar ndonjë prirje të qëndrueshme në rritje në përqëndrimin e ndonjë ndotësi që vjen nga impakti i aktivitetit njerëzor me qëllim që progresivisht të zvogëlojnë ndotjen e ujërave nëntokësore.

Masa për të arritur drejtime të ndryshme do të zbatohet në përputhje me paragrafet 2, 4 dhe 5 të Nenit 17, duke marrë në konsideratë standardet e zbatueshme të përcaktuara në legjislacionin përkatës të Komunitetit, subjekt i aplikimit të paragrafëve 6 dhe 7 pa paragjykimin e paragrafit 8;

(c) për zonat e mbrojtura

Shtetet anëtare duhet të arrijnë në përputhje me standardet dhe objektivave të 15 viteve të fundit pas hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, nëse nuk është specifikuar ndryshe në legjislacionin e Komunitetit, sipas së cilës janë krijuar zona të veçanta të mbrojtura.

2. Ku më shumë se një prej dy objektivave, sipas paragrafit 1, ka të bëjë më një shtrat ujor të dhënë, masat më shtrënguese duhet të aplikohen.

3. Shtetet anëtare mund të caktojnë një shtrat apo sipërfaqe ujore si artificiale ose tepër të modifikuar kur:

(a) Ndryshimet ne karakteristikat hidromorfologjike të shtratit, të cilat janë të nevojshme për të arritur një gjendje ekologjike të mirë, do të kenë efekte të konsiderueshme të kundërta mbi:

i. Mjedisin e gjerë

ii. Lundrimin, përfshirë pajisjet portuale ose aktivitetet rekreative

iii. Veprimtaritë për arsye të të cilave uji është grumbulluar, si psh. furnizimi me ujë të pijshëm, sistemin energjitik dhe atë të ujitjes

iv. Rregullimin e ujërave, mbrojtjen nga përmbytjet dhe thatësirat e tokës ose aktivitete të tjera zhvillimi, të rëndësishme dhe të qëndrueshme të kryera nga njerëzit;

(b) Objektivat përfituese të ofruara nga karakteristikat artificiale ose të modifikuara të shtratit të ujërave, nuk mund që të arrihen qoftë për arsye të parealizueshmërisë teknike apo të qënit tepër të kushtueshme, dhe që rrjedhimisht mund të arrihen me mjete të tjera, të cilat janë në mënyrë të konsiderueshme zgjidhjet më të mira mjedisore.

Një përcaktim i tillë dhe arsyet për të duhet të përmenden specifikisht në planet e menaxhimit sipas Nenit 13 dhe që rishikohen çdo gjashtë vjet.

4. Afatet e vendosura nga paragrafi 1 mund të shtyhen me qëllim arritjen e objektivave në faza nga organet që merren me ujin, me kusht që të mos ndodhë asnjë përkeqësim i mëtejshëm në gjendjen e shtrateve ujore të prekura kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

(a) Shtetet anëtare vendosin që të gjitha përmirësimet në gjendjen e shtrateve ujore nuk mund të arrihen brenda afatave kohore të vendosura në atë paragraf për të paktën një nga arsyet e mëposhtme:

i. Shkalla e përmirësimeve të nevojshme mund të arrihet në faza që e tejkalojnë afatin kohor për arsye të fizibilitetit teknik

ii. Plotësimi i përmirësimeve brenda afatit kohor do të jetë tepër i shtrenjtë

iii. Kushtet natyrale nuk lejojnë përmirësime kohore në gjendjen e shtratit ujor

(b) Shtyrje e afatit dhe arsyet për të janë të përcaktuara qartë dhe shpjeguar në planin e menaxhimit të basenit ujëmbledhës në Nenin 13.

(c) Shtyrja e afatit duhet të kufizohet deri në maksimumin e përditësimeve të mëtejshme të planeve menaxhuese të baseneve ujëmbledhës, me përjashtim të rasteve kur kushtet natyrore janë të tilla që objektivat nuk mund të arrihen brenda kësaj periudhe kohore.

(d) Një përmbledhje e masave të nevojshme sipas Nenit 11 të cilat janë parashikuar si të domosdoshme për të sjellë shtratet ujore në mënyrë progresive në gjendjen e tyre të kërkuar duke shtyrë afatet kohore, arsyet për çdo vonesë të konsiderueshme për t'i bërë këto masa vepruese, dhe afatin kohor të pritshëm për zbatimin e tyre janë përcaktuar në planin e menaxhimit të baseneve ujëmbledhës. Një rishikim i zbatimit të këtyre masave dhe një përmbledhje e çdo mase të mëtejshme duhet të përfshihet në përditësimet që do t'i bëhen planit të menaxhimit të baseneve ujëmbledhës.

5. Shtetet anëtare mund të synojnë të arrijnë objektiva mjedisore më pak shtrënguese sesa ato të përcaktuara sipas paragrafit 1 për shtrate specifike të ujit, kur këto preken nga aktiviteti i njerëzve sipas përcaktimit në përputhje me Nenin 5(1), ose kur kushtet natyrore të tyre ***<u>tilla</u>*** që e bëjnë arritjen e këtyre objektivave të parealizueshme ose tepër të kushtueshme dhe kur të gjitha kushtet e mëposhtme plotësohen:

(a) Nevojat mjedisore dhe social-ekonomike të servirura nga një aktivitet i tillë njerëzor nuk mund të plotësohen me mënyra të tjera që janë në mënyrë të konsiderueshme zgjidhje më të mira mjedisore dhe nuk paraqesin kosto të parealizueshme;

(b) Shtetet anëtare sigurojnë,

– Për ujërat sipërfaqësore, arritjen e gjendjes më të mirë të mundshme ekologjike dhe kimike, duke patur parasysh se ndikimet duhet të ishin mënjanuar falë natyrës së aktivitetit njerëzor ose ndotjes,

– Për ujërat nëntokësorë, ndryshimet më të vogla të mundshme për një gjendje të mirë të uëjrave nëntokësore, duke patur parasysh se ndikimet duhet të ishin mënjanuar falë natyrës së aktivitetit njerëzor ose ndotjes,

(c) Asnjë përkeqësim i mëtejshëm në gjendjen e shtratit ujor të prekur

(d) Vendosja e objektivave mjedisore më pak shtrënguese dhe arsyet për to janë përmendur kryesisht në planin e menaxhimit të baseneve ujëmbledhës sipas Nenit 13 dhe atyre objektivave, që rishikohen çdo gjashtë vjet.

6. Përkeqësimi i përkohshëm i gjendjes së shtrateve të ujërave nuk mund të bëhet në kundërshtim me kërkesat e kësaj Direktive, nëse kjo është rezultat i rrethanave të kushteve natyrore ose force madhore të cilat janë përjashtime dhe nuk mund të jenë parashikuar më parë, veçanërisht përmbytjet e mëdha ose thatësirat e stërzgjatura, ose rezultat i aksidenteve të cilat nuk mund të jenë parashikuar më parë, dhe kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

(a) Të gjithë hapat praktikë janë ndërmarrë për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes dhe me qëllim që të mos rrezikohet arritja e objektivave të kësaj Direktive në shtrate të tjera ujore që nuk janë prekur nga këto rrethana.

(b) Kushtet nën të cilat rrethanat që janë përjashtuese ose nuk mund të parashikoheshin në mënyrë të logjikshme mund të deklarohen, duke përfshirë dhe miratimin e treguesve të përshtatshëm përfshihen në planin e menaxhimit të basenit të lumit;

(c) Masat që duhet të merren në kushte të tilla përjashtimore përfshihen në programin e masave dhe nuk do të kompromentojnë përmirësimin e cilësisë së masës të ujit pas përfundimit të rrethanave;

(d) Efektet e rrethanave që janë përjashtimore ose që nuk mund të parashikohen, rishikohen çdo

vit dhe janë subjekt i arsyeve që jepen në paragrafin 4 (a), dhe merren të gjitha masat praktike me qëllimin e përmirësimit të masës së ujit në statusin që kishte më parë sesa t'i nënshtrohen efekteve të këtyre rrethanave sa më shpejt të jetë e arsyeshme praktikisht, dhe

(e) Një përmbledhje e efekteve të rrethanave dhe të masave të tilla të marra në përputhje me paragrafin (a) dhe (d) përfshihen në përditësimin e planit të manaxhimit të basenit të lumit.

7. Shtetet anëtare nuk do ta shkelin këtë Direktivë kur:

- pamundësia për të pasur një status të mirë të ujit nëntokësor, një status të mirë ekologjik ose, aty ku është e përshtatshme, një mundësi të mirë ekologjik ose për të parandaluar prishjen e statusit të masës së ujit sipërfaqësor ose nëntokësor ka ardhur si rezultat i modifikimeve të reja që i janë bërë karakteristikave fizike të sipërfaqes së trupit ujor ose ndryshimeve që i janë bërë nivelit të zonave nënujore, ose

- pamundësisë për të shmangur prishjen/degradimin nga një status i lartë në një status të mire(të pranueshëm) të një mase uji sipërfaqësor ka ardhur si rezultat i aktiviteteve të një zhvillimi të ri të qëndrueshëm të njerëzve

dhe, kur të gjitha kushtet e mëposhtme plotësohen:

(a) kur janë marrë të gjitha hapat praktike për të lehtësuar ndikimin negativ mbi statusin e masës të ujit;

(b) arsyet për këto rregullime ose ndryshime janë përcaktuar specifikisht dhe janë shpjeguar në planin e menaxhimit të basenit të lumit që kërkohet sipas Nenit 13, dhe objektivat rishikohen një herë në 6 vjet

(c) arsyet për ato rregullime ose ndryshime janë në përputhje me interesin publik dhe/ose në dobi të mjedisit dhe shoqërisë për të arritur objektivat e parashtruara në paragrafin 1, të cilat nënvlerësohen nga përfitimet e modifikimeve të reja ose ndryshimeve në shëndetin e njerëzve, për ruajtjen e sigurisë së njerëzve ose për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm, dhe

(d) objektivat përfituese të cilave u shërbejnë ato rregullime ose ndryshime të trupit të ujit nuk mund të kryhen nëpërmjet mënyrave të tjera të cilat përfaqësojnë mundësi thelbësisht më të mira mjedisore si përfundim i fizibilitetit teknik ose kostove joproporcionale.

8. Gjatë aplikimit të paragrafëve 3, 4, 5, 6 dhe 7, një Shtet Anëtar duhet të sigurohet që aplikimi nuk përjashton ose cënon në mënyrë të vazhdueshme arritjen e objektivave të Direktivës në trupa të tjerë të ujit brenda të njëjtit rreth të basenit lumor dhe është një përputhje me zbatimin e ligjeve të tjera të Komunitetit për mjedisin.

9. Duhet të ndërmerren hapa për t'u siguruar se zbatimi i dispozitave të reja, duke përfshirë dhe zbatimin e paragrafëve 3, 4, 5, 6 dhe 7, garanton të paktën të njëjtin nivel mbrojtjeje të parashikuar në ligjet ekzistuese të Komunitetit Evropian.

**Neni 5**

**Karakteristikat e rrethit të basenit lumor, rishikimi i ndikimit mjedisor të aktivitetit njerëzor dhe analiza ekonomike e përdorimit të ujit**

1. Çdo vend anëtar duhet të sigurohet se për çdo rreth të basenit ujor ose për përqindjen e një rrethi ndërkombëtar të basenit ujor që është pjesë e territorit të tij

- të bëhen analizat e karakteristikave të tij,
- të bëhet një rishim i ndikimit të aktivitetit të njeriut mbi statusin e ujërave sipërfaqësore ose ujërave tokësore, dhe
- një analizë ekonomike e përdorimit të ujit

në bazë të specifikimeve teknike të parashtruara në Shtojcën II dhe III dhe që ato të jenë bërë gjatë harkut kohor të katër viteve të fundit pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive.

2. Analizat dhe rishikimet e përmendura në paragrafin 1 do të rishikohen dhe, nëse është e nevojshme, do të përditësohen jo më vonë se 13 vjet pas hyrjes së kesaj Direktive në fuqi, dhe çdo gjashtë vjet pas kësaj kohe.

**Neni 6**

**Regjistri i zonave të mbrojtura**

1. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë hapjen e një regjistri ose të regjistrave të të gjitha zonave që shtrihen brenda çdo rrethi të basenit lumor të cilat janë përcaktuar se kërkojnë një mbrojtje të veçantë në legjislacionin përkatës të Komunitetit Evropian për mbrojtjen e sipërfaqes së tyre ujore dhe nënujore ose për ruajtjen e habitatit dhe specieve që varen drejtpërsëdrejti nga uji. Ata duhet të sigurojnë gjithashtu që regjistri të plotësohet jo më vonë se katër vjet nga data e hyrjes në fuqi i kësaj Direktive.

2. Regjistri ose regjistrat do të përfshijnë të gjitha trupat e ujit, të identifikuara në Nenin 7(1) dhe të gjitha zonat e mbrojtura, të trajtuara nga Shtojca IV.

3. Regjistri ose regjistrat e zonave të mbrojtura duhet të rishikohen dhe të përditësohen për çdo rreth të basenit lumor.

**Neni 7**

**Ujërat e përdorura për nxjerrjen e ujit të pijshëm**

1. Shtetet anëtare duhet të identifikojnë, brenda cdo rrethi të basenit lumor,:

- të gjithë trupat e ujit të përdorur për nxjerrjen e ujit që synohet të përdoret për konsumim njerëzor nga të cilat nxirret mesatarisht më tepër se 10 $m^3$ në ditë, ose që u shërbejnë për konsum më tepër se 50 personave dhe

- ato trupa uji që synohet të përdoren për të njëjtin qëllim në të ardhmen.

Shtetet anëtare do të monitorojnë, që sipas Shtojcës V, nxjerrin mesatarisht më tepër se 100 $m^3$ në ditë.

2. Për secilin trup uji të identifikuar në paragrafin 1, përveç plotësimit të objektivave të Nenit 4, në përputhje me këtë Direktivë, shtetet anëtare, për trupat e ujit sipërfaqësor, duke përfshirë dhe standardet e cilësisë të përcaktuara për nivelin e Komunitetit në Nenin 16, duhet të sigurohen se sipas regjimit të përdorur, dhe në përputhje me ligjet e Komunitetit, uji do të plotësojë kërkesat e Direktivës 80/778/EEC, të përmirësuara nga Direktiva 98/83/EC.

3. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë mbrojtjen e nevojshme për trupat e ujit të identifikuar me qëllim që të mënjanojnë prishjen e cilësisë së tyre në mënyrë që të ulet niveli i trajtimit të purifikimit që kërkohet për prodhimin e ujit të pijshëm. Shtetet anëtare mund të përcaktojnë zonat e ruajtjes për këto trupa uji.

**Neni 8**

**Monitorimi i statusit të ujit sipërfaqësor, statusi i ujit nëntokësor dhe zonat e mbrojtura**

1. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë hapjen e programeve për monitorimin e statusit të ujit në mënyrë që të përcaktohet një rishikim koherent dhe i kuptueshëm i statusit të ujit, brenda secilit rreth të basenit ujor:

- Për ujërat sipërfaqësore programe të tilla duhet të mbulojnë:

(i) volumin dhe nivelin, ose shkallën e rrjedhjes që kërkohet për të arritur statusin përkatës ekologjik dhe kimik, potencialin ekologjik, dhe

(ii) statusin ekologjik dhe kimik dhe potencialin ekologjik;

- për ujërat tokësore programet e tilla duhet të mbulojnë monitorimin e statusit kimik dhe sasior,

- për zonat e mbrojtura programet e lartpërmendura do të plotësohen nga specifikimet e dhëna në ligjet e Komunitetit Evropian, sipas të cilave janë përcaktuar zonat e mbrojtura.

2. Këto programe do të vihen në zbatim jo më vonë se 6 vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, në përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në legjislacionin përkatës. Një monitorim i tillë do të jetë në përputhje me kërkesat e Shtojcës V.

3. Specifikimet teknike dhe metodat e standardizuara për analizën dhe monitorimin e statusit të ujit do të parashtrohen në përputhje me procedurën e dhënë në Nenin 21.

**Neni 9**

**Mbulimi i shpenzimeve për shërbimet ujore**

1. Shtetet anëtare duhet të marrin parasysh parimin e mbulimit të shpenzimeve/kostove të shërbimeve të ujit, duke përfshirë dhe kostot mjedisore dhe të burimit, duke pasur parasysh analizën ekonomike të bërë sipas Shtojcës III dhe në përputhje veçanërisht me parimin që ndotësi paguan.

Deri në 2010-ën shtetet anëtare duhet të sigurojnë që:

- politikat e çmimit të ujit të ofrojnë stimuj të përshtatshëm për përdoruesit që ata t'i përdorin burimet ujore në mënyrë efiçente, dhe si rezultat të kontribuojnë për arritjen e objektivave mjedisore të parashtruara në këtë Direktivë,

- një kontribut të përshtatshëm për përdoruesit e ndryshëm të ujit, të ndarë të paktën në kategorinë e përdoruesve të industrisë, të familjeve dhe të bujqësisë për të mbuluar shpenzimet e shërbimeve të ujit, në bazë të analizës ekonomike të bërë sipas Shtojcës III dhe duke marrë parasysh sqarimin "ndotësi paguan".

Duke realizuar këto zëra, shtetet anëtare mund të marrin parasysh efektet shoqërore, mjedisore dhe ekonomike të pagimit si dhe kushtet gjeografike dhe klimaterike të rajonit ose rajoneve të prekura.

2. Shtetet anëtare duhet të përfshijnë në planet e menaxhimit të baseneve të lumenjve hapat e planifikuara për të zbatuar paragrafin 1, i cili do të kontribojë për arritjen e objektivave mjedisore të Direktivës dhe në kontributin e dhënë nga përdorues të ndryshëm të ujit për të paguar shpenzimet, kostot e shërbimeve të ujit.

3. Asgjë në këtë Nen nuk duhet të shmangë financimin e preventivave të veçantë ose të masave ndreqëse/ rikuperuese në mënyrë që të arrihen objektivat e kësaj Direktive.

4. Shtetet anëtare nuk e shkelin këtë Direktivë nëse ata vendosin të mos aplikojnë parashikimet e paragrafit 1, në bazë të praktikave të vendosura, fjalia e dytë, dhe për të njëjtin qëllim parashikimet përkatëse të paragrafit 2 për një aktivitet të caktuar të përdorimit të ujit, kur një gjë e tillë nuk cënon qëllimet dhe arritjen e objektivave të Direktivës. Shtetet anëtare duhet të raportojnë arsyet për të cilat nuk

respektohet plotësisht plotësimi i paragrafit 1, (fjalia e dytë) në planet e menaxhimit të baseneve lumore.

## Neni 10

**Metoda e kombinuar për burimet e përqëndruara dhe të shpëndara**

1. Shtetet anëtare duhet të sigurohen se të gjitha parashikimet e dhëna në paragrafin 2 për ujërat sipërfaqësorë kontrollohen sipas metodës së kombinuar të parashtruar në këtë Nen.

2. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë vendosjen dhe/ose zbatimin e:

   (a) kontrolleve të nxjerrjes të bazuara në teknikat më të mira, ose
   (b) vlerat limite përkatëse të nxjerrjeve, ose
   (c) në rast të ndikimeve të shpërndara, kontrollet duhet të përfshijnë, sipas rastit, praktikat më të mira mjedisore

   të përcaktuara në:

- Direktivën e Këshillit 96/61/EC të 24 shtatorit të vitit 1996 që lidhet me parandalimin dhe kontrollin e ndotjes së integruar ([1]),
- Direktivën e Këshillit 91/271/EEC të 21 majit të vitit 1991 që bën fjalë për trajtimin e mbetjeve ujore ([2])
- Direktivën e Këshillit nr 91/676/EEC të 12 dhjetorit të vitit 1991 që lidhet me mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratet e burimeve bujqësore ([3])
- Direktivat e miratuara në përputhje me Nenin 16 të kësaj Direktive,
- Direktivat e dhëna në listën e Shtojcës IX,
- Çdo parashikimi përkatës të legjislacionit të Komunitetit

Jo më vonë se 12 vjet pas datës së hyrjes në fuqi të Direktivës, në përjashtim të rasteve që parashikohet ndryshe në legjislacionin përkatës.

## Neni 11

**Programi i masave**

1. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë për secilin rreth të basenit lumor, ose për pjesën e një rrethi ndërkombëtar të basenit ujor një program masash, duke marrë parsysh rezultatet e analizave që kërkohen në Nenin 5 në mënyrë që të arrihen objektivat e dhëna në Nenin 4. Programe të tilla masash mund t'u referohen masave që vijnë si rezultat i ligjeve të miratuara në nivelin kombëtar dhe që mbulojnë të gjithë territorin e shtetit anëtar. Kur është e përshtatshme, një Shtet Anëtar mund të miratojë masa që janë të zbatueshme për të gjitha rrethet e basenit lumor dhe/ose për pjesën e rretheve të baseneve ndërkombëtare që janë pjesë e territorit të tij.

2. Secili program masash duhet të përfshijë masat "bazë" të specifikuara në paragrafin 3, dhe aty ku është e nevojshme, dhe masa "shtesë";

3. "Masat bazë" janë kërkesat minimale që duhet të plotësohen dhe duhet të përbëhen nga:

(a) ato masa që kërkohen për të zbatuar legjislacionin e Komunitetit Evropian për mbrojtjen e ujit, duke përfshirë dhe ato të kërkuara në legjislacionin e specifikuar në Nenin 10 dhe në pjesën A të Shtojcës VI;

[1] OJ L 257, 10. 10. 1996, fq. 26
[2] OJ L 135, 10. 05. 1991, fq 40, Direktiva e emanduar nga Direktiva e Komisionit nr 98/15/EC (OJ L 67, 07. 03. 1998, fq 29
[3] OJ L 375, 31. 12. 1991, fq 1.

(b) masat e para si të përshtatshme për qëllimet e Nenit 9;

(c) masat për të nxitur një përdorim efiçent dhe të qëndrueshëm të ujit për të shmangur cënimin e arritjes së objektivave të dhënë më mënyrë specifike në Nenin 4;

(d) Masat për të arritur kërkesat e Nenit 7, duke përfshirë masat për ruajtjen e cilësisë së ujit në mënyrë që të ulet niveli i trajtimit të purifikimit, i cili nevojitet për të prodhimin e ujit të pijshëm;

(e) Kontrollet për nxjerrjen e ujit të freskët sipërfaqësor dhe nëntokësor, dhe marrjen e ujit të freskët sipërfaqësor duke përfshirë dhe një regjistër ose regjistra për nxjerrjen e ujit dhe një kërkesë për një autorizim paraprak për nxjerrjen dhe perpunimin. Kontrollet duhet te ndërmerren në mënyrë periodike dhe, nëse është e nevojshme, të përditshme. Shtetet anëtare presin nga keto kontrolle nxjerrje dhe perpunim, i cili nuk ka impakt ne gjendjen e ujit.

(f) Kontrolle, duke përfshirë një kërkesë për një autorizim paraprak për rifurnizimin artificial ose rritjen e trupave nënujore. Uji i përdorur mund të vijë nga çdo ujë sipërfaqësor ose ujë nëntokësor, për aq kohë sa përdorimi i burimit nuk cënon arritjen e objektivave mjedisore për burimin, trupin e rifurnizuar ose të rritur të ujit nëntokësor, Këto kontrolle do të rishikohen në mënyrë periodike dhe, atëherë kur të jetë e nevojshme, do të përditësohen;

(g) Për derdhjet e pikave të ndotura të cilat mund të shkaktojnë ndotje, duhet të ketë një kërkesë për një rregullim të mëparshëm, si për shembull një ndalesë për derdhjen e substacave ndotëse në ujë, ose autorizim të mëparshëm, ose regjistrim të bazuar në rregulla të përgjithshme detyruese, të përcaktuara në kontrollet për ndotësit përkatës, duke përfshirë dhe kontrolle që bëhen në përputhje me Nenin 10 dhe 16. Këto kontrolle duhet të rishikohen në mënyrë periodike dhe, kur është e nevojshme, duhet të përditësohen;

(h) Për burime të shpërndara që kanë gjasa që të shkaktojnë ndotje, duhen përcaktuar masat për të parandaluar ose kontrolluar ndikimin e ndotësve. Kontrollet mund të marrin formën e një kërkese për rregullime të mëparshme, si për shembull ndalimin e hedhjes/derdhjes së ndotësve në ujë, autorizim ose regjistrim paraprak bazuar në rregullat e përgjithshëm detyruese ku një kërkesë e tillë nuk është dhënë në legjislacionin e Komunitetit. Këto kotrolle duhet të rishikohen në mënyrë periodike, dhe, ku është e nevojshme, duhet të përditësohen;

(i) Për çdo ndikim tjetër domethënës negativ në statusin e ujit të identifikauar në Nenin 5 të Shtojcës II, në veçanti masat për të siguruar që kushtet hidromorfologjike të trupave të ujit janë në përputhje me arritjet e statusit ekologjik të kërkuar ose të potencialit të mirë ekologjik për trupat e ujit të përcaktuar si artificialë ose të modifikuar rëndë. Kontrollet për këtë qëllim mund të marrin formën e një kërkese për një autorizim ose regjistrim paraprak bazuar në rregullat e përgjithshme detyruese, ku një kërkesë e tillë nuk është parashikuar në legjislacionin e Komunitetit. Këto kontrolle duhet të rishikohen në mënyrë periodike dhe, ku është e nevojshme, duhet të përditësohen.

(j) Një ndalim për hedhjet e drejtpërdrejta të ndotësve në subjektin nënujor sipas dispozitave të mëposhtme:

Shtetet anëtare mund të autorizojnë riinjeksionin e ujit të përdorur për qëllime gjeotermale në të njëjtin akuifer.

Ata mund të autorizojnë gjithashtu, duke specifikuar kushtet për:

- injektimin e substancave që përmbajnë ujë që shkaktohen nga veprimet për të zbuluar dhe nxjerrë hidrokarbure ose aktivitete minerare, injektimin e ujit në formacionet gjeografike nga të cilat janë nxjerrë hidrokarburet ose substancat e tjera për arsye teknike, ose injektimin në formacione gjeologjike të cilat si

pasojë e arsyeve natyrale janë të papërshtatshme për qëllime të tjera. Injektime të tilla nuk duhet të përmbajnë substanca të tjera të ndryshme nga ato që vijnë si rezultat i veprimeve të mësipërme,

- rinjektimi i ujit nëntokësor të pompuar nga minierat dhe gërmimet ose të shoqëruara nga ndërtimi ose mirëmbajtja e veprave inxhinierike civile;

- injektimin e gazit natyror ose të LPG-së (gaz petroleumi të lëngëzuar) për qëllime ruajtjeje në formacionet gjeografike, të cilat, për arsye natyrale, janë të papërshtatshme për qëllime të tjera;

- injektimin e gazit natyror ose të LPG-së për qëllime ruajtje në formacione të tjera gjoegrafike ku ka një nevojë të ngutshme për sigurimin e furnizimit me gaz dhe ku injektimi parandalon çdo rrezik aktual ose të ardhshëm për përkeqësimin e cilësisë së ujit nëntokësor të marrë,

- veprat e ndërtimit, të inxhinierisë civile, ndërtesat dhe aktivitete të ngjashme në brendësi ose në sipërfaqe, të cilat janë në kontakt me ujin nëntokësor. Për këto qëllime, shtetet anëtare mund të përcaktojnë se aktivitete të tilla do të trajtohen si të autorizuara, me kusht që ato të ndërtohen në përputhje me rregullat e përgjithshme detyruese të hartuara nga shtetet anëtare përsa u përket aktiviteteve të tilla,

- hedhjet e sasive të vogla të substancave për qëllime shkencore për karakterizimin, mbrojtjen dhe ndreqjen e trupave ujore të kufizuar në sasinë të nevojshme për qëllimet në fjalë

me kusht që hedhje të tilla nuk cënojnë plotësimin e objektivave mjedisore të përcaktuara për trupin e ujit nëntokësor;

(k) në përputhje me veprimet e ndërmarra sipas Nenit 16, masat për të zhdukur ndotjen nga ujrat nëntokësorë nga ato substanca të specifikuara në listën e substancave parësore të rëna dakort sipas Nenit 16(2) dhe për të ulur ndotjen në mënyrë të vazhdueshme nga substanca të tjera, të cilat nuk do t'u lejonin shteteve anëtare të plotësojnë objektivat për trupat sipërfaqësorë të ujit të parashikuar në Nenin 4;

(l) çdo masë që nevojitet për të shmangur humbjet e konsideruara të ndotësve nga instalimet teknike dhe për të shmangur dhe/ose ulur ndikimet e incidenteve të ndotjeve aksidentale për shembull si rezultat i përmbytjeve, duke përfshirë sistemet për diktimin ose dhënien e paralajmërimit për ngjarje të tilla, duke përfshirë dhe rastin e aksidenteve të cilat në mënyrë të arsyeshme nuk mund të parashikohen si dhe të gjitha masat e duhura për të ulur rreziqet e ekosistemeve ujore.

4. Masat "shtesë" janë ato masa të cilat janë hartuar dhe zbatohen si shtojcë e masave bazë, me qëllimin e arritjes së objektivave të përcaktuara në bazë të nenin 4. Pjesa B e Shtojcës IV përmban një listë jo ekskluzive të masave të tilla. Shtetet anëtare mund të miratojnë masa të tjera shtesë në mënyrë që të sigurojnë mbrojtje më të mirë ose përmirësim të ujërave të mbuluar nga kjo Direktivë, duke përfshirë zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilave u referohet Nenin 1.

5. Kur monitorimi ose të dhëna të tjera dëshmojnë se objektivat e përcaktuara në Nenin 4 për trupin e ujit nuk ka të ngjarë që të arrihen, shtetet anëtare duhet të sigurohen që:

- shkaqet e dështimit të mundshëm janë hetuar,

- janë shqyrtuar dhe janë rishikuar ashtu siç duhet lejet dhe autorizimet përkatëse;

- janë rishikuar programet e monitorimit, të cilave u janë bërë rregullimet përkatëse dhe;

- janë përcaktuar masa shtesë të nevojshme për të arritur objektivat e përcaktuara, duke përfshirë, sipas rastit, vendosjen e cilësore standardeve strikte për mjedisin e ndjekur procedurat e parashtruara në Shtojcën V.

  Kur këto shkaqe janë rezultat i rrethanave të shkaqeve natyrore ose si rezultat i forcës madhore, raste të cilat janë përjashtimore dhe nuk mund të parashikohen në bazë të arsyes, si për shembull përmbytjet ekstreme ose thatësirat shumë të gjata, shtetet anëtare mund të përcaktojnë se masat shtesë nuk janë të praktikueshme (Neni 4(6)).

6. Në zbatimin e masave sipas paragrafit 1, shtetet anëtare duhet të marrin të gjitha hapat e nevojshme për të mos rritur ndotjen e ujërave të marinës. Pa paragjykuar legjislacionin ekzistues, aplikimi i masave të marra sipas paragrafit 3, mund të mos çojë qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë në një nivel më të lartë ndotjeve të ujërave tokësore. Kjo kërkesë nuk do të aplikohet kur ajo rezulton në një rritje të ndotjes së mjedisit si i tërë.

7. Programet e masave duhet të rishikohen dhe, nëse është e nevojshme duhet të përditësohen jo më vonë se 15 vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj direktive, dhe një herë në çdo gjashtë vjet pas asaj kohe. Çdo masë e re ose e rishikuar e përcaktuar nën një program të përditësuar, do të vihet në jetë brenda periudhës kohore prej tre vjetësh pas përcaktimit.

## Neni 12

## Çështje që nuk mund të trajtohen në nivelin e shteteve anëtare

1. Kur një shtet anëtar identifikon një çështje që ka ndikim mbi ujin e tij, por që nuk mund të zgjidhet nga shteti anëtar, ai mund t'ia raportojë çështjen Komisionit dhe çdo shteti tjetër anëtar, dhe mund të bëjë rekomandime për zgjidhjen e çështjes.

2. Komisioni duhet t'i përgjigjet çdo raporti ose rekomandimi të bërë nga shtetet anëtare brenda një periudhe kohore 6-mujore.

## Neni 13

## Planet e menaxhimit të baseneve lumore

1. Shtetet anëtare duhet të sigurohen se plani i menaxhimit të basenit lumor bëhet për çdo rreth të basenit lumor që shtrihet tërësisht në territorin e tyre përkatës.

2. Në rastin e rretheve të baseneve ndërkombëtare të lumenjve të cilat janë plotësisht pjesë e Komunitetit, shtetet anëtare duhet të sigurojnë koordinimin me qëllimin e nxjerrjes/përgatitjes së një plani menaxhimi për basenin lumor. Në rastet kur një plan i tillë për menaxhimin e basenit të lumit ndërkombëtar nuk realizohet, shtetet anëtare duhet të prodhojnë plane menaxhimi për basenet lumore, duke mbuluar taksën për ato pjesë të rrjetit të basenit të lumit ndërkombëtar që shtrihen në territoret e tyre, për të arritur objektivat e kësaj Direktive.

3. Në rastin e një rrethi të basenit ndërkombëtar të një lumi që shtrihet përtej kufijve të Komunitetit, shtetet anëtare duhet të përpiqen që të përgatisin një plan të vetëm menaxhimi për basenin ndërkombëtar të lumit dhe, në rastet kur një gjë e tillë nuk është e mundur, plani të paktën duhet të mbulojë pjesën e rrethit të basenit ndërkombëtar të lumit që shtrihet në territorin e shteteve anëtare.

4. Plani i menaxhimit të basenit lumor duhet të përfshijë informacionin e dhënë në mënyrë të detajuar në Shtojcën VII.

5. Planet e menaxhimit të basenit lumor mund të plotësohen me programe më të detajuara dhe plane menaxhimi për nënbasenin, sektorin, çështjen ose llojin e ujit, për të trajtuar aspekte të veçanta të menaxhimit të ujit. Zbatimi i këtyre masave nuk do t'i përjashtojë shtetet anëtare nga asnjë detyrim i tyre i parashikuar nga pjesa tjetër e kësaj Direktive.

6. Planet e menaxhimit të baseneve lumore duhet të botohen jo më vonë se nëntë vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Direktive.

7. Planet e menaxhimit të baseneve lumore do të rishikohen dhe të përditësohen jo më vonë se 15 vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive dhe do të rishikohen dhe përditësohen një herë në gjashtë vjet, pas asaj kohe.

**Neni 14**

**Informimi i publikut dhe konsultimi**

1. Shtetet anëtare do të përkrahin përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesuara në zbatimin e kësaj Direktive, veçanërisht në prodhimin, rishikimin dhe përditësimin e planeve të menaxhimit të baseneve lumore. Shtetet anëtare duhet të sigurohen se për secilin rreth të basenit lumor ata nxjerrin botime dhe i ofrojnë publikut dhe përdoruesve për materialet e mëposhtme:

(a) një grafik dhe një program pune për nxjerrjen e planit, duke përfshirë një deklaratë për masat që do të merren për konsultim, të paktën tre vite përpara fillimit të periudhës së cilës i referohet plani;

(b) një vështrim të plotë të brendshëm të çështjeve domethënëse të menaxhimit të ujit të identifikuar në basenin e lumit, të paktën dy vjet përpara fillimit të periudhës që i referohet plani.

Nëse kërkohet, do të jepet akses për dokumentet bazë dhe informacionin e përdorur për zhvillimin e projektit të planit të menaxhimit të basenit lumor.

2. Shtetet anëtare duhet të lejojnë të paktën gjashtë muaj për të komentuar këto dokumente me shkrim, në mënyrë që të lejohet një pjesëmarrje dhe proces konsultimi aktiv.

3. Paragrafi 1 dhe 2 do të aplikohet në mënyrë të barabartë mbi planet e menaxhimit të basenit lumor.

**Neni 15**

**Raportimi**

1. Shtetet anëtare duhet t'i dërgojnë Komisionit kopje të planeve të menaxhimit të basenit lumor si dhe kopje pasardhëse të përditësuara. Kopje të njëja duhet t'i dërgohen dhe Shteteve Anëtare të interesuara brenda një periudhë tremujore nga botimi i tyre;

(a) për rrethet e baseneve lumore që janë plotësisht pjesë e territorit të vendeve anëtare, të gjitha planet e manaxhimit të lumenjve që mbulojnë atë territor dhe të botuara sipas Nenit 13;

(b) për rrethet e baseneve ndërkombëtare të lumenjve, të paktën pjesën e planeve të menaxhimit të basenit lumor që mbulon territorin e shtetit anëtar.

2. Shtetet anëtare duhet të paraqesin raportet përmbledhëse të:

- analizës që kërkohet sipas Nenit 5 dhe

- programet e monitorimit të përcaktuara në Nenin 8

të ndërmarra për qëllimet e planit të parë të basenit të lumit, brenda tre muajsh nga përfundimi i tyre.

Shtetet anëtare, brenda tre vjetësh nga botimi i planit të menaxhmit të basenit lumor ose përditësimit të parashikuar në Nenin 1, duhet t'i paraqesin një raport të brendshëm që përshkruan arritjet në zbatimin e programit të planifikuar të masave.

**Neni 16**

**Strategjitë kundër ndotjes së ujit**

1. Parlamenti Europian dhe Këshilli do të miratojnë masa specifike kundër ndotjes të ujit nga ndotës individualë ose grup ndotësish që përfaqësojnë një rrezik domethënës në ose nëpërmjet mjedisit ujor, duke përfshirë rreziqe të tilla për ujërat e përdorura për nxjerrjen e ujit të pijshëm. Për këta ndotës masat do të synohet që të ulin në mënyrë të vazhduehsme substancat parësore të rrezikshme, ashtu siç përcaktohet në Nenin 2(30) në nxjerrjen e ngarkesave ose humbjet. Masa të tilla do të hartohen nën bazë të propozimeve që paraqiten nga Komisioni në përputhje me procedurat e parashikuara nga Traktati.

2. Komisioni do të paraqesë një propozim duke përcaktuar një listë të substancave parësore të zgjedhura ndërmjet atyre substancave që paraqesin një rrezik domethënës mbi mjedisin ujor ose nëpërmjet mjedisit ujor. Veprimi i substancave do të përcaktohet në bazë të rrezikut mbi mjedisin ujor ose nëpërmjet mjedisit ujor, të identifikuar nga:

(a) vlerësimi i rrezikut i përfshirë në Rregulloren e Këshillit (EEC) nr. 793/93([1]), Direktiva e Këshillit nr 91/414/EEC ([2]), dhe Direktiva nr 98/8/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit([3]), ose

(b) vlerësimi i bazuar në rreziqe (sipas metofologjisë së Rregullores (EEC) nr 793/93) duke u përqëndruar vetëm në ekotoksicitetin e ujit dhe në thelmimin njerëzor nëpërmjet mjedisit ujor.

Aty ku është e nevojshme, në mënyrë që të arrihet programi i përcaktuar në paragrafin 4, substancat duhet të përcaktohen sipas përparësisë për veprim në bazë të rrezikut mbi mjedisin ujor ose nëpërmjet tij, të identifikuar nga një procedurë e thjeshtë vlerësimi të bazuar në rreziqet, duke marrë veçanërisht në konsideratë:

- të dhënat në lidhje me rrezikun natyror të substancës në fjalë dhe veçanërisht ekotoksitetin e saj ujor nëpërmjet rrugëve të ekspozimit ujor dhe,

faktorë të tjerë të provuar, të cilët mund të dëshmojnë mundësinë e përhapjes së ndotjes mjedisore, si për shembull prodhimin ose volumin e përdorimit të substancave në fjalë dhe llojet e përdorimit.

3. Propozimi i komisionit duhet të identifikojë gjithashtu dhe substancat me rrezikshmëri më të lartë. Gjatë këtij procesi Komisioni duhet të marrë parasysh zgjedhjen e substancave që paraqesin shqetësim, të trajtuara nga legjislacioni i Komunitetit përkatës përsa u përket substancave të rrezikshme ose marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare.

4. Komisioni duhet të rishikojë listën e miratuar të substancave parësore jo më vonë se katër vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Direktive dhe të paktën një herë në katër vjet pas asaj kohe, duhet të paraqesë propozime.

[1] OJ L 84l 5. 04. 1993, fq 1
[2] OJ L 230 19. 08. 1991, fq 1
[3] OJ L 123 24. 04. 1998, fq 1

5. Gjatë përgatitjes së propozimit të tij Komisioni duhet të marrë parasysh rekomandimet nga Komiteti Shkencor mbi Toksitetin, Ekotoksicitetin dhe Mjedisin, Shtetet Anëtare, Parlamentin Evropian, Agjencinë e Mjedisit Europian, programet e kërkimet të komunitetit, organizatat ndërkombëtare në të cilat Komuniteti është palë. Organizatat europiane të biznesit duke përfshirë ato organizata që përfaqësojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, organizatat europiane të mjedisit dhe informacione të tjera që janë në vëmendjen e tyre.

6. Për substancat parësore, Komisioni duhet të paraqesë propozime për kontrolle për:

- uljen e vazhdueshme të hedhjeve, nxjerrjeve ose humbjeve të substancave në fjalë, dhe në veçanti

- përfundimin ose çfazimin e hedhjeve, nxjerrjeve dhe humbjeve të substancave të identifikuara në përputhje me paragrafin 3, duke përfshirë një afat kohor të përshtatshëm për ta bërë këtë. Afati kohor nuk duhet të jetë më i gjatë se 20 vjet pas miratimit të këtyre propozimeve nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli, në përputhje me parashikimet e ketij Neni.

Gjatë këtij procesi Komisioni duhet të identifikojë nivelin e duhur efektiv të kostos, kombinimin e kontrolleve të produktit dhe të procesit për burime e përqëndruara dhe të shpërqëndruara dhe duhet të marrë parasysh vlerat limite të nxjerrjeve uniforme në mbarë Komunitetin për kontrollet e procesit. Aty ku shihet si e nevojshme, mund të ndërmerren veprime në nivelin e komunitetit për kontrolle procesi në bazë sektoriale. Kur kontrollet e produktit përfshijnë një rishikim të autorizimeve përkatëse të nxjerra në Direktivën 91/414/EEC dhe Direktivën 98/8/EC, rishikime të tilla do të realizohen në përputhje me parashikimet e këtyre Direktivave. Çdo propozim për kontroll duhet të specifikojë rregullimet për rishikimin e tyre, përditësimin dhe vlerësimin e efektivitetit të tyre.

7. Komisioni do të paraqesë propozime për cilësinë e standardeve të aplikueshme për përqëndrimet e substancave parësore në ujërat sipërfaqësore, sedimentet ose biotat.

8. Komisioni do të paraqesë propozime në përputhje me paragrafët 6 dhe 7 dhe të paktën për kontrollet e nxjerrjeve për burimet e përqëndruara dhe standardet e cilësisë mjedisore brenda dy vjetësh nga përfshirja e substancës në listën e substancave përparësore. Për ato të përfshira në listën e parë të substancave përparësore, në mungesë të një marrëveshjeje në nivelin e Komunitetit, gjashtë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, shtetet anëtare do të përcaktojnë standarde cilësie për mjedisin për ato substanca për të gjithë ujërat sipërfaqësorë të prekura nga shkarkimet e këtyre substancave, dhe kontrollet në burimet parësore të shkarkimeve të tilla, bazuar *inter alia* në marrjen në konsideratë të të gjitha zgjidhjeve të uljeve teknike. Për substancat që përfshihen rrjedhimisht në listën e substancave përparësore, në mungesë të marrëveshjes në nivelin e Komunitetit, shtetet anëtare do të ndërmarrin një hap të tillë pesë vjetë pas futjes në listë.

9. Komisioni mund të përgatisë strategji kundër ndotjes së ujit për cdo ndotës tjetër ose grup ndotësish, duke përfshirë dhe atë që ndodh si rezultat i aksidenteve.

10. Gjatë përgatitjes së propozimeve të tij, sipas paragrafëve 6 dhe 7, Komisioni do të rishikojë gjithashtu të gjitha Direktivat e dhëna në Shtojcën IX. Ai duhet të propozojë, deri në afatin kohor të parashikuar në paragrafin 8, një rishikim të kontrolleve në Shtojcën IX për të gjitha ato substanca që përfshihen në listën e atyre prioritare dhe duhet të propozojë masat e nevojshme; duke përfshirë zhvleftesimin e mundshëm të kontrolleve sipas Shtojcës IX për të gjitha substancat e tjera.

Të gjitha kontrollet në Shtojcën IX për të cilat propozohen rishikime do të anullohen në datën e hyrjes në fuqi të këtyre rishikimeve.

11. Lista e substancave përparësore të substancave të përmendura në paragrafin 2 dhe 3 të propozuar nga Komisioni do të bëhet Shtojca 1 e kësaj Direktive pas miratimit nga Parlamenti Europian dhe Këshilli. Rishikimi i saj i

përmendur në paragrafin 4 do të ndjekë të njëjtën procedurë.

**Neni 17**

**Strategjitë për të parandaluar dhe për të kontrolluar ndotjen e ujit nëntokësor**

1. Parlamenti Europian dhe Këshilli do të hartojnë masa specifike për të shmangur dhe për të kontrolluar ndotjen e ujit nëntokësor. Masa të tilla do të synojnë të arrijnë objektivat e statusit të mirë kimik nënujor në përputhje më Nenin 4(1)(b) dhe do të miratohen në bazë të propozimit të paraqitur brenda 2 vjetësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Direktive nga Komisioni, në përputhje me procedurat e parashikuara nga Traktati.

2. Gjatë propozimit të masave Komisioni do të marrë parasysh analizat e bëra sipas Nenit 5 dhe Shtojcës II. Masa të tilla do të propozohen më parë nëse ka të dhëna të disponueshme dhe do të përfshijnë:

   (a) kriteret për vlerësimin e statusit të mirë kimik nënujor në përputhje me Shtojcën II.2.2 dhe Shtojcën V 2.3.3 dhe 2.4.5;

   (b) kriteret për identifikimin e përparësive domethënëse dhe të qëndrueshme me tendencë në rritje dhe për përcaktimin e pikave të nisjes për tendencat e kundërta që do të përdoren në përputhje me Shtojcën V 2.4.4.

3. Masat që vijnë si rezultat i zbatimit të paragrafit 1 do të përfshihen në programet e masave që kërkohen sipas Nenit 11.

4. Në mungesë të kritereve të miratuara sipas paragrafit 2 në nivelin e Komunitetit, shtetet anëtare duhet të vendosin kriteret e duhura jo më vonë se pesë vjet nga data e hyrjes së kësaj Direktive në fuqi.

5. Në mungesë të kritereve të miratuara sipas paragrafit 4 në nivelin kombëtar, kthimi i tendencës duhet të konsiderojë si pikë nisje 75% e nivelit të standardeve të cilësisë të përcaktuar në legjislacionin ekzistues të Komunitetit, që është i zbatueshëm për ujerat nëntokësorë.

**Neni 18**

**Raporti i Komisionit**

1. Komisioni do të botojë një raport për zbatimin e kësaj Direktive jo më vonë se 12 vjet pas hyrjes në fuqi të Direktivës dhe një herë në 6 vjet pas kësaj kohe, duhet t'ia paraqesë këtë raport Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

2. Raporti duhet të përfshijë elementët e mëposhtme:

   (a) një rishikim të statusit të ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor në Komunitet, të përgatitur në bashkëpunim me Agjencinë Evropiane të Mjedisit;

   (b) një hetim për planet e menaxhimit të basenit lumor të paraqitur në përputhje me Nenin 15, duke përfshirë sugjerime për përmirësime të planeve në të ardhmen;

   (c) një sondazh të planeve të menaxhimit të basenit lumor, të paraqitur në përputhje me nenin 15, duke përfshirë dhe sugjerime për përmirësimin e planeve për të ardhmen;

   (d) një përmbledhje të përgjigjeve të secilit prej raporteve ose rekomandimeve për Komisionin, të bëra nga shtetet anëtare sipas Nenit 12;

(e) një përmbledhje të propozimeve, masave të kontrollit dhe strategjive të zhvilluara sipas nenit 16;

(f) një përmbledhje të përgjigjeve ndaj komenteve të bëra nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli mbi raportet e mëparshme të zbatimit.

3. Komisioni do të botojë gjithashtu dhe një raport progresi për zbatimin e bazuar në raportet përmbledhëse që paraqesin shtetet anëtare sipas Nenit 15(2), dhe do t'ia paraqesin atë Parlamentit Evropian dhe shteteve anëtare jo më vonë se dy vjet pas datës që i referohet Neni 5 dhe Neni 8.

4. Brenda tre vjetësh nga botimi i secilit raport të përmendur në paragrafin 1, Komisioni do të botojë një raport të brendshëm për të përshkruar arritjet në zbatimin e bazës së raporteve të brendshme të shteteve anëtare ashtu siç përmendet në Nenin 15(3). Kjo duhet t'i dërgohet Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

5. Komisioni, në përputhje me ciklin e raportimit, atëherë kur nevojitet do të mbledhë një konferencë për politikën e Komunitetit për ujin, ku do të marrin pjesë palët e interesuara nga secili shtet anëtar për të komentuar raportet e zbatimit të Komisionit dhe për të ndarë përvoja.

Lista e pjesëmarrësve do të përfshijë gjithashtu dhe përfaqësues nga autoritetet përkatëse, Parlamenti Evropian, OJQ-të, partnerët socialë dhe ekonomikë, strukturat e konsumatorëve, akademikë dhe ekspertë të tjerë.

**Neni 19**

**Planet për masat e Komunitetit në të ardhmen**

1. Një herë në vit, për qëllime informimi Komisioni do t'i paraqesë Komitetit që i referohet Neni 21, një plan tregues masash që kanë ndikim në legjislacionin e ujit, i cili ka si synim që t'i propozojë në një të ardhme të afërt, duke përfshirë propozimet, masat e kontrollit dhe strategjitë e zhvilluara sipas Nenit 16. Komisioni do të bëjë prezantimin e parë jo më vonë se 2 vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive.

2. Komisioni do të rishikojë Direktivën jo më vonë se 19 vjet pas datës së hyrjes në fuqi, do të të propozojë dhe ndryshime, nëse është e nevojshme.

**Neni 20**

**Adaptimet teknike të Direktivës**

1. Shtojcat I, III dhe seksioni 1.3.6 i Shtojcës V mund të miratohen si progres shkencor dhe teknik në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Neni 21, duke marrë parasysh periudhat për rishikimin dhe përditësimin e planeve të menaxhimit të basenit lumor që i referohet Neni 13. Aty ku është e nevojshme, Komisioni mund të hartojë udhëzime për zbatimin e Shtojcës II dhe V në përputhje me procedurat e parashtruara në Nenin 21.

2. Për qëllimin e transmetimit dhe përpunimit të të dhënave, duke përfshirë të dhëna statistikore dhe kartografike, formatet teknike për qëllim të paragrafit 1 mund të miratohen në përputhje me procedurat e parashtruara në Nenin 21.

**Neni 21**

**Komiteti Rregullator**

1. Komisioni do të ndihmohet nga komiteti (që tani e tutje referenca këtij organi do t'i bëhet si "Komiteti")

2. Kur i bëhet referencë këtij Neni, do të zbatohen Nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/EC, duke pasur parasysh dispozitat e Nenit 8 po aty.

Periudha e parashikuar në Nenin 5(6) e Vendimit 1999/468/EC do të kufizohet në tre muaj.

3. Komiteti duhet të hartojë rregulloren e tij.

**Neni 22**

**Anullimet dhe Dispozita Tranzitore**

1. Dokumentet e mëposhtme do të shfuqizohen pas shtatë vitesh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Direktive:

- Direktiva 75/440/EEC e 16 qershorit të vitit 1975 që lidhet me cilësinë e kërkuar për ujin sipërfaqësor të synuar për t'u përdorur për nxjerrjen e ujit të pijshëm nga shtetet anëtare ([1]);

- Vendimi nr 77/440/EEC i Këshillit, i nxjerrë më 12 dhjetor të vitit 1997, që përcakton një procedurë të përbashkët për shkëmbimin e informacionit për cilësinë e ujit të freskët sipërfaqësor në Komunitet ([2]);

- Direktiva e Këshillit nr 79/869/EEC e 9 tetorit të vitit 1979 që lidhet me metodat e matjes së frekuencave të kampionëve dhe të analizave të ujit sipërfaqesor, të synuar për t'i përdorur për nxjerrjen e ujit te pijshëm nga shtetet anëtare ([3]);

2. Dokumentet e mëposhtme do të shfuqizohen pas 13 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj direktive:

- Direktiva e Këshillit nr 78/659/EEC e 17 korrikut të vitit 1978 për cilësinë e ujërave të brendshme që kanë nevojë për mbrojtje ose përmirësim në mënyrë që të mbështetet jeta e peshqve ([4]);

- Direktiva e Këshillit nr 79/923/EEC e 30 tetorit të vitit 1979 për cilësinë e kërkuar për ujërat e molusqeve ([5])

- Direktivë e Këshillit nr 80/68/EEC e datës 17 dhjetor të vitit 1979 për mbrojtjen e ujit nëntokësor kundër ndotjes së shkaktuar nga substanca të caktuara të rrezikshme;

- Direktiva 76/464/EEC me përjashtim të Nenit 6, i cili do të shfuqizohet pas hyrjes së kësaj Direktive në fuqi.

3. Dispozitat e mëposhtme provizore do të aplikohen për Direktivën 76/464/EEC:

   (a) lista e substancave parësore e miratuar sipas Nenit 16 të kësaj Direktive do të zëvendësojë listën e substancave të nxjerra si parësore nga Komisioni në komunikatën e tij dhënë para Këshillit më 22 qershor të vitit 1982;

   (b) për qëllimet e Nenit 7 të Direktivës 76/464/EEC, shtetet anëtare mund të aplikojnë parimet për identifikimin e problemeve të ndotjes dhe substancave që i shkaktojnë ato, përcaktimin e standardeve të cilësisë dhe miratimin e masave të përcaktuara në këtë Direktivë.

4. Objektivat mjedisore të Nenit 4 dhe standardet e cilësisë së mjedisit të dhëna në Shtojcën IX dhe në përputhje me

[1] OJ L 194, 25. 07. 1975, fq 26, Direktiva e amenduar nga Direktiva 91/692/EEC
[2] OJ L 334, 24. 12. 1977; Vendim i amenduar së fundmi nga Akti i Pranimit të 1994-ës
[3] OJ L 271, 29. 10. 1979, fq 44; Direktivë e amenduar së fundmi nga Akti i Pranimit të 1994-ës
[4] OJ L 222, 14. 08. 1978, fq 1; Direktivë e amenduar së fundmi nga Akti i Pranimit të 1994-ës
[5] OJ L 281, 10. 11. 1979, fq 47; Direktivë e amenduar së fundmi nga Akti i Pranimit të 1994-ës

Nenin 16(7) dhe nga shtetet anëtare sipas Shtojcës V për substancat nuk janë në listën e substancave përparësore dhe sipas Nenit 16(8) përsa u përket standardeve përparësore për të cilat nuk janë përcaktuar standardet e komunitetit, do të konsiderohen si standarde të cilësisë së mjedisit për qëllimet e pikës 7 të Nenit 2 dhe të Nenit 10 të Direktivës 96/61/EC.

5. Kur një substancë në listën e substancave prioritare të miratuara sipas Nenit 16 nuk është përfshirë në Shtojcën VIII të Direktivës 96/61/EC, ajo duhet të shtohet menjëherë pas identifikimit.

6. Për trupat e ujërave sipërfaqësore, objektivat mjedisore të përcaktuara në planin e parë të menaxhimit të basenit lumor të kërkuar nga kjo Direktivë, si minimum, duhet të bëjnë të aplikueshme standardet e cilësisë të paktën në mënyrë aq strike sa ata standarde që kërkohen të zbatohen sipas Direktivës 76/464/EEC.

**Neni 23**

**Gjobat**

Shtetet anëtare duhet të përcaktojnë gjoba për rastet e shkeljeve të dispozitave kombëtare të miratuara në përputhje me Direktivën. Në këtë mënyrë gjobat do të jenë efektive dhe proporcionale.

**Neni 24**

**Zbatimi**

1. Shtetet anëtare duhet të fusin në fuqi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative që janë të nevojshme për t'u përshtatur me këtë Direktivë jo më vonë se deri më 22 dhjetor të vitit 2003. Pas këtij veprimi, ata duhet të informojnë Komisionin.

Pasi shtetet anëtare të kenë miratuar këto masa, ato duhet të përfshijnë një referencë ndaj Direktivës, ose duhet të shoqërohen nga një referencë e tillë kur të botohen zyrtarisht. Metodat e bërjes së referencave të tilla do të përcaktohen nga shtetet anëtare.

2. Shtetet anëtare do t'i komunikojnë Komisionit tekstet e dispozitave kryesore të ligjeve kombëtare të cilat ata miratojnë në fushën e qeverisur nga Direktiva. Më pas Komisioni duhet të informojështetet e tjera anëtare.

**Neni 25**

**Hyrja në fuqi**

Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi ditën e botimit të saj në *Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.*

**Neni 26**

**Adresimi**

Direktiva u drejtohet shteteve anëtare

E përgatitur në Luksemburg, më 23 tetor 2000.

| Për Parlamentin Evropian | Për Këshillin |
|---|---|
| Presidenti | Presidenti |
| N. FONTAINE | J. GLAVANY |

**SHTOJCA I**

Informacioni që kërkohet për listën e autoriteteve përgjegjëse

Ashtu sic kërkohet nga Neni 3 (8), shtetet anëtare do tu ofrojnë informacionin e mëposhtëm të gjitha autoriteteve përgjegjëse brenda secilit rreth të basenit lumor si dhe përqindjen e cdo rrethi të basenit ndërkombëtar lumor që shtrihet brenda territorit të tyre.

(i) emrin dhe adresën e autoritetit përkatës – emrin zyrtar dhe adresën e autoriteteve të identifikuar sipas Nenit 3(2);

(ii) Shtrirjen gjeografike të rrethit të basenit ujor – emrin e lumenjve kryesorë brenda rrethit të basenit, së bashku me një përshkrim të saktë të kufijve të rrethit të basenit ujor. Informacioni duhet sa më shumë të jetë e mundur i disponueshëm për të bërë hyrjen në një sistem formacioni gjeografik dhe/ose sistemin e informacionit gjoegrafik të Komisionit (GISCO);

(iii) Statusin ligjor të autoritetit përgjegjës – një përshkrim të statusit ligjor të autoritetet kompetent dhe, aty ku duhet, një përmbledhje të kopjes së statusit të saj, marrëveshjen e themelimit ose dokumenta të tjera përkatëse.

(iv) Përgjegjësitë – një përshkrim të përgjegjësive ligjore dhe administrative për cdo autoritet përgjegjës dhe një përshkrim të rolit të tij në cdo rreth të basenit lumor;

(v) Anëtarësia – kur autoriteti përgjegjës luan rolin e një organi koordinues për autoritetet e tjera përgjegjëse, kërkohet një listë e këtyre organeve së bashku me një përmbledhje të marrëdhënieve institucionale, të vendosura në mënyrë që të realizohet koordinimi;

(vi) Marrëdhëniet ndërkombëtare – kur një basen lumor mbulon territorin e më shumë se një shteti anëtar ose përfshin territorin e një shteti joanëtar, kërkohet një përmbledhje e marrëdhënieve institucionale të vendosura, në mënyrë që të sigurohet koordinimi.

**SHTOJCA II**

1. Ujërat Sipërfaqësore

Karakteristikat e llojeve të ujërave sipërfaqësore.

Shtetet anëtare duhet të identifikojnë vendndodhjen dhe kufijtë e kategorive të ujërave sipërfaqësore dhe duhet të ëartësojnë karakteristikat më cilësore të të gjitha zonave në përputhje me metodologjinë e mëposhtme. Shtetet Anëtare mund të grupojnë kategoritë në fjalë së bashku, për qëllimet e këtyre karakteristikave fillestare.

(i) Ujërat sipërfaqësore brenda basenit lumor do të identifikohen si një prej kategorive të mëposhtëme të ujërave supërfaqësore – lumenj, liqene, ujëra tranzitë ose ujëra bregdetare – apo ujëra sipërfaqësore artificiale, ose si ujëra sipërfaqësore që janë tepër të modifikuar.

(ii) Për secilën kategori të ujit sipërfaqësor, zonat përkatëse të ujit sipërfaqësor do të dallohen sipas llojeve/tipeve. Këto tipe janë ato që përcaktohen duke përdorur: “sitemin A”ose “sistemin B”të identifikuar në seksionin 1.2.

(iii) Nëse përdoret sistemi A, kategoritë e ujit sipërfaqësor brenda basenit ujor do të kategorizohen së pari nga ekorajonet përkatëse në përputhje me zonat gjeografike të identifikuara në seksionin 1.2 dhe të treguara në hartën përkatëse të Shtojcës XI. Zonat ujore brenda cdo ekorajoni do të dallohen më pas sipas tipeve, në bazë të përshkrimit të përcaktuar në tabelat e sistemit A.

(iv) Nëse pëdoret sistemi B, shtetet anëtare duhet të arrijnë të paktën të njëjtën shkallë ndryshimi që do të arrihet duke përdorur sistemin A. Si rezultat, kategoritë e ujit sipërfaqësor brenda basenit ujëmbledhës lumor do të kategorizohen sipas tipeve duke përdorur vlerat për përshkruesit detyrues dhe për përshkrues të tillë opsionalë, ashtu sic kërkohet, për të siguruar se kushtet e referencës specifike biologjike mund të jenë të përftuara.

(v) Për kategoritë ujore sipërfaqësore artificiale ose tepër të modifikuara, ndryshimi do të ndërmerret në përputhje me përshkruesit për cilindo prej kategorisë së sipërfaqeve ujore që ka ngjashmëri më shumë me trupin ujor të modifikuar shumë ose artificial në fjalë.

(vi) Shtetet anëtare do t’i paraqesin Komisionit një hartë ose disa harta (në format GIS) të vendndodhjes gjeografike të llojeve, në përputhje me shkallën e ndryshimit që kërkohet sipas sistemit A.

**1.2. Ekorajonet dhe llojet e ujërave sipërfaqësore.**

1.2.1. Lumenjtë

Sistemi A

| Tipologjia fikse | Përshkruesit |
|---|---|
| Ekorajonet | Ekorajonet e treguara në hartën A në Shtojcën XI |
| Lloji | Tipologjia e lartësisë<br>I/e lartë: më e lartë se 800 metra<br>Lartësia mesatare: 200 deri në 800 metra<br>Fushë: më e vogël se 200 metra<br><br>Tipologia e masës, bazuar në shtrirjen e zonës<br>E vogël: 10 deri në 100 $km^2$<br>E mesme: më e madhe se 100 deri në 1000 $km^2$<br>E madhe: më e madhe se 1 000 deri në 10 000 $km^2$ |

| | |
|---|---|
| | Shumë e madhe: më e madhe se 10 000 $km^2$<br><br>Gjeologjia<br>Gëlqerore<br>Silicore<br>Organike |

Sistemi B

| Karakterizimi alternativ | Faktorët fizikë dhe kimikë që përcaktojnë karakteristikat e lumit ose të një pjese të lumit, për rrjedhojë dhe strukturën biologjike të popullsisë dhe përbërjen e saj |
|---|---|
| Faktorët detyrues (përcaktues) | Lartësia<br>Pozicionimi<br>Prerja tërthore (gjerësia)<br>Gjeologjia<br>Masa |
| Faktorët opsionalë | Distanca nga burimi i lumit<br>Energjia e rrjedhjes (funksion i rrjedhjes dhe i pjerrësisë)<br>Mesatarja e gjerësisë së ujit<br>Mesatarja e thellësisë së ujit<br>Mesatarja e pjerrësisë së ujit<br>Forma e shtratit (më kryesor) të lumit<br>Kategoria e shkarkimit/rrjedhjes së ujit<br>Forma e luginës<br>Transportimi i mbetjeve të ngurta<br>Kapaciteti i neutralizimit acid<br>Mesatarja e përbërjes së nënshtresës(tabanit)<br>Klorinimi<br>Luhatjet e temperaturës së ajrit<br>Mesatarja e temperaturave të ajrit<br>Precipitimi |

1.2.2. Liqenet

**Sistemi A**

| Tipologjia fikse | Përshkruesit |
|---|---|
| Ekorajonet | Ekorajonet e treguara në hartën A në Shtojcën XI |
| Lloji | Tipologjia e lartësisë<br>I/e lartë: më e lartë se 800 metra<br>Lartësia mesatare: 200 deri në 800 m<br>Fushë: më e vogël se 200 m<br><br>Tipologia e thellësisë e bazar në mesataren e thellësisë<br>më e madhe se 3 m |

| | |
|---|---|
| | 3-15 m<br>Më e madhe se 15 m<br><br>Gjeologjia<br><br>Gëlqeror<br>Silicor<br>Organike |

**Sistemi B**

| Karakterizimi alternativ | Faktorët fizikë dhe kimikë që përcaktojnë karakteristikat e lumit ose të një pjese të lumit, si rezultat dhe strukturën biologjike të popullsisë dhe përbërjen e saj |
|---|---|
| Faktorët detyrues (përcaktues) | Lartësia<br>Pozicionimi<br>Prerja tërthore (gjerësia)<br>Thellësia<br>Gjeologjia<br>Masa |
| Faktorët me përzgjedhje | Mesatarja e thellësisë së ujit<br>Forma e liqenit<br>Koha e qëndresës<br>Mesatarja e temperaturave të ajrit<br>Luhatjet e temperaturës së ajrit<br>Karakteristikat e përziera (p.sh monomiktike, dimiktike, polimiktike)<br>Kapaciteti i neutralizimit acid<br>Statusi bazë ushqyes<br>Mesatarja e përbërjes së nënshtresës(tabanit)<br>Ndryshimi i nivelit të ujit |

1.2.3 Ujërat tranzicionalë

**Sistemi A**

| Tipologjia fikse | Përshkruesit |
|---|---|
| Ekorajonet | Ekorajonet e identifikuara në hartën B në Shtojcën XI<br><br>Deti Balltik<br>Deti Barens<br>Deti i Norvegjisë<br>Deti i Veriut<br>Oqeani i Atlantikut Verior<br>Deti Mesdhe |

| | |
|---|---|
| Lloji | Bazuar në mesataren e kripshmërisë vjetore<br>Më e vogël se 0,5%: ujë i freskët/pa kripë<br>0.5 deri në 5% : pak i kripur<br>5 deri në 18%: mesatarisht i kripur<br>18 deri në 30% shumë i kripur<br>30 deri në 40% shumë shumë i kripur<br><br>Bazuar në mesataren e nivelit të pastërtisë<br>Më i madh se 2 m: mikrotidal<br>2 deri në 4 m: mesotidal<br>më e madhe se 4 m: makrotidal |

**Sistemi B**

| Karakterizimi alternativ | Faktorët fizikë dhe kimikë që përcaktojnë karakteristikat e lumit ose të një pjese të lumit dhe si rezultat dhe strukturën biologjike të popullsisë dhe përbërjen e saj |
|---|---|
| Faktorët detyrues (përcaktues) | Pozicionimi<br>Prerja tërthore (gjerësia)<br>Niveli i pastërtisë<br>Kripshmëria |
| Faktorët me përzgjedhje (opsionale) | Thellësia<br>Shpejtësia e momentit<br>Ekspozimi i valës<br>Koha e qëndrimit<br>Mesatarja e temperaturave të ujit<br>Karakteristikat e përzierjes<br>Turbulenca<br>Mesatarja e përbërjeve të nënshtresës<br>Forma<br>Ecuria e temperaturave të ujit |

1.2.4. Ujërat Bregdetare

**Sistemi A**

| Tipologjia fikse | Përshkruesit |
|---|---|
| Ekorajonet | Ekorajonet e ideitifikuara në hartën B në Shtojcën XI<br><br>Deti Balltik<br>Deti Barens<br>Deti i Norvegjisë<br>Deti i Vermut<br>Oqeani i Atlantikut Verior<br>Deti Mesdhe |
| Lloji | Bazuar në mesataren e kripshmërisë vjetore<br><br>Më e vogël se 0,5%: ujë i freskët/pa kripë<br>0.5 deri në 5% : oligohaline<br>5 deri në 18%: mesohaline<br>18 deri në 30% palihaline<br>30 deri në 40% euhaline<br><br>Bazar në mesataren e thellësisë<br><br>Ujëra të cekëta: deri në 30 m<br>Të mesme: 30 deri në 200 m<br>Të thella: më shumë se 200 m |

**Sistemi B**

| Karakterizimi Alternativ | Faktorët fizikë dhe kimikë që përcaktojnë karakteristikat e lumit ose të një pjese të lumit, si rezultat dhe strukturën biologjike të popullsisë dhe përbërjen e saj |
|---|---|
| Faktorët detyrues (përcaktues) | Pozicionimi<br>Prerja tërthore<br>Prurjet<br>Kripshmëria |
| Faktorët me përzgjedhje (opsionalë) | Shpejtësia e çastit<br>Ekspozimi i valëve<br>Mesatarja e temperaturave të ujit<br>Karakteristikat e përzierjes<br>Turbulenca<br>Koha e qëndrimit (të gjireve detarë të mbyllur)<br>Mesatarja e përbërjes së nënshtresave(tabani)<br>Ecuria e temperaturave të ujit |

### 1.3. Vendosja e kushteve të referencës për llojet e vecanta për tipet e kategorive të ujërave sipërfaqësore

(i) Për secilin tip të kategorive të ujit sipërfaqësor të karakterizuar sipas seksionit 1.1, kushte specifike hidromorfologjike dhe fiziko-kimike duhet të vendosen me qëllim që të paraqesin vlerat e elementëve cilësorë hidromorfologjikë dhe fiziko-kimikë të specifikuar në pikën 1.1 në Shtojcën V për atë kategori të ujit sipërfaqësor në status të lartë ekologjik të përcaktuar në tabelën përkatëse në pikën 1.2. të shtojcës V. kushtet e referencës biologiike tipiko-specifike do të përcaktohen gjithashtu, duke shprehur vlerat e elementëve të cilësisë biologjike të dhënë të specifikuara në pikën 1.1 të Shtojcës V për atë lloj kategorie të sipërfaqes ujore në një status të lartë ekologjik të përcaktuar në tabelën përkatëse në seksionin 1.2 në Shtojcën V.

(ii) Gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë seksion për kategoritë ujore tepër të modifikuara ose artificiale, referencat për një status të lartë ekologjik duhet të ndërtohen si referenca deri në potencialin maksimal ekologjik të përcaktuar në tabelën 1.25 të Shtojcës V. Vlerat për potencialin maksimal ekologjik për një kategori do të rishikohen një herë në gjashtë vjet.

(iii) Kushtet tipiko-specifike për qëllimet e pikave (i) dhe (ii) dhe kushtet e referencës biologjike të llojeve të vecanta mund të bazohen në hapësirë ose në modelim, apo mund të vijnë si rezultat i kombinimit të këtyre dy metodave. Aty ku nuk është e mundur që të përdoren këto metoda, shtetet anëtare mund të marrin mendimin e ekspertëve për të përcaktuar kushte të tilla. Në përcaktimin e një statusi të lartë ekologjik, përsa i përket përqëndrimit të ndotësve specifikë sintetikë, kufijtë e diktimit janë ato që mund të arrihen në përputhje me teknikat e disponueshhme në një kohë kur kushtet e lidhura, vecanerisht me llojin/tipin, duhet të përcaktohen.

(iv) Për kushtet e referencës biologjike tipiko-specifike, shtetet anëtare do të zhvillojnë një rrjet reference për cdo kategori të ujit sipërfaqësor. Rrjeti do të përfshijë një numër të mjaftueshëm vendesh të një statusi të lartë për të ofruar një nivel të mjaftueshëm besueshmërie rreth vlerave të kushteve të referencës, duke pasur parasysh ndryshueshmërinë në vlerat e elementëve të cilësisë që korrespondojnë me statusin e lartë ekologjik për atë kategori të ujit sipërfaqësor dhe sipas teknikave të modelimit, që do të aplikohen sipas paragrafit (v).

(v) Kushtet e referencës biologjike tipiko-specifike, të lidhura vecanërisht me tipin të bazuar në modelim mund të vijnë si rezultat i përdorimit të modeleve të parashikuara ose metodave të fshehura. Metodat duhet të përdorin të dhëna historike, paleologjike e të dhëna të tjera të disponueshme dhe duhet të ofrojnë një nivel të mjaftueshëm besueshmërie rreth vlerave për kushtet e referencës, për të siguruar se kushtet janë të logjikshme dhe të vlefshme për cdo lloj trupi të sipërfaqes ujore.

(vi) Kur nuk është e mundur që të vendosen kushte reference të besueshme që lidhen me specifikisht me llojin për një element cilësie në një tip të trupit të ujit sipërfaqësor si rezultat i shkallëve të larta të ndryshueshmërisë natyrale në atë element, jo vetëm si rezultat i ndryhimeve stinore, atëherë elementi mund të përjashtohet nga vlerësimi i statusit ekologjik për atë tip të ujit sipërfaqësor. Në rrethana të tilla, shtetet anëtare do të deklarojnë arsyet pse ndodh ky përjashtim në planin e menaxhimit të basenit të lumit.

## 1.4. Identifikimi i presioneve

Shtetet anëtare do të mbledhin dhe mirëmbajnë informacionin në lidhje me llojin dhe shkallën e presioneve antropogjene te konsiderueshëm ndaj të cilave ka të ngjarë të ekspozohen kategoritë e ujërave sipërfaqësore në secilin basen lumor, vecanërisht informacioni do të lidhet me:

Vlerësimin dhe identifikimin e burimeve domethënëse të ndotjes, vecanërisht nga substanca të dhëna në listë në Shtojcën VIII nga aktivitete urbane, industriale, bujqësore dhe instalime të tjera, duke u bazuar *inter alia*, në informacionin e mbledhur sipas

(i) Nenet 15 dhe 17 të Direktivës 91/271/EEC;
(ii) Neni 9 dhe 15 i Direktivës 96/61/EC([1])

Dhe për qëllim të planit fillestar të manaxhimit të basenit lumor:

(iii) Neni 11 i Direktivës 76/464/EEC, dhe
(iv) Direktivat 75/440/EC, 76/160/EEC([2]), 78/659/EEC dhe 79/923/EEC([3])

Vlerësimi dhe identifikimi i burimit të ndotjes së shpëndarë, në vecanti nga substancat e dhëna në listë në Shtojcën VIII nga aktivitete ose instalime urbane, industriale, bujqësore dhe të tjera, bazuar *inter alia*, në informacionin e mbledhur sipas:

(i) Neni 3, 5 dhe 6 i Direktovës 91/676/EEC([4])
(ii) Neni 7 dhe 17 i Direktivës 91/441/EEC
(iii) Direktiva 98/8/EC

Dhe për qëllimet e planit të parë të menaxhimit të basenit lumor;

(iv) Direktivat 75/440/EEC, 76/160/EEC, 76/464/EEC, 78/659/Eec dhe 79/923/EEC

Vlerësimi dhe identifikimi i nxjerrjes sinjifikante të ujit për përdorime urbane, industriale, bujqësore dhe përdorime të tjera, duke përfshirë dhe ndryshimet stinore dhe kërkesën totale vjetore, dhe humbjen e ujit në sistemet e shpërndarjes.

Vlerësimi dhe identifikimi i ndikimit të rregullave të rëndësishme të rrjedhjes së ujit, duke përfshirë dhe transferimin e ujit dhe ndryshimin e tij mbi karakteristikat e përgjithshme të rrjedhjes dhe mbi balancat ujore.

Vlerësimi dhe identifikimi i ndikimeve të tjera domethënëse antropogjenike në statusin e ujërave sipërfaqësore.

Vlerësimin e llojeve të përdorimit të ujit, duke përfshirë identifikimin e zonave kryesore urbane, industriale, dhe bujqësore, i faktorëve të tillë si peshqit dhe pyjet ku është e nevojshme.

## 1.5. Vlerësimi i ndikimit

[1] OJ L 135, 30. 05.1991,, fq 40. Direktivat e amenduara së fundmi nga Direktiva 98/15/EC (OJ L 67. 07.03.1998, fq 29)
[2] OJ L 31, 05.02.1976, fq 1 Direktivë e amenduar së fundmi nga Akti I Pranimit të 1994-ës
[3] OJ L 281, 10.11.1979, fq 47 Direktivë e amenduar së fundmi nga Direktiva 91/692/EEC (OJ L 377, 31. 12. 1991, fq 48)
[4] OJ L 375, 31. 12, 1991, fq 1

Shtetet anëtare duhet të bëjnë një vlerësim për ndjeshmërinë e statusit të kategorive të ujërave sipërfaqësore nga presionet e identifikuara më lart.

Shtetet anëtare duhet të përdorin informacionin e mbledhur më parë, dhe cdo informacion tjetër dukë përfshirë të dhëna ekzistuese për monitorimin e mjedisit, duhet të bëjnë një vlerësim mbi gjasat që kategoritë e ujërave sipërfaqësore brenda basenit ujor kanë për mosplotësim të objektivave të cilësisë së mjedisit të përcaktuar për kategoritë në Nenin 4. Shtetet anëtare mund të përdorin teknikat e modelimit për të ndihmuar në një vlerësim të tillë.

Për ato kategori të identifikuara si në rrezik për të plotësuar objektivat e cilësisë së mjedisit, duhet të përcaktohen karakteristika të tjera, aty ku shihet e nevojshme, për të optimizuar hartimin e progameve të monitorimit të kërkuara sipas Nenit 8 dhe programit të masave të kërkuara sipas nenit 11.

## 2. Ujërat nëntokësore

### 2.1.Karakterizimi fillestar

Shtetet anëtare duhet të nxjerrin karakteristikat fillestare të të gjitha kategorive të ujërave nëntokësorë për të vlerësuar përdorimin e tyre dhe shkallën në të cilën ata rrezikojnë që të plotësojnë objektivat për secilën kategori të ujërave nëntokësore të përcaktuar në Nenin 4. Shtetet anëtare mund t'i grupojnë së bashku kategoritë e ujërave nëntokësore për qëllimet e karakterizimit fillestar. Kjo analizë mund të vërë në punë të dhëna për hidrologjinë, gjeologjinë, pedologjinë, përdorimin e tokës, shkarkimin, nxjerrjen si dhe të dhëna të tjera, por ato duhet të identifikojnë:

- vendndodhjen dhe kufijtë e kategorisë apo kategorive të ujërave nëntokësore,
- presionin me të cilën mund të hasen kategoria/kategoritë ujore nëntokësore, duke përfshirë:

- burimet shpërndarëse të ndotjes

- burimet e ndotjes

- nxjerrjen

- ringarkimin artificial

- karakterin e përgjithshëm të shtresës që shtrihet mbi zonën e grumbullimit nga e cila kategoria ujore nëntokësore merr sërish ngarkesën.

- ato kategori ujore nëntokësore për të cilat ka ekosisteme ujore sipërfaqësore drejtpërsëdrejti të varura ose ekosisteme terrestiale.

### 2.2.Karaktersitika të mëtejshme

Mbas karakterizimit fillestar, shtetet anëtare duhet të nxjerrin dhe karakteristika të atyre kategorive ose grupeve të ujërave nëntokësore të cilat janë identifikuar si në rrezik në mënyrë që të bëhet një vlerësim më i saktë i domethënies së një rreziku të tillë dhe identifikimi i masave që duhet të kërkohen sipas Nenit 11. Këto karakteristika duhet të përfshijnë informacionin përkatës mbi ndikimin e aktivitetit të njerëzve dhe, aty ku duhet, informacion në lidhje me:

- karakteristikat gjeologjike të kategorisë së ujit nëntokësor, duke përfshirë dhe shtrirjen dhe llojin e njësive gjeologjike;

- karakteristikat hidrogjeologjike të kategorisë së ujit nëntokësor duke përfshirë konduktivitetin hidraulik, porozitetin dhe kufizueshmërine;
- karakteristikat e depozitimeve sipërfaqësore në formën e shtresave ujëmbajtëse, nga e cila kategoria e ujit nëntokësor e merr ringarkesën, duke përfshirë trashësinë, porozitetin, konduktivitetin hidraulik dhe aftësitë thithëse të depozitimeve dhe tokës;
- karakteristikat e shtresave të ujit nëntokësor brenda kategorisë së ujit nëntokësor;
- një inventar të sistemeve të sipërfaqeve të shoqëruara, duke përfshirë dhe ekosisteme terrestiale dhe kategori të ujit sipërfaqësor, me të cilin uji nëntokësor është i lidhur në mënyrë dinamike;
- vlerësime të drejtimeve dhe shkallës së shkëmbimit të ujit ndërmjet kategorisë së ujit nëntokësor dhe sistemeve të shoqëruara të sipërfaqes;
- të dhëna të mjaftueshme për të llogaritur shkallën mesatare vjetore afatgjatë të ringarkimit të përgjithshëm;
- karakteristikat e përbërjes kimike të ujit nëntokësor, duke përfshirë dhe specifikimin e kontributeve nga aktiviteti njerëzor. Shtetet anëtare mund të përdorin tipoligjitë për karakterizimin e ujit nëntokësor kur vendosen nivelet bazë natyrore për këto trupa të ujit nëntokësor.

**2.3. Rishikimi i ndikimit të aktivitetit njerëzor tek ujërat nëntokësorë**

Për ato zona te ujërave nëntokësorë, të cilët kalojnë kufirin midis dy ose më shumë shteteve anëtare ose që janë identifikuar në bazë të karakterizimit fillestar të ndërmarrë në përputhje me paragrafin 2.1, duke qënë në rrezik të dështojnë të arrijnë objektivat e caktuara për cdo ent sipas Nenit 4, informacioni i mëposhtem, kur të jetë i përshtatshëm ,do të mblidhet dhe mbahet për cdo prej zonave të ujërave nëntokësore:

a) pozicionimi i pikave në zonën e ujërave nëntokësore për shkëputjen e ujërave me përjashtim të:
- pikave për shkëputjen e ujit duke prodhuar më pak se një mesatare prej 10 $m^3$ në ditë, ose,
- pikave për shkëputjen e ujit për konsumim njerëzor duke prodhuar më pak se një mesatare prej 10 $m^3$ në ditë ose duke u shërbyer më pak se 50 personave,

b) normat mesatare vjetore të shkëputjes prej këtyre pikave,
c) përbërja kimike e ujit, të shkeputur nga zona e ujërave nëntokësore
d) vendndodhja e pikave në zonën e ujërave nëntokësore, në të cilat uji shkarkohet direkt
e) normat e shkarkimit në pika të tilla
f) përbërja kimike e shkarkimeve në zonën e ujërave nëntokësore dhe
g) përdorimi i tokës në ujëmbledhësin ose ujëmbledhësat nga të cilat zona e ujërave nëntokësore merr furnizimin e saj, duke perfshirë edhe inputet ndotëse dhe modifikimet antropogjenike për karakteristikat mbushëse si: uji i shiut dhe shmangiet që humbasin përmes mbylljes së tokës, mbushjes artificiale, digave ose kanaleve kulluese.

**2.4. Rishikimi i ndikimit të ndryshimeve në nivelet e ujërave nëntokësore**

Vendet anëtare gjithashtu do të identifikojnë ato zona të ujërave nëntokësore, objektivat më të ulëta të së cilave do të specifikohen sipas nenit 4, duke përfshirë si rezultat konsiderimin e efekteve të statusit të zonës në:

(i) ujërat sipërfaqësore dhe ekosistemet e shoqëruara tokësore
(ii) rregullimin e ujit, mbrojtjen nga përmbytja dhe drenazhimin e tokës
(iii) zhvillimin njerëzor

**2.5. Rishikimi i ndikimit të ndotjes në cilësinë e ujërave nëntokësore**

Vendet anëtare do të identifikojnë gjithashtu edhe ato zona të ujërave nëntokësore, objektivat minimale të së cilave do të specifikohen sipas nenit 4 ( 5), ku si rezultat i ndikimit të aktivitetit njerëzor, sic është vendosur në përputhje me Nenin 5(1), zona e ujërave nëntokësore është kaq e ndotur, sa që të arrihet statusi kimik optimal i ujërave nëntokësore është e parealizueshme ose në mënyrë disproporcionale e kushtueshme.

**SHTOJCA III**

**ANALIZA EKONOMIKE**

Analiza ekonomike do të përmbajë mjaft informacion me detaje të mjaftueshme (duke marrë parasysh edhe kostot të shoqëruara me mbledhjen e të dhënave të ngjashme) në mënyrë që:

a) të bëjë të dhënat e ngjashme të nevojshme për të marrë në konsideratë, sipas Nenit 9, parimin e rikuperimit të kostove të shërbimeve të ujit, duke patur parasysh parashikimet afatgjata të furnizimit dhe kërkesës për ujë në basenin lumor te rrethit dhe ku në mënyrë të nevojshme:

- vlerëson volumin, cmimet dhe kostot e shoqëruara me shërbimet me ujë dhe
- vlerëson investimin e ngjashëm duke përfshire parashikimet e investimeve të tilla;

b) të gjykojë rreth kombinimit më efektiv të masave përsa u përket përdorimeve të ujit, që të jenë të përfshira në programin e masave sipas Nenit 11 të bazuar në vlerësime të kostove të mundshme të masave të tilla.

## SHTOJCA IV

## ZONAT E MBROJTURA

1. Regjistri i zonave të mbrojtura sipas Nenit 6 do të përfshijë llojet e mëposhtme të zonave të mbrojtura:

(i) zona të përcaktuara për grumbullimin e ujit që synohet për konsumim njerëzor sipas nenit 7;
(ii) zona të përcaktuara për mbrojtjen e specieve ujore ekonomikisht të rëndësishme;
(iii) ente të ujit të percaktuar si ujëra rekreative, duke përfshirë dhe rajonet të përcaktuara si ujëra për larje sipas Direktivës 76/160/EEC
(iv) zonat ushqyese sensitive, duke përfshirë zona të përcaktuara si vulnerabile sipas direktivës 91/676/EEC dhe zonave të përcaktuara si zona sensitive nën direktivën 91/271/EE dhe
(v) zona të përcaktuara për mbrojtjen e mjediseve ose specieve ku mirëmbajtja ose përmirësimi i statusit (gjendjes) së ujit është një fakor i rëndësishëm në mbrojtjen e tyre, duke përfshirë edhe vendet relevante Natura 2000, të përcaktuara sipas Direktivës 92/43/EEC

2. Përmbledhja e regjistrit e kërkuar, si pjesë e planit manaxhues të basenit lumor, do të përfshijë harta që tregojnë vendndodhjen e cdo zone të mbrojtur dhe një përshkrim të Komunitetit, legjislacionit kombëtar ose lokal, në bazë të të cilëve ata janë përcaktuar.

## SHTOJCA V

## 1. STATUSI I UJIT SIPËRFAQËSOR

### 1.1 Elementët e cilësisë për klasifikimin e statusit ekologjik

1.1.1 Lumenjtë
1.1.2 Liqenet
1.1.3 Ujërat tranzite (kalimtare)
1.1.4 Ujërat bregdetarë
1.1.5 Entet ujorë sipërfaqësore artificiale dhe shumë të modifikuar

### 1.2 Përkufizime normative të klasifikimeve te statusit ekologjik

1.2.1 Përkufizime për statusin e lartë, të mirë dhe të moderuar ekologjik në lumenj
1.2.2 Përkufizime për statusin e lartë, të mirë dhe të moderuar ekologjik në liqene
1.2.3 Përkufizime për statusin e lartë, të mirë dhe të moderuar në ujërat tranzite (kalimtare)
1.2.4 Përkufizime për statusin e lartë, të mirë dhe të moderuar ekologjik në ujërat bregdetare
1.2.5 Përkufizime për potencialin ekologjik maksimal, të mirë dhe të moderuar për entet ujorë tepër të moderuar ose artificiale
1.2.6 Procedura për caktimin e standarteve kimike të cilësisë nga shtetet anëtare

### 1.3 Monitorimi i statusit ekologjik dhe statusit kimik për ujërat sipërfaqësore

1.3.1 Projektimi i monitorimit mbikqyrës
1.3.2 Projektimi i monitorimit operacional
1.3.3 Projektimi i monitorimit hetues
1.3.4 Frekuenca e monitorimit
1.3.5 Kërkesa shtesë monitoruese për zonat e mbrojtura
1.3.6 Standartet për monitorimin e elementëve të cilësisë

### 1.4 Klasifikimi dhe prezantimi i statusit ekologjik

1.4.1 Krahasueshmëria e rezultateve monitoruese biologjike
1.4.2 Paraqitja e rezultateve monioruese dhe klasifikimi i statusit ekologjik e potencialit ekologjik
1.4.3 Paraqitja e rezultateve monitoruese dhe klasifikimi i statusit kimik

2. UJËRAT NËNTOKËSORË

**Statusi sasior i ujërave nëntokësore**

Parametri për klasifikimin e statusit sasior
Përkufizimi i statusit sasior

**Monitorimi i statusit sasior të ujërave nëntokësore**

Rrjeti monitorues i nivelit të ujërave nëntokësore
Densiteti i vendeve monitoruese
Frekuenca monitoruese
Interpretimi dhe prezantimi i statusit sasior të ujërave nënujore

**Statusi kimik i ujërave nëntokësore**

Parametrat për caktimin e statusit kimik të ujërave nëntokësore
Përkufizimi i statusit të mirë kimik të ujërave nëntokësore

**Monitorimi i statusit kimik të ujërave nëntokësore**

Rrjeti monitorues i ujërave nëntokësore
Monitorimi mbikqyrës
Monitorimi operacional
Identifikimi i tendencave tek ndotësit
Interpretimi dhe prezantimi i statusit kimik të ujërave nëntokësore

**Paraqitja e statusit të ujërave nëntokësore**

1. STATUSI I UJIT SIPËRFAQËSOR

Elementet e cilësisë për klasifikimin e statusit ekologjik

1.1.1. Lumenjtë

Elementet biologjikë
Përbërja dhe shumellojshmëria e florës ujore
Përbërja dhe shumellojshmëria e faunës bentike jovertebrore
Përbërja, shumëllojshmëria dhe struktura e moshës e faunës së peshqve

Elementët hidromorfologjikë në mbrojtje të elementeve biologjike

Regjimi hidrologjik
Sasia dhe dinamika e rrjedhës së ujit
Lidhja me ente të ujërave nëntokësore
Vazhdimësia e lumit

Kushtet morfologjike
Ndryshimi i thellësisë dhe gjerësisë së lumit
Struktura dhe nënshtresat e shtratit te lumit
Struktura e zonës bregore

Elementet kimikë dhe fiziko-kimikë që mbështesin elementët biologjike

Të përgjithshme

Kushtet termale
Kushtet e oksigjenimit
Kripësia
Statusi acidimit
Kushtet ushqyese

Ndotësit specifikë

Ndotje prej substancave kryesore, ndërsa derdhen në zonën e ujëmbledhësit
Ndotje nga substanca të tjera të derdhura ne sasi sinjifikante në entin e ujit.

1.1.2 Liqenet

Elementet biologjike

Përbërja, shumellojshmëria dhe biomasa e fitoplanktonit

Përbërja dhe shumellojshmëria i florës tjetër ujore
Përbërja dhe shumëllojshmëria e faunës bentike jovertebrore
Përbërja, shumellojshmëria dhe struktura e moshës së faunës së peshqve

Elementët hidro-morfologjikë duke mbështetur elementet biologjikë

Regjimi hidrologjik
Sasia dhe dinamika e rrjedhës së ujit
Koha e qëndrimit
Lidhja me entin e ujërave nëntokësore
Kushtet morfologjike
Ndryshimi i thellësisë së liqenit
Sasia, struktura dhe nënshtresat e shtratit të liqenit
Struktura e bregut të liqenit

Elementet kimike dhe fiziko-kimike duke mbështetur elementët biologjikë

Të përgjithshme
Transparenca
Kushtet termale
Kushtet e oksigjenimit
Kripësia
Statusi(nivelli) acid
Kushtet ushqyese

Ndotësit specifikë

Ndotje nga të gjitha substancat kryesore, ndërsa derdhen në entin e ujit
Ndotje nga substanca të tjera të derdhura në sasi domethënëse në entin e ujit.

1.1.3 Ujërat kalimtare

Elementet biologjike

Përbërja, shumëllojshmëria dhe biomasa e fitoplanktonit
Përbërja dhe shumëllojshmëria e florës tjetër ujore
Përbërja dhe shumëllojshmëria e faunës bentike jovertebrore
Përbërja dhe shumëllojshmëria e faunës së peshqve

Elementet hidro-morfologjike duke mbështetur elementet biologjikë

Kushtet morfologjike
Ndryshimi i thellësisë
Sasia, struktura dhe përbërja e shtratit
Struktura e zonës ndërbaticore

Regjimi vjetor i prurjeve

Rrjedha e ujërave të ëmbla
Ekspozimi i valës

Elementet kimike dhe fiziko-kimike duke mbështetur elementet biologjike

Të përgjithshme

Transparenca
Kushtet termale
Kushtet e oksigjenimit
Kripësia
Kushtet ushqyese

Ndotësit specifikë

Ndotje prej substancave parësore të identifikuara si të derdhura në trupin e ujit.
Ndotje nga të gjitha substancat e identifikuara si të derdhura në sasi të konsiderueshme në entin e ujit.

1.1.4. Ujërat bregdetare

Elementet biologjikë

Përbërja, shumëllojshmëria dhe biomasa e fitoplanktonit
Përbërja dhe shumëllojshmëria e florës ujore
Përbërja dhe shumëllojshmëria e faunës bentike jovertebrore

Elementët hidromorfologjikë duke mbështetur elementët biologjikë

Kushtet morfologjike

Ndryshimi i thellësisë
Struktura dhe nënshtresat e shtratit bregdetar
Struktura e zonës interdale (ndërbaticore)

Regjimi prurjes vjetore

Drejtimi i korrenteve dominante
Ekspozimi i valës

Elementët kimikë dhe fiziko-kimikë duke mbështetur elementet biologjikë

Të përgjithshme

Transparenca
Kushtet termale
Kushtet oksigjenuese
Kripësia
Kushtet ushqyese

Ndotësit specifikë

Ndotja nga të gjitha substancat parësore të identifikuara si të derdhura në entin e ujit
Ndotja nga substanca të tjera të identifikuara si të derdhura në sasi të konsiderueshme në entin e ujit

1.1.5. Entet ujorë sipërfaqësore artificialë dhe tepër të modifikuar

Elementet e cilësisë të aplikueshëm në entet ujore sipërfaqësore artificiale dhe tepër të modifikuar do të jenë ato që janë të aplikueshme tek secila nga katër kategoritë e ujërave sipërfaqësore natyrale të mësipërme e që më tepër i ngjan entit të ujit sipërfaqësor, artificial ose tepër të modifikuar në fjalë.

1.2. Përkufizime normative të klasifikimeve të statusit ekologjik

Tabela 1.2 Përkufizime të përgjithshme për lumenjtë, liqenet, ujërat kalimtare dhe ujërat bregdetare

Teksti i mëposhtëm jep një përkufizim të cilësisë ekologjike. Për qëllim të klasifikimit, vlerat e elementeve të cilësisë të statusit ekologjik për cdo kategori të ujërave sipërfaqësore janë ato që jepen në tabelat 1.2.1-1.2.4 si më poshtë;

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
|---|---|---|---|
| Të përgjithshme | Nuk ka, ose ka fare pak ndryshime antropogjenike tek vlera e elementeve cilësore fiziko-kimike dhe hidromorfologjike për llojet e enteve të ujërave sipërfaqësore nga ato që zakonisht shoqërohen me atë lloj në kushte të pangacmuara.<br><br>Vlerat e elementeve cilësorë biologjikë për entin e ujërave sipërfaqësorë reflekton ato që zakonisht shoqërohen me atë tip në kushte të pashqetësuara dhe nuk tregojnë, ose tregojnë fare pak evidencë shtrembërimi.<br><br>Këto janë kushtet tip-specifike të llojeve dhe komunitetet. | Vlerat e elementeve cilësorë biologjike për llojin e entit të ujit sipërfaqësor tregojnë nivele të ulëta shtrembërimi si rezultat i aktivitetit njerëzor, por devijojnë paksa nga ato normale të shoqëruara me llojin e entit të ujërave sipërfaqësore në kushte të pangacmuara. | Vlerat e elementëve cilësorë biologjikë për llojin e enteve të ujërave sipërfaqësore shmangen në mënyrë të moderuar nga ato normalisht të shoqëruara me llojin e enteve të ujërave sipërfaqësorë në kushte të pangacmuara. Vlerat tregojnë shenja moderuese të shtrembërimit si rezultat i aktivitetit njerëzor dhe janë në mënyrë domethënëse më të shqetësuar sesa në kushte të statusit të mirë. |

Ujërat që arrijnë një status nën i moderuar, do të klasifikohen si të varfëra apo të këqija.

Ujërat që tregojnë evidencë të ndryshimeve të mëdha të vlerave të elementëve cilësorë biologjikë për llojin e enteve të ujërave sipërfaqësore dhe në të cilat komunitete biologjike relevante devijojnë në mënyrë substanciale nga ato normalisht të shoqëruara me llojin e entit të ujërave sipërfaqësore në kushte të pangacmuara, do të klasifikohen si të dobëta (të varfëra).

Ujërat që tregojnë evidencë të ndryshimeve të mëdha të vlerave të elementëve cilësore biologjike për llojin e entit të ujërave sipërfaqësore dhe në të cilat sasi të mëdha të komuniteteve relevante biologjike, normalisht të shoqëruara me llojin e enteve te ujëave sipërfaqësore në kushte të pangacmuara mungojnë, do të trajtohen si të këqija.

1.2.1 Përkufizime për statusin ekologjik të lartë, të mirë, të moderuar në lumenj.

Elementët cilësorë biologjikë

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
|---|---|---|---|
| Fitoplanktoni | Përbërja taksonomike e fitoplanktonit i korrespondon totalisht ose përafërsisht totalisht kushteve të pacënuara.<br>Shumëllojshmëria mesatare e fitoplanktonit është tërësisht në përputhje me kushtet fiziko-kimike, tip-specifike dhe nuk është i tillë që të ndryshojnë në mënyrë domethënëse kushtet tip-specifike të transparencës.<br>Shtimi planktonik ndodh në atë frekuencë dhe intensitet, i cili është në përputhje me kushtet tip-specifike fiziko-kimike. | Ndodhin ndryshime të vogla në përbërjen dhe sasinë e taksa planktonik të krahasuar me komunitetet tip-specifike. Ndryshime të tilla nuk tregojnë ndonjë rritje të shpejtë të algave që të rezultojnë më pas në shqetësime të padëshirueshme të balancës së organizmave të pranishëm në entin ujor ose në cilësinë fiziko-kimike të ujit ose sedimentit.<br>Një rritje e vogël në frekuencë dhe intensitet të shtimit tip-specifik planktonik mund të ndodhë. | Përbërja e taksa planktonik ndryshon në mënyrë të moderueshme nga komunitetet tip-specifike.<br>Sasia është moderativisht e ngacmuar dhe mund të jetë e tillë të prodhojë një shqetësim domethënës të padëshirueshëm në vlerat e elementeve të tjera cilësorë biologjikë dhe fiziko-kimikë.<br>Një ngritje e moderueshme në frekuencë dhe intensitet të shtimit planktonik mund të ndodhë. Shtime të vazhdueshme mund të ndodhin gjatë muajve të verës.. |
| Makrofitet dhe fitobentos | Përbërja taksonomike i korrespondon totalisht ose pothuajse totalisht kushteve të pacënuara.<br>Nuk ndodhin ndryshime të vërejtura në sasinë mesatare makrofitike dhe atë mesatare fitobentike. | Ka pak ndryshime në përbërjen dhe sasinë e taksa makrofitike dhe fitobentike, të krahasuar me komunitetet tip-specifike. Ndryshime të tilla nuk tregojnë ndonjë rritje drastike të fitobentosit ose forma më të larta të jetës së bimëve që rezultojnë në shqetësime të padëshiruehme të balancës së organizmave prezent në entin e ujit ose të cilësisë fiziko-kimike të ujit ose sedimentit. | Përbërja taksa makrofitike dhe fitobentike ndryshon në mënyrë të moderueshme nga komuniteti tip-specifik dhe është më i shpërfytyruar sesa në status të mirë.<br>Ndryshime të moderuara në bollëkun mesatar makrofitik dhe atë mesatar fitobentik janë të qarta.<br>Komuniteti fitobentik mund te ndërhyhet me dhe në disa zona, të zëvendësohet nga tufa dhe shtresa bakteriale të pranishme si rezultat i aktiviteteve antropogjenike. |
| Fauna bentike jovertebrore | Përbërja taksonomike dhe sasia korrespondojnë totalisht ose pothuajse totalisht në kushte të pashqetësuara.<br>Raporti i shqetësimit taksa sensitive me taksa josensitive nuk tregon ndonjë shenjë të ndryshimit nga nivelet e pashqetësuara.<br>Niveli i diversitetit të taksa jovertebrore nuk tregon ndonjë shenjë të ndryshimit nga nivelet e pandryshueshme. | Ka ndryshime të pakta në përbërjen dhe sasinë e taksa invertebrate me komunitetet tip-specifike.<br>Raporti i taksa shqetësuese-sensitive tregon ndryshime të pakta nga nivelet tip-specifike.<br>Niveli i ndryshueshmërisë të taksa jovertebrorë tregon shenja të pakta të ndryshimit nga nivelet tip-specifike. | Përbërja dhe sasia e taksa invertebrateve ndryshon në mënyrë të moderueshme nga komunitetet tip-specifike.<br>Grupe të mëdha taksonomike të komunitetit tip-specifik mungojnë.<br>Raporti i shqetësimit taksa sensitive me taksa jo-sensitive dhe niveli i diversitetit, janë substancialisht më të ulëta sesa për statusin e mirë. |

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
|---|---|---|---|
| Fauna e peshqve | Përbërja e specieve dhe sasia i korrespondon totalisht ose pothuajse totalisht kushteve të pangacmuara.<br>Të gjitha speciet tip-specifike të ngacmuara-sensitive janë të pranishme.<br>Strukturat e moshës të komuniteteve të peshqve tregojnë shenja të pakta të ngacmimeve antropogjenike dhe nuk janë indikative për një dështim në riprodhim ose për zhvillimin e ndonjë specieje të vecantë. | Ka ndryshime të vogla në përbërje dhe sasi nga komunitetet tip-specifike, të atribueshme tek impaktet antropogjenike për elementët cilësorë fiziko-kimikë dhe hidromorfologjikë.<br>Strukturat e moshës së komuniteteve të peshqve tregojnë shenja ngacmimi, si pasojë e impakteve antropogjenike në elementët fiziko-kimikë ose ato hidromorfologjikë cilësorë dhe në pak raste janë tregues i një dështimi në riprodhimin ose zhvillimin e specieve të veçanta, deri në atë pikë sa disa klasa moshore mund të mungojnë. | Përbërja dhe sasia e specieve të peshqve ndryshon moderativisht nga komunitetet tip-specifike, që i atribuohet impakteve antropogjenike për elementët cilësorë fiziko- kimike ose atyre cilësorë hidromorfologjikë.<br>Struktura e moshës e komuniteteve të peshqve tregon shumë shenja të ngacmimeve antropogjenike, deri në pikën që një proporcion i moderuar i specieve të llojit specific mungon ose është në një sasi shumë të ulët. |

Elementet cilësorë hidromorfologjikë

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
|---|---|---|---|
| Regjimi hidrologjik | Sasia dhe dinamika e rrjedhës dhe lidhja e rezultante tek ujërat nëntokësore, reflekton totalisht, ose pothuajse totalisht, kushtë të pangacmuara. | Kushte në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. | Kushte në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. |
| Vazhdimësia e lumit | Vazhdimësia e lumit nuk shqetësohet nga aktivitetet antropogjenike dhe lejon migrimin e pashqetësuar të organizmave ujore dhe transportin e sedimentit. | Kushte në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. | Kushte në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. |
| Kushtet morfologjike | Llojet e kanaleve, ndryshimi i gjerësisë dhe thellësisë shpejtësia e rrjedhës, kushtet shtresore dhe të dyja, struktura dhe kushtet e zonave bregore korrespondojnë plotësisht ose pothuajse plotësisht tek kushtet e pangacmuara. | Kushte në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. | Kushte në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. |

Elementet cilesorë fiziko-kimikë.(1)

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
|---|---|---|---|
| Kushte të përgjithshme | Vlerat e elementëve fiziko-kimike korrespondojnë plotësisht ose pothuajse plotësisht tek kushtet e pangacmuara.<br>Koncentratët ushqyes ngelen brenda normës, zakonisht të shoqëruar me kushte jo të ngacmuara.<br>Nivelet e kripësisë, pH, balancës së oksigjenit, kapacitetit neutralizues të acidit dhe temperatura nuk tregojnë shenja të ngacmimit antropogjenik dhe ngelen brenda normës zakonisht të shoqëruar me kushte të pangacmuara. | Temperatura, balanca e oksigjenit, kapaciteti acid neutralizues dhe kripësia nuk arrijnë nivele jashtë normës të krijuar për të siguruar funksionimin e ekosistemit tip-specifik dhe arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët biologjik, cilësorë. | Kushte në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet cilësorë biologjikë. |
| Ndotës specifikë sintetikë | Përqëndrime afër zeros dhe të paktën poshtë limiteve të zbulimit të teknikave më të avancuara analitike në përdorim të përgjithshëm. | Përqëndrimet jo më tepër se standartet e vendosura, në përputhje me procedurat e detajuara në seksionin 1.2.6, pavarësisht nga Direktiva 91/414/EC dhe Direktiva 98/8/EC. (<EQS). | Kushte në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet cilësorë biologjikë. |
| Ndotës specifik josintetikë | Përqëndrimet ngelen brenda normës, zakonisht të shoqëruar me kushte të pangacmuara (nivelet e sfondit= bgl) | Përqëndrimet jo më tëpër se standartet e vendosura në përputhje me procedurat e detajuara ne seksionin 1.2.6(2) pavarësisht nga Direktiva91/414EC dhe Direktiva 98/8/EC. (<EQS). | Kushte në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet cilësorë biologjikë. |

1) Shkurtimet e mëposhtme janë përdorur; bgl= niveli i sfondit, EQS= standarti cilësor mjedisor

2) Aplikimet e standarteve të ardhura sipas këtiij protokolli, nuk do të kërkojnë reduktim të përqëndrimeve ndotëse poshtë niveleve të sfondit(EQS>bgl)

1.2.2 Përkufizime për statusin ekologjik të lartë, të mirë, dhe të moderuar në liqene
Elementë cilësorë biologjikë

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
|---|---|---|---|
| Fitoplanktoni | Përberja taksonomike dhe sasia e fitoplanktonit i korrespondon plotësisht ose pothuajse plotësisht kushteve të pangacmuara.<br>Biomasa mesatare e fitoplanktonit është në përputhje me kushtet tip-specifike fiziko-kimike dhe nuk është e tillë që të ndryshojë në mënyrë të dukshme kushtet tip-specifike të transparencës.<br>Lulëzimi i planktonit ndodh me një frekuencë dhe intensitet i cili është në përputhje me kushtet tip-specifike kimiko-fizike. | Ka ndryshime të pakta në përberjen dhe sasinë e taksa planktonit në krahasim me komunitetet tip-specifike. Ndryshime të tilla nuk tregojnë ndonjë rritje të shpejtë të algave, duke rezultuar në shqetësim të padashur të balancës së organizmave të pranishëm në entet ujorë ose në cilësinë fiziko-kimike të ujit apo sedimentit.<br>Një rritje e vogël në frekuencë dhe intensitet të lulëzimit tip-specifik planktonik mund të ndodhë. | Përbërja dhe sasia e taksa planktonit ndryshon në mënyrë të moderuar nga komunitetet tip-specifike.<br>Biomasa është moderueshëm e ngacmuar dhe mund të prodhojë një ngacmim kuptimplotë ngacmues në kushtet e elementeve të tjerë cilësorë biologjikë dhe të cilësisë fiziko-kimike të ujit ose sedimentit. |
| Makrofitet<br>dhe fitobentos | Përbërja taksonomike i korrespondon plotësisht ose pothuajse plotësisht kushteve të pangacmuara.<br>Nuk ka ndryshime të vërejtura në sasinë mesatare makrofitike dhe ate mesatare fitobentike. | Ka ndryshime të vogla në përbërjen dhe sasinë e taksa makrofitike dhe fitobentike, të krahasuar me komunitetet tip-specifike. Ndryshime të tilla nuk tregojnë ndonjë rritje të fitobentos ose të formave më të larta të jetës bimore që rezultojnë në ngacmim të padëshirueshëm të balancës së organizmave të pranishme në entet ujorë ose në cilësinë fiziko-kimike të ujit.<br>Komuniteti fitobentik nuk është ndikuar armiqësisht nga tufat e shtresat bakteriale të pranishme si rezultat i aktivitetit antropogjenik. | Përbërja e taksa makrofitike dhe fitobentike ndryshojnë nga komunitetet tip-specifik dhe janë më të shpërqëndruara sesa ato të vëzhguara në cilësi të mirë.<br>Ndryshime të moderuara në sasinë mesatare makrofitike dhe fitobentike janë të dukshme.<br>Komuniteti fitobentik mund të ndërhyhet me dhe në disa zona zëvendësohet nga tufa apo shtresa bakteriale, rezultat i aktiviteteve antropogjenike. |
| Fauna betike<br>jovertebrore | Përbërja taksonomike dhe sasia i korrespondojnë plotësisht ose pothuajse plotësisht kushteve të pangacmuara.<br>Raporti i taksa ngacmimit sensitiv ndaj atij josensitiv nuk tregon ndonjë shenjë të ndryshimit nga nivelet e pangacmuar.<br>Niveli i diversitetit i taksa jovertebrore nuk tregon ndonjë shenjë të ndryshimit nga nivelet e pangacmuar. | Ka pak ndryshime në përbërjen dhe sasinë e taksa invertebrate të krahasuar me komunitetet tip-specifike.<br>Raporti i taksa ngacmimit sensitive ndaj asaj jo sensitive tregon shenja te lehta të ndryshimit nga nivelet tip-specifike.<br>Niveli i diversitetit të taksa invertebrate tregon shenja te lehta të ndryshimit nga nivelet tip-specifike. | Përbërja dhe sasia e taksa makrofitike dhe fitobentike ndryshojnë moderueshëm nga kushtet tip-specifike.<br>Grupe të mëdha taksonomike të komunitetit tip-specifik mungojnë.<br>Raporti i taksës sensitive dhe asaj josensitive të ngacmimit dhe niveli i diversitetit janë thelbësisht më të ulëta se niveli tip-specifik dhe më të ulëta sesa për statusin e mirë. |

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
|---|---|---|---|
| Fauna e peshqve | Përbërja e specieve dhe sasia i korrespondojnë plotësisht ose pothuajse plotësisht kushteve të pangacmuara.<br>Të gjitha speciet sensitive tip-specifike janë të pranishme.<br>Strukturat e moshës të komuniteteve të peshqve tregojnë shenja të pakta të ngacmimit antropologjik dhe nuk janë tregues të dështimit në riprodhimin ose zhvillimin e specieve të vecanta. | Ka ndryshime të vogla në përbërjen dhe sasinë nga komunitetet tip-specifike, të dedikuara impakteve antropogjenike mbi elementët fiziko-kimikë ose elementëve cilësorë hidromorfologjikë.<br>Strukturat e moshës të komuniteteve të peshqve tregojnë shenja të ngacmimeve, si rrjedhojë e impakteve antropogjenike mbi elementët fiziko-kimikë ose ata cilësorë hidromorfologjikë dhe në pak raste janë tregues të dështimit në riprodhimin ose zhvillimin e specieve të vecanta , deri në atë pikë sa disa klasa moshore të mungojnë. | Përbërja dhe sasia e specieve të peshqve ndryshon moderueshëm nga komunitetet e specieve të peshqve të atribuara impakteve antropogjenike mbi elementët fiziko-kimikë ose atyre cilësorë hidromorfologjikë.<br>Struktura e moshës së komuniteteve të peshqve tregon shenja të dukshme të mëdha të ngacmimit, si rrjedhojë e impakteve antropogjenike mbi elementë fiziko-kimikë ose ato cilësorë hidromorfologjikë, deri në masën që një proporcion i moderuar i specieve tip-specifik të mungojë ose të jetë në sasi shumë të ulët. |

Elementët cilësorë hidromorfologjikë

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
|---|---|---|---|
| Regjimi hidrologjik | Sasia dhe dinamika e rrjedhës, niveli, koha e rezidencës dhe lidhja e rezultantes me ujërat nëntokësore reflektojnë plotësisht ose pothuajse plotësisht kushte të pangacmuara. | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. |
| Kushtet morfologjike | Ndryshimi i thellësisë së liqenit, sasia dhe struktura e nënshtresave dhe struktura dhe kushtet e zones bregdetare të liqenit korrespondojnë plotësisht ose pothuajse plotësisht të gjitha kushteve të pangacmuara. | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. |

Elementët cilësorë fiziko-kimikë (1)

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
|---|---|---|---|
| Kushte të përgjithshme | Vlerat e elementeve fiziko-kimikë korrespondojnë totalisht ose pothuajse totalisht tek kushtet e pangacmuara.<br>Përqëndrimet ushqyese mbeten brenda normës të shoqëruara me kushte të pangacmueshme.<br>Nivelet e kripës, pH, balanca e oksigjenit, kapaciteti acid neutralizues, transparenca dhe temperatura nuk tregojnë ndonjë shenjë të ngacmimit antropologjik dhe ngelen brenda normës së zakonshme, të shoqëruara me kushte të pangacmuara. | Temperatura, balanca e oksigjenit, pH, kapaciteti acid neutralizues, transparenca dhe kripësia nuk arrijnë nivelet jashtë normës të krijuar për të siguruar funksionimin e ekosistemit dhe arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë.<br>Përqëndrimet ushqyese nuk i tejkalojnë nivelet e krijuara për të siguruar funksionimin e ekosistemit dhe arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët biologjikë cilësorë. | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. |
| Ndotës specifikë sintetikë | Përqëndrime afër zeros dhe të paktën poshtë limiteve të detektimit të teknikave më të zhvilluara analitike në përdorim të përgjithshëm. | Përqëndrimet jo në tejkalim të standardeve të vendosura në përputhje me procedurat e detajuara në seksionin 1.2.6, pavarësisht Direktivës 91/414/EC dhe Direktivës 98/8/EC (<EQS) | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë |
| Ndotës specifikë josintetikë | Përqëndrimet mbeten brenda normës, normalisht të shoqëruara me kushte të pangacmuara (niveli i sfondit=bgl) | Përqëndrimet jo në tejkalim të standardeve te vendosura në përputhje me procedurat e detajuara në seksionin 1.2.6 (2) pavaresisht direktivës 91/414EC dhe Direktivës 98/8/EC. (<EQS) | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë |

1) Shkurtimet e mëposhtme janë përdorur: bgl= niveli i sfondit, EQS= standard cilësor mjedisor
2) Aplikimi i standardeve të përftuara në këtë protokoll nuk do të kërkojnë reduktim të përqëndrimeve të ndotësve nën nivelet e sfondit (EQS>bgl)

1.2.3 Përkufizime për statusin e lartë, të mirë dhe të moderuar ekologjik në ujërat tranzitore
Elementët cilësorë biologjik

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
|---|---|---|---|
| Fitoplankton | Përbërja dhe sasia e taksa fitoplanktonike janë në përputhje me kushtet e pangacmuara.<br>Biomasa mesatare fitoplankton është në përputhje me kushtet tip-specifike, kimiko-fizike dhe nuk është e tillë që të ndryshojë ndjeshëm kushtet e transparencës tip-specifike.<br>Lulëzimi planktonik ndodh me një frekuencë dhe intensitet i cili është në përputhje me kushtet tip-specifike fiziko-kimike. | Ka ndryshime të pakta në përbërjen dhe sasinë e taksa fitoplanktonik.<br>Ka ndryshime të vogla në biomasën krahasuar me kushtet tip-specifike. Ndryshime të tilla nuk tregojnë ndonjë rritje të ndjeshme të algave duke rezultuar në ngacmim të padëshiruar të balancës së organizmave të pranishëm në entet ujore ose në cilësinë fiziko-kimike të ujit.<br>Një rritje e lehtë frekuence dhe intensitet të lulëzimit tip-specifik planktonik mund të ndodhë. | Përbërja dhe sasia e taksa fitoplanktonike ndryshon nga kushtet tip-specifike.<br>Biomasa është ngacmuar dhe mund të prodhojë si rrjedhim një ngacmim të rëndësishëm të padëshirueshëm në kushtet e elementëve të tjerë cilësorë biologjikë.<br>Një rritje e moderuar në frekuencë dhe në intensitet të lulëzimit planktonik mund të ndodhë. Lulëzime të vazhduesme mund të ndodhin gjatë muajve të verës. |
| Makroalgat | Përbërja e taksa makroagal është në përputhje me kushtet e pangacmuara.<br>Nuk ka ndryshime në shtresën e makroagal si rrjedhojë e aktiviteteve antropogjenike. | Ka ndryshime të vogla në përbërje dhe sasi të taksa makroalgal krahasuar me komunitetet tip-specifik. Ndryshime të tilla nuk tregojnë ndonjë rritje të ndjeshme të fitobentos apo të formave më të larta të jetës së bimëve, duke rezultuar në ngacmime të padëshirueshme të balancës të organizmave të pranishme në entin ujor ose në cilësinë fiziko-kimike të ujit. | Përbërja e taksa makroalgal ndryshon nga kushtet tip-specifike dhe është më e çrregullt sesa në cilësi të mirë. |
| Angiosperma | Përbërja taksonomike korrespondon plotësisht ose pothuajse plotësisht në kushtet e pangacmuara.<br>Nuk ka ndryshime në sasinë e agispermës si rrjedhojë e aktiviteteve antropogjenike. | Ka ndryshime të vogla në përbërjen e taksa angiospermës të krahasuar me komunitetet tip-specifike.<br>Sasia e angiospermës tregon shenja të lehta të ngacmimit. | Përbërja e taksa angiospermës ndryshon nga komunitetet tip-specifike dhe është mjaft më e ngacmuar sesa në cilësi të mirë.<br>Ka ngacmime ne sasinë e taksa angiospermës. |

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
|---|---|---|---|
| Fauna bentike invertebrale | Niveli i diversitetit dhe mjaftueshmëria e taksasë invertebrale është brenda gamës, normalisht e shoqëruar me kushte të pangacmuara<br><br>Të gjitha taksasë që janë të ndjeshme ndaj shqetësimeve të shoqëruara me kushtet të pangacmuara janë të pranishme. | Niveli i diversitetit dhe mjaftueshmëria e taksasë invertebrale është lehtësisht janshtë gamës, e shoqëruar me kushtet specifike të llojit<br><br>Pjesa më e madhe e taksasë të komuniteteve të llojeve specifike janë të pranishme. | Niveli i diversitetit dhe mjaftueshmëria e taksasë invertebrale është disi jashtë gamës, e shoqëruar me kushte specifike të llojit<br><br>taksasë që dëshmojnë ekzistencën e e ndotjes janë të pranishme.<br><br>Mjaft nga taksasë e ndjeshme të komuniteteve specifike të llojeve nuk janë të pranishme. |
| Fauna e peshqve | Përbërja dhe mjaftueshmëria e specieve është e lidhur me kushtet të pangacmuara. | Mjaftueshmëria e specieve të ndjeshme ndaj shqetësimeve tregon shenja të lehta të prishjes së kushteve specifike të llojit si rezultat i ndikimeve antropologjike mbi elementet fiziko-kimike ose hidromorfologjike. | Një pjesë normale e specieve të llojit specifik që lidhen me ndjeshmërinë e shqetësimit, nuk janë të pranishme si rezultat i ndikimeve antropogjenike mbi elementet e cilësisë fiziko-kimike dhe hidromorfologjike. |

*Elementet e cilësisë hidromorfologjike*

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
|---|---|---|---|
| Regjimi i prurjeve | Regjimi i rrjedhjes së ujit të ëmbël korrespondon totalisht ose pothuajse totalisht me kushtet të pangacmuara. | Kushtet janë në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më lart për elementet e cilësisë bologjike. | Kushtet janë në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara në lart për elementet e cilësisë biologjike. |
| Kushtet morfologjike | Ndryshime të thellësisë, kushte nënshtresore; si struktura ashtu dhe kushti i zonave të prurjeve korrespondon | Kushtet janë në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më lart për elementet e cilësisë bologjike. | Kushtet janë në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më lart për elementet e cilësisë biologjike. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | plotësisht ose pothuajse plotësisht me kushtet joshqetësuese. | | |
| Kushtet e përgjithshme | Elementet fiziko-kimike korrespondojnë plotësisht ose pothuajse plotësisht me kushtet e pangacmuara.<br><br>Përqëndrimet ushqyese mbeten brenda gamës që normalisht shoqërohet me kushtet e pangacmuara.<br><br>Temperatura, balanca e oksigjenit dhe transparenca nuk tregojnë shenja të shqetësimeve antropogjenike dhe mbeten brenda gamës që normalisht shoqërohet me kushtet të pangacmuara. | Temperatura, kushtet e oksigjenimit dhe transparenca nuk i arrijnë nivelet jashtë gamave e vendosura në mënyrë që të sigurohet funksionimi i ekosistemeve dhe arritja e vlerave të specifikuara më lart për elemteve të cilësisë biologjike.<br><br>Përqëndrimet ushqyese nuk i kalojnë nivelet e vendosura në mënyrë që të sigurojnë funksionimin e ekosistemeve dhe arritjen e vlerave të specifikuara më lart për elementët e cilësisë biologjike. | Kushtet janë në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më lart për elementet e cilësisë biologjike. |
| Ndotës të veçantë sintetikë | Përqëndrimet janë afër zeros ose të paktën nën kufijtë e zbulimit të teknikave më të avancuara analitike në përdorimin e përgjithshëm. | Përqëndrimet nuk shkojnë përtej standardeve të përcaktuara në përputhje me procedurën e detajuara në seksionin 1.2.6, pa paragjykim në Direktivën 91/414/EC dhe Direktivën 98/8/EC ( më I madh se EQS) | Kushtet janë në përputhje me arritjen e vlerave specifike të dhëna më lart rreth elementëve të cilësë biologjike. |
| Ndotësit e veçantë jo-sintetikë | Përqëndrimet mbeten brenda gamës që normalisht shoqërohet me kushte të pangacmuara (nivelet bazë = bgl). | Përqëndrimet nuk i kalojnë standardet e përcaktuara në përputhje me procedurën e detajuar në seksionin 1.2.6 (1) pa paragjykime mbi Direktivën 91/414/EC dhe Direktivën 98/8/EC (më e madhe se EQS) | Kushtet janë në përputhje me arritjen e vlerave specifike të dhëna më lart rreth elementëve të cilësisë biologjike. |

1) Shkurtimet e mëposhtme janë përdorur: bgl= niveli i sfondit, EQS= standard cilësor mjedisor
2) Aplikimi i standardeve të përftuara nën këtë protokoll nuk do të kërkojnë reduktim të përqëndrimeve të ndotësve nën nivelet e sfondit (EQS>bgl)

1.2.3 Përkufizime për statusin e lartë, të mirë dhe të moderuar ekologjik në ujërat bregdetare
Elementët cilësorë biologjikë

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
|---|---|---|---|
| Fitoplanktoni | Përbërja dhe sasia e taksa fitoplanktonike janë në përputhje me kushtet e pangacmuara.<br><br>Biomasa mesatare fitoplankton është në përputhje me kushtet tip-specifike, kimiko-fizike dhe nuk është e tillë që të ndryshojë ndjeshëm kushtet e transparencës tip-specifike.<br><br>Lulëzimi planktonik ndodh me një frekuencë dhe intensitet i cili është në përputhje me kushtet tip-specifike fiziko-kimike. | Ka ndryshime të pakta në përbërjen dhe sasinë e taksa fitoplanktonik.<br><br>Ka ndryshime të vogla në biomasën, krahasuar me kushtet tip-specifike. Ndryshime të tilla nuk tregojnë ndonjë rritje të ndjeshme të algave duke rezultuar në ngacmim të padëshiruar të balancës së organizmave të pranishëm në entet ujore ose në cilësinë fiziko-kimike të ujit.<br><br>Një rritje e lehtë frekuence dhe intensiteti të lulëzimit tip-specifik planktonik mund të ndodhë. | Përbërja dhe sasia e taksa fitoplanktonike ndryshon nga kushtet tip-specifike.<br><br>Biomasa e agave është ngacmuar dhe mund të prodhojë si rrjedhim një ngacmim të rëndësishëm të padëshirueshëm në kushtet e elementëve të tjerë cilësorë biologjikë.<br><br>Një rritje e moderuar në frekuencë dhe në intensitet të lulëzimit planktonik mund të ndodhë. Lulëzime të vazhduesme mund të ndodhin gjatë muajve të verës. |
| Fauna betike jovertebrore | Niveli i diversitetit i taksa jovertebrore nuk tregon ndonjë shenjë të ndryshimit nga nivelet e pangacmuar.<br><br>Janë të pranishme të gjitha taksatë të ndjeshme ndaj ngacmimeve, të shoqëruara nga kushte të pangacmuara. | Niveli i diversitetit dhe masës së taksa invertebrale tregon shenja te lehta të ndryshimit nga nivelet/kushtet tip-specifike.<br><br>Pjesa më e madhe e taksave të ndjeshme të komuniteteve tip-specifike është e pranishme | Niveli i diversitetit dhe i sasisë së taksave invertebrale është jashtë gamës së shoqëruar me kushte tip-specifike.<br><br>Taksa që tregojnë për ekzistencën e ndotjes, janë të pranishme.<br><br>Shumë nga taksatë të ndjeshme të komuniteteve tip-specifike nuk janë të pranishme. |

Elementët cilësorë hidromorfologjikë

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
| --- | --- | --- | --- |
| Regjimi hidrologjik | Sasia dhe dinamika e rrjedhës së ujit, shpejtësia e prurjeve kryesore korrespondon plotësisht ose pothuajse plotësisht kushte të pangacmuara. | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. |
| Kushtet morfologjike | Ndryshimi i thellësisë së shtratit bregdetar, sasia dhe struktura e nënshtresave dhe struktura dhe kushtet e zones bregdetare korrespondojnë plotësisht ose pothuajse plotësisht të gjitha kushteve të pangacmuara. | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. |

Elementët cilësorë fiziko-kimikë (1)

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
| --- | --- | --- | --- |
| Kushte të përgjithshme | Vlerat e elementeve fiziko-kimikë korrespondojnë totalisht ose pothuajse totalisht tek kushtet e pangacmuara.<br><br>Përqëndrimet ushqyese mbeten brenda normës të shoqëruara me kushte të pangacmueshme.<br><br>Temperatura, balanca e oksigjenit, kapaciteti acid neutralizues, transparenca dhe temperatura nuk tregojnë ndonjë shenjë të ngacmimit antropologjik dhe ngelen brenda normës normale të shoqëruara me kushte të pangacmuara. | Temperatura, balanca e oksigjenit, dhe transparenca nuk arrijnë nivelet jashtë normës të krijuar për të siguruar funksionimin e ekosistemit dhe arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë.<br><br>Përqëndrimet ushqyese nuk i tejkalojnë nivelet e krijuara për të siguruar funksionimin e ekosistemit dhe arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët biologjikë cilësorë. | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ndotës specifikë sintetikë | Përqëndrime afër zeros dhe të paktën poshtë lkufijveve të zbulimit të teknikave më të zhvilluara analitike në përdorim të përgjithshëm. | Përqëndrimet jo përtej standarteve të vendosura në përputhje me procedurat e detajuara në seksionin 1.2.6 pavarësisht Direktivës 91/414/EC dhe Direktivës 98/8/EC (<EQS) | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë |
| Ndotës specifikë josintetikë | Përqëndrimet mbeten brenda normës, normalisht të shoqëruara me kushte të pangacmuara (niveli i sfondit=bgl) | Përqëndrimet jo përtej standarteve te vendosura në përputhje me procedurat e detajuara në seksionin 1.2.6 (2) pavarësisht direktivës 91/414EC dhe Direktivës 98/8/EC. (<EQS) | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë |

1) Shkurtimet e mëposhtme janë përdorur: bgl= niveli i sfondit, EQS= standart cilësor mjedisor
2) Aplikimi i standarteve të përftuara nën këtë protokoll nuk do të kërkojnë reduktim të përqëndrimeve të ndotësve nën nivelet e sfondit (EQS>bgl)

1.2.5. Përkufizime për potencialin maksimal, të mirë dhe të moderuar ekologjik për zonat ujore të modifikuara shumë ose artificiale

| Elementi | Statusi i lartë | Statusi i mirë | Statusi i moderuar |
|---|---|---|---|
| Të përgjithshme | Vlerat e elementeve cilësorë biologjikë reflektojnë aq sa është e mundur ato vlera që zakonisht shoqërohen me tipin më të afërt të krahasueshëm të zonës ujore , duke pasur parasysh kushtet fizike të cilat vijnë si rezultat i karakteristikave artificiale ose të modifikuara tepër të zonave ujore. | Vlerat e elementeve cilësor biologjike për tregojnë nivele të ulëta ndryshimi krahasuar me vlerat e gjetura në potencialin maksimal ekologjik. | Ka ndryshime mesatare në vlerat e elementeve përkatëse cilësorë biologjikë krahasuar me vlerat e gjetura në potencialin maksimal ekologjik.<br><br>Këto vlera janë shumë më të deformuara/shpërfyturuara se vlerat e gjetura në një cilësi të mirë. |
| Elementët hidromorfologjikë | Kushtet hidromorfologjike janë në përputhje me ndikimet mbi zonën e sipërfaqes ujore që vijnë si rezultat i karakteritikave artificiale ose të modifikuar tepër të zonës ujore, pasi janë marrë të | Kushtet janë në përputhje me arritjet e vlerave të specifikuara më lart për elementët cilësorë biologjike. | Kushtet janë në përputhje me arritjet e vlerave të specifikuara më lart për elementët cilësorë biologjikë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | gjitha masat lehtësuese për të siguruar përqasjen më të mirë me aspektin ekologjik. | | |
| Elementët fiziko-kimikë | | | |
| Kushte të përgjithshme | Vlerat e elementëve fiziko-kimike korrespondojnë plotësisht ose pothuajse plotësisht me kushtet e pangacmuara.<br><br>Përqëndruesit ushqimorë ngelen brenda normës, zakonisht të shoqëruar me kushte jo të ngacmuara.<br><br>Nivelet e temperaturës, balancës së oksigjenit dhe pH nuk tregojnë shenja të ngacmimit antropogjenik dhe ngelen brenda normës zakonisht të shoqëruar me kushte të pangacmuara. | Vlerat e elementeve fiziko-kimike janë brenda normës së vendosur në mënyrë që të sigurohet funksionimi i ekosistemeve dhe arritja e vlerave të specifikuara më lart për elementet cilësorë biologjikë.<br><br>Temperatura dhe pH nuk arrijnë nivele jashtë normës së vendosur për të siguruar funksionimin e ekosistemeve dhe arritjen e vlerave të specifikuara më lart per elementët cilësorë biologjikë.<br><br>Përqëndrimet ushqyese nuk shkojnë përtej niveleve të përcaktuara, të vendosura për të siguruara funksionimin e ekosistemeve dhe arritjen e vlerave të specifikuara më lart për elementët biologjikë cilësorë. | Kushte në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementet cilësorë biologjikë. |
| Ndotës specifikë sintetikë | Përqëndrime afër zeros dhe të paktën poshtë kufijve të zbulimit të teknikave më të zhvilluara analitike në përdorim të përgjithshëm. | Përqëndrimet jo përtej standarteve të vendosura në përputhje me procedurat e detajuara në seksionin 1.2.6 pavarësisht Direktivës 91/414/EC dhe Direktivës 98/8/EC (<EQS) | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për elementët cilësorë biologjikë |
| Ndotës specifikë josintetikë | Përqëndrimet mbeten brenda normës normalisht të shoqëruara me kushte të pangacmuara (niveli i | Përqëndrimet jo përtej standarteve te vendosura në përputhje me procedurat e | Kushtet në përputhje me arritjen e vlerave të specifikuara më sipër për |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | sfondit=bgl) | detajuara në seksionin 1.2.6 (1) pavaresisht direktivës 91/414EC dhe Direktivës 98/8/EC. (<EQS) | elementët cilësorë biologjik |

1) Aplikimi i standarteve të përftuara nën këtë protokoll nuk do të kërkojnë reduktim të përqëndrimeve të ndotësve nën nivelet e sfondit (EQS>bgl)

1.2.6. Procedurat për vendosjen e standardeve të cilësisë kimike nga shtetet anëtare

Gjatë nxjerrjes së standardeve të cilësisë së mjedisit për ndotësit, të dhënë në listë në pikat 1 deri 9 të Shtojcës VIII për mbrojtjen e biotës ujore, shtete anëtare duhet të veprojnë në përputhje me dispozitat e mëposhtëme. Standate mund të vendosen për ujin, sedimentin, ose biotën.

Aty ku është e mundur, si të dhënat e shpejta dhe ato në mënyrë kronike, mund të merren për taksa-në e dhënë më poshtë, të dhëna që janë të përshtatshme si për zonën ujore në fjalë dhe për taksa të tjera ujore për të cilat ka të dhëna të disponueshme. “Bazat”e taksa-ve janë:

- algat dhe makrofitet
- daphnia ose organizmat përfaqësues për ujerat me kripë
- peshqit.

**Vendosja e standardit për cilësinë e mjedisit**

Për përcaktimin e përqëndrimeve mesatare maksimale vjetore ndiqen procedurat e mëposhtëme:

(i) Shtetet anëtare duhet të përcaktojnë faktorët e duhur të sigurisë për secilin rast, në përputhje me natyrën dhe cilësinë e të dhënave të disponueshme dhe me udhëzimet e dhëna në seksionin 3.3.1 të Pjesës së Dytë të dokumentit të udhëzimeve teknike, në mbështetje të Direktivës së Komisionit nr 93/67/EEC për vlerësimin e rrezikut për substancat e reja dhe të Rregullores së Komisionit (EC) nr 1488/94 mbi vlerësimin e rrezikut për substancat ekzistuese dhe faktorët e sigurisë, të dhënë në tabelën më poshtë:

| | Faktori i sigurisë |
|---|---|
| Të paktën një L(E)$C_{50}$ akute nga secili prej të tre niveleve trofike të bazës | 1 000 |
| Një NOEC kronike (peshk ose një organizëm tjetër përfaqësues i ujërave të kripura) | 100 |
| Dy NOEC kronike nga specie që përfaqësojnë dy nivele trofike (peshk dhe/ose dafnia ose një organizëm përfaqësues për ujërat e kripura dhe/ose algat) | 50 |
| NOEC kronike nga të paktën tri specie (normalisht peshk, dafnia ose një organizëm përfaqësues për ujërat e kripura dhe algat) që përfaqëson tre nivele trofike. | 10 |
| Raste të tjera, duke përfshirë të dhëna në terren ose ekosisteme model, të cilat lejojnë faktorë më të saktë sigurie për t’u llogaritur dhe aplikuar | Vlerësime rast pas rasti. |

(ii) kur të dhënat për persistencën dhe bioakumulimin janë të disponueshme, ato do të merren parasysh në nxjerrjen e vlerës përfundimtare të standardit të cilësisë së mjedisit;

(iii) për rrjedhojë, standardet duhet të krahasohen me prova nga studimet në terren. Në rastet e anomalive, duhet të bëhen rishikime për llogaritjen e faktorëve të saktë të sigurisë;

(iv) Standardi që arrihet, duhet të jetë subjekt i një rishikimi të ngushtë dhe i konsultimeve me publikun, duke përfshirë dhe lejimin e llogaritjes më të saktë të faktorit të sigurisë.

## 1.3 **Monitorimi i statusit ekologjik dhe kimik të ujrave sipërfaqësore**

Rrjeti i monitorimit të ujërave sipërfaqësore duhet të vendoset në përputhje me kërkesat e Nenit 8. Rrjeti i monitorimit do të hartohet në mënyrë që të ofrojë një kontroll koherent dhe të kuptueshëm të gjendjes ekologjike dhe kimike të secilit basen lumor dhe duhet të lejojë klasifikimin e zonave ujore në pesë klasa, në përputhje me përcaktimet normative të dhëna në seksionin 1.2. Shtetet anëtare duhet të ofrojnë një hartë ose disa harta për të treguar rrjetin e monitorimit të ujërave sipërfaqësore në planin e menaxhimit të basenit lumor.

Në bazën e karakteristikave dhe vlerësimit të ndikimit të bërë në përputhje me Nenin 5 dhe Ashtojcën II, Shtetet anëtare për cdo periudhë që aplikohet një plan menaxhimi i basenit lumor, duhet të përcaktojnë një program mbikëqyrjeje/monitorimi si dhe një program monitorimi operativ. Shtetet anëtare mund të kenë nevojë gjithashtu që të përgatisin programe hetuese monitorimi për disa raste.

Shtetet anëtare do të monitorojnë parametra të cilat janë treguese për statusin e secilit element cilësie përkatës. Në përzgjedhjen e parametrave për cilësinë biologjike, shtetet anëtare në disa raste duhet të identifikojnë nivelin e duhur të kërkuar taksonomik për të pasur më shumë besueshmëri dhe saktësi në klasifikimin e elementeve të cilësisë. Vlerësimet e nivelit të besueshmërisë dhe saktësisë së rezultateve të ofruara nga programet e monitorimit duhet të jenë pjesë e planit.

### 1.3.1. Hartimi i monitorimit mbikqyrës

Objektivi

Shtetet anëtare duhet të krijojnë programe monitorimi për të qënë në gjendje që të japin informacion për:

- të plotësuar dhe për të bërë të vlefshme procedurën e vlerësimit të ndikimit të dhënë, të detajuar në Shtojcën II
- skicën efektive dhe eficente për programet e monitorimit në të ardhmen;
- vlerësimin e ndryshimeve afatgjata në kushtet natyrore, dhe
- vlerësimin e ndryshimeve afatgjata që vijnë si pasojë e aktivitetit intensiv te përhapur antropogjenik.

Përfundimet e një monitorimi të tillë duhet të rishikohen dhe të përdoren në kombinim me procedurën e vlerësimit të ndikimit të përshkruar në Shtojcën II për të përcaktuar kërkesat për programet e monitorimit në placet aktuale të menaxhimit të baseneve të lumenjve dhe planeve që do të krijohen në të ardhmen.

*Përzgjedhja e pikave të monitorimit*

Monitorimi mbikqyrës do të kryhet në numër të mjaftueshëm të zonave të ujërave sipërfaqësore për të ofruar një vlerësim të statusit të përgjithshëm të ujërave sipërfaqësore brenda cdo basenit ujor. Në përzgjedhjen e këtyre zonave, Shtetet Anëtare do të sigurohen se kur është e nevojshme, monitorimi do të kryhet në ato pika ku:

- shkalla e prurjes së ujit është e konsiderueshme brenda basenit lumor si një i tërë, duke përfshirë pika mbi lumenj të mëdhenj ku zona mbajtëse është më e madhe se 2 500 $km^2$ ;

- volumi i ujit, prezent është domethënës brenda rrethit të basenit ujor, duke përfshirë dhe liqene të mëdha dhe rezervuarë të mëdhenj;

- ente të konsiderueshme uji kalojnë përmes kufirit të një Shteti Anëtar

- janë identifikuar vende pasi Vendimit për Shkëmbimin e Informacionit 77/795/EEC, dhe

dhe vende të tjera kërkohet që t'i nënshtrohen vlerësimit të ngarkesës së ndotësve, e cila transferohet përmes kufinjve të Shteteve Anëtare dhe që transferohet gjithashtu dhe në mjedisin detar.

*Zgjedhja e elementeve të cilësisë*

Monitorimi i mbikëqyrjes duhet të realizohet për cdo zone monitorimi për një periudhë prej një viti, gjatë periudhës së bërjes së planit të menaxhimit të basenit ujor për:

- parametrat tregues për të gjithë elementet cilësorë biologjike;

- parametrat që janë tregues për të gjitha elementet cilësorë hidromorfologjike;

- parametrat që janë tregues për të gjithë elementët e përgjithshëm fiziko-kimikë;

- ndotësit kryesorë në listë, të cilët janë hedhur në basenin lumor ose një nën-basen, dhe

- ndotës të tjerë të hedhur në masa të konsiderueshme në basenin ose nën-basenin ujor,

në përjashtim të rasteve kur mbikqyrja dëshmon se zona përkatëse ka arritur një nivel të mirë dhe se nuk ka prova nga rishikimi i ndikimit të aktivitetit njerëzor të Shtojcës II që dëshmojnë se ndikimet në zonë kanë ndryshuar. Në këto raste, monitorimi mbikqyres duhet të kryhet një herë për cdo tre plane menaxhimi të basenit ujor.

1.3.2. Hartimi i monitorimit operativ

Monitorimi operativ do të ndërmerret në mënyrë që:

- të përcaktojë statusin e atyre zonave të përcaktuara që rrezikojnë të mos përmbushin objektivat mjedisore, dhe

- të vlerësojë cdo ndryshim në statusin e zonave të tilla që vijnë si rezultat i progameve të masave.

Programi mund të amandohet gjatë periudhës së planit të menaxhimit të basenit lumor, sipas informacionit të marrë si pjesë e kërkesave të Shtojcës II ose si pjesë e kësaj Shtojce, në vecanti për të lejuar uljen e frekuencës ku ndikimi nuk është domethënës ose ku presioni përkatës është humbur.

*Zgjedhja e pikave të monitorimit*

Monitorimi operativ duhet të kryhet për të gjitha ato zona uji, të cilat në bazë të vlerësimit të ndikimit të bërë në përputhje me Shtojcën II ose me monitorimin e mbikëqyrjes, janë identifikuar se janë në rrezik për të mos plotësuar objektivat mjedisore të përcaktuara në Nenin 4 dhe për ato zona uji në të cilat janë shkarkuar substanca nga lista përparësore. Pikat e monitorimit do të zgjidhen për substancat e listës përparësore, ashtu sic është specifikuar në legjislacionin që përmbledh standardet përkatëse të cilësisë së mjedisit. Në të gjitha rastet e tjera, duke përfshirë dhe substancat nga lista parësore për të cilat nuk është dhënë një udhëzim specifik në legjislacion, pikat e monitorimit do të zgjidhen si më poshtë:

- për zonat në rrezik nga presione domethënësee burimore, do të përcaktohen pika të mjaftueshme monitorimi në mënyrë që të vlerësohet shkalla dhe ndikimi i burimit ndotës. Kur zona është subjekt i një numri presionesh burimore pikash, pikat e monitorimit mund të zgjidhen për të vlerësuar shkallën dhe ndikimin e këtyre presioneve si të tëra.

- Për zonat në rrezik nga presione difuzive domethënëse burimore, do të caktohen pika monitorimi të mjaftueshme në mënyrë që të vlerësohet shkalla dhe ndikimi i presioneve të burimit. Zgjedhja e zonave duhet të bëhet në mënyrë të tillë që ato të përfaqësojnë rreziqet përkatëse të presioneve burimore difuzive, dhe rreziqet relative të mosarritjes të statusit të mirë të ujërave sipërfaqësore.

- Për zonat në rrezik nga presioni domethënës hidromorfologjik, duhet të zgjidhen pika të mjaftueshme monitorimi në mënyrë që të vlerësohet shkalla dhe ndikimi i presioneve hidromorfologjike. Zgjedhja e zonave do të jetë tregues i ndikimit të përgjithshëm të presionit hidromorfologjik.

*Zgjedhja e elementeve të cilësisë*

Për t'u bërë i mundur vlerësimi i shkallës së presionit që ndikon zonat e ujit sipërfaqësor, shtetet anëtare do të monitorojnë për ato elemente cilësie të cilat janë treguese të presionit që ndikon mbi zonën ose zonat. Në mënyrë që të vlerësohet ndikimi i këtij presioni, shtetet anëtare duhet të monitorojnë:

- parametrat që janë tregues për elementin e cilësisë biologjike, ose elementët që janë më të ndjeshëm ndaj presionit i cili ndikon mbi zonat ujore;

- të gjitha substancat përparësore të shkarkuara dhe ndotës të tjerë të shkarkuara në sasi të konsiderueshme;

- parametra që tregojnë elementin e cilësisë hidromorfologjike, që janë më të ndjeshme ndaj presionit të identifikuar

- parametrat tregues të elementit cilësor hidromorfologjik më të ndjeshme ndaj presionit të identifikuar

1.3.3. Hartimi i monitorimit nvestigativ

Objektivi

Monitorimi investigativ do të kryhet:

- kur arsyeja për investigim është e njohur
- kur monitorimi mbikëqyrës tregon se objektivat e vendosura në Nenin 4 për zonën e ujit nuk ka të ngjarë të arrihen dhe nuk është vendosur akoma një monitorim operativ në mënyrë që të sigurohen shkaqet e zonës ujore ose zonave ujore, që nuk janë në gjendje të arrijnë objektivat mjedisore, ose
- për të siguruar shkallën dhe ndikimet e ndotjes aksidentale

dhe do të informojnë vendosjen e programit të masave për arritjen e objektivave mjedisore dhe masave specifike të nevojshme për të ndrequr efektet e ndotjes aksidentale.

1.3.4. Frekuenca e monitorimit

Gjatë periudhës së monitorimit mbikqyrës, frekuencat për parametrat monitorues që janë tregues për elementët e cilësisë fiziko-teknike, duhet të aplikohen në përjashtim të rasteve kur intervale më të mëdha rregullohen në bazë të njohurisë teknike dhe gjykimit të ekspertëve. Për elementet biologjike dhe hidromorfologjike, monitorimi duhet të kryhet të paktën një herë gjatë periudhës së monitorimit mbikëqyrës.

Për monitorimin operativ, frekuenca e kërkuar e monitorimit për çdo parametër do të përcaktohet nga shtetet anëtare në mënyrë që të ofrohen të dhëna të mjaftueshme për një vlerësim të besueshëm të statusit të elementit të cilësisë përkatëse. Si udhëzues, monitorimi duhet të ndodhë gjatë intervaleve që nuk i kalojnë ato që tregohen në tabelën më poshtë, në përjashtim të rasteve kur justifikohen intervale më të mëdha në bazën e njohurive teknike dhe gjykimeve të ekspertëve.

Frekuencat e monitorimit duhet të zgjidhen duke marrë parasysh ndryshueshmërinë e parametrave që vijnë si rezultat i kushteve natyrale dhe antropogjenike. Koha në të cilën është bërë monitorimi duhet të zgjidhet në mënyrë të tillë që të ulë sa më shumë të jetë e mundur ndikimin e ndyshimeve sezonale për rezultatet, dhe duke siguruar në këtë mënyrë që rezultatet reflektojnë ndryshimet në zonën ujore si rezultat i ndryshimeve të shkaktuara nga presioni antropogjenik. Gjatë sezoneve të ndryshme të të njëjtit vit do të bëhen monitorime shtesë, aty ku është e mundur, në mënyrë që të arrihet ky objektiv.

| Elementi i cilësisë | Lumenjtë | Liqenet | Ujërat tranzicionale | Ujerat bregdetare |
|---|---|---|---|---|
| Biologjike | | | | |
| Fitoplankton | 6 muaj | 6 muaj | 6 muaj | 6 muaj |
| Flora të tjera ujore | 3 vjet | 3 vjet | 3 vjet | 3 vjet |
| Makroinvertebrorët | 3 vjet | 3 vjet | 3 vjet | 3 vjet |
| Peshqit | 3 vjet | 3 vjet | 3 vjet | |

Hidromorfologjikët

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Vazhdimësia | 6 vjet | | | |
| Hidrologjia | E vazhdueshme | 1 muaj | | |
| Morfologjia | 6 vjet | 6 vjet | 6 vjet | 6 vjet |

Psiko-kimikë

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kushtet termale | 3 muaj | 3 muaj | 3 muaj | 3 muaj |
| Oksigjenimi | 3 muaj | 3 muaj | 3 muaj | 3 muaj |
| Kripësia | 3 muaj | 3 muaj | 3 muaj | |
| Statusi ushqyes | 3 muaj | 3 muaj | 3 muaj | 3 muaj |
| Gjendja e acidit | 3 muaj | 3 muaj | | |
| Ndotësit e tjerë | 3 muaj | 3 muaj | 3 muaj | 3 muaj |
| Substancat parësore | 1 muaj | 1 muaj | 1 muaj | 1 muaj |

1.3.5. Kërkesa të tjera monitorimi shtesë për zonat e mbrojtura

Programet e monitorimit që kërkohen më lart, do të zbatohen në mënyrë që të plotësohen kërkesat e mëposhtme:

Pikat e nxjerrjes së ujit të pijshëm

Zonat e ujit sipërfaqësor, të pëmendur në Nenin 7, nga të cilat nxirren mesatarisht më shumë se 100 metra kub do të caktohen si pika monitorimi dhe do të jenë subjekt i monitorimeve të tjera shtesë, ashtu siç do të kërkohet për të plotësuar kërkesat e nenit përkatës. Zona të tilla do të monitorohen për të gjitha substancat përparësore dhe për të gjitha substancat e tjera që janë në masa të konsiderueshme, të cilat kanë ndikim mbi statusin e trupit të ujit dhe të cilat kontrollohen nga dispozitat e Direktivës së Ujit të Pijshëm. Monitorimi dhe të kryhet në përputhje me frekuencat e përcaktuara më poshtë:

| | |
|---|---|
| | |

| Komunitetit që i shërbehet | Frekuenca |
|---|---|
| Më e madhe se 10 000 | 4 në vit |
| 10 000 deri në 30 000 | 8 në vit |
| Më e madhe se 10 000 | 12 në vit |

Habitatet dhe zonat e mbrojtura të specieve

Strukturat e ujit që formojnë këto zona, do të përmblidhen si pjesë e programit monitorues të përmendur më lart, për bazën e ndikimit të vlerësimit dhe monitorimit mbikqyres; ato janë përcaktuar se janë që rrezikojnë që të mos plotësojnë objektivat mjedisore, të përcaktuara në Nenin 4. Monitorimi do të kryhet për të vlerësuar shkallën e ndikimit të presioneve përkatëse domethënëse mbi këto zona, dhe aty ku është e nevojshem, për të vlerësuar ndryshimet në statusin e trupave të tillë që vijnë si rrjedhojë e masave. Monitorimi do të vazhdojë derisa zonat të plotësojnë kërkesat e lidhura me ujin të dhëna në legjislacion, sipas të cilave atyre u kërkohet të plotësojnë objektivat e Nenit 4.

1.3.6. Standardet për monitorimin e elementeve të cilësisë

Metodat e përdorura për monitorimin e parametrave tip duhet të jenë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të dhëna në listë më poshtë, të cilat do të sigurojnë dhënien e të dhënave të një cilësie dhe krahasueshmërie përkatëse shkencore.

Kampionet e makroinvertebrorëve

| | |
|---|---|
| ISO 5667-3:1995 | Cilësia e ujit – Kampionimi – Pjesa 3: Udhëzime për ruajtjen dhe trajnimin e kampioneve |
| EN 27828:1994 | Cilësia e ujit – Metodat e kompioneve biologjike – Udhëzime për trajtimin e kampionëve të makroinvertebrorëve bentikë |
| EN 28265:1994 | Cilësia e ujit – Metoda e nxjerrjes së kampioneve biologjikë – Udhëzime për strukturën dhe përdorimin e kampionëve sasiorë për makroinvertebrorët bentikë mbi nënshtresa gurore në ujërat e cekëta. |
| EN ISO 9391:1995 | Cilësia e ujit – Nxjerrja e kampioneve të makroinvertebrorët në ujërat e thella. |
| EN ISO 8689 – 1:1999 | Klasifikimi biologjik i lumenjve PJESA 1: Udhëzime për interpretimin e të dhënave të cilësisë biologjike nga sondazhe të maktoinvertebralëve në ujërat e rrjedhshme |
| EN ISO 8689-2:1999 | Klasifikimi biologjik i lumenjve PJESA II. Udhëzime për paraqitjen e të dhënave për cilësinë biologjike nga sondazhet e makrovertebrorëve bentikë në ujrat e rrjedhshme. |

Nxjerrja e kampjoneve të mikrofiteve

Standardet përkatëse CEN/ISO përgjatë zhvillimit

Nxjerrja e kompioneve të peshkut

Standardet përkatëse CEN/ISO përgjatë zhvillimit

Nxjerrja e kompioneve të diatomit

Standardet përkatëse CEN/ISO përgjatë zhvillimit

Standardet për parametrat fiziko-kimikë

Standardet përkatëse CEN/ISO

Standardet për parametrat hidromorfologjikë

Standardet përkatëse CEN/ISO përgjatë zhvillimit

## 1.4 Klasifikimi dhe paraqitja e statusit ekologjik

1.4.1 Krahasueshmëria e rezultateve të monitorimit biologjik

(i) Shtetet Anëtare do të krijojnë sisteme monitorimi për të matur vlerat e elementeve të cilësisë biologjike të specifikuar për secilën kategori të ujit sipërfaqësor ose për zonat e sipërfaqeve ujore të modifikuar tepër ose të ujërave artificiale. Gjatë aplikimit të procedurave të përcaktuara më poshtë për zonat e ujit të modifikuar tepër ose për zonat e ujit artificial, duhet t'i referencat e statusit ekologjik do të shikohen si referenca të potencialit ekologjik. Sisteme të tilla mund të përdorin specie të veçanta ose grupe të veçanta speciesh të cilat si të tëra janë përfaqësuese të elementit të cilësisë.

(ii) Në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me sisteme të tilla monitorimi, rezultatet e sistemeve që përdoren nga secili shtet anëtar, do të shprehen si raporte të cilësë ekologjike për qëllime klasifikimi të statusit ekologjik. Këto raporte do të përfaqësojnë marrëdhëniet ndërmjet vlerave të parametrave biologjikë të vëzhguar për një zonë të caktuar të sipërfaqes ujore dhe vlerave atop parametra në kushtet e referimit që janë të aplikueshme për zonën. Raporti do të shprehet si një vlerë numerike ndërmjet zeros dhe njëshit, me një status të lartë ekologjik, të përfaqësuar nga vlerat e statusit ekologjik nga një në statusin e keq, me status të lartë ekologjik të përfaqësuar nga vlerat që janë afër njëshit dhe statusi i keq ekologjik nëpërmjet vlerave që janë afër zeros.

(iii) Secili shtet anëtar duhet të ndajë shkallën e përqindjes së cilësisë ekologjike për sistemin e tyre të monitorimit për secilën kategori uji sipërfaqësore në pesë klasa, që variojnë nga statusi i lartë në statusin e keq biologjik, ashtu sic përcaktohet në Seksionin 1.2., duke i caktuar një vlerë numerike secilit kufi ndërmjet klasave. Vlera për kufirin ndërmjet klasave të statusit të lartë dhe të mirë dhe vlerës për kufij ndërmjet statusit të mirë dhe të moderuar do të përcaktohet nëpërmjet ushtrimit të ndërkalibrimit të përshkruar më lart.

(iv) Komisioni do të lehtësojë ushtrimin e ndërkalibrimit në mënyrë që të sigurojë që këto kufij klasorë janë përcaktuar në përputhje me përkufizimet normative të Seksionit 1.2 dhe janë të krahasueshme ndërmjet shteteve anëtare.

(v) Si pjesë e këtij ushtrimi, Komisioni do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet shteteve anëtare, gjë që do të çojë në identifikimin e disa pikave për secilin ekorajon në Komunitete; këto vende do të formojnë një rrjet ndërkalibrimi. Rrjeti do të përbëhet nga pika (vende) që u përkasin tipeve të ndryshme të trupit të ujit brenda secilit ekorajon. Për secilin tip të të zgjedhur të zonës së ujit sipërfaqësor, rrjeti do të përbëhet nga të paktën dy pika që korrespondojnë me kufijtë ndërmjet përkufizimeve normative të statusit të mirë dhe të moderuar. Pikat do të përzgjidhen si rezultat i një gjykimi ekspertësh, bazuar në inspektimin e pikave dhe në të gjithë informacionin tjetër të disponueshëm.

(vi) Secili sistem monitorimi i çdo shteti anëtar do të aplikohet për ato pika në rrjetin e ndërkalibrimit të cilat janë si brenda ekorajonit dhe pjesë e një tipi të zonës ujore sipërfaqësore mbi të cilën do të aplikohet sistemi, në përputhje me kërkesat e kësaj Direktive. Rezultatet e aplikimit do të përdoren për të përcaktuar vlerat numerike për kufijtë përkatës klasorë në secilin sistem monitorimi të shteteve anëtare.

(vii) Brenda afatit kohor prej 3 vjetësh pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Direktive, Komisioni do të përgatisë një projekt-regjistër për pikat (vendet) për të formuar një rrjet ndërkalibrimi, i cili mund të hartohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në Nenin 21. Regjistri përfundimtar i pikave (vendeve) do të përcaktohet brenda periudhës prej katër vitesh nga hyrja në fuqi e kësaj Direktive dhe do të botohet nga Komisioni.

(viii) Komisioni dhe shtetet anëtare do të plotësojnë ushtrimin ndërkalibrues brenda 18 muajsh nga data në të cilën është përfunduar botimi i regjistrit.

(ix) Rezultatet e ushtrimit ndërkalibures dhe vlerat e përcaktuara për klasifikimet e sistemeve të monitorimit për shtetet anëtare do të botohen nga Komisioni brenda 6 muajsh pas përfundimit të ushtrimit të interkalibrimit.

1.4.2 Paraqitja e përfundimeve të monitorimit dhe klasifikimi i statusit ekologjik dhe potencialit ekologjik

(i) Për kategoritë e ujërave sipërfaqësorë, klasifikimi i statusit ekologjik për zonat e ujit do të përfaqësohen nga vlerat më të ulta për rezultatet e monitorimit biologjik dhe fiziko-kimik për elementët përkatës cilësorë, në përputhje me kolonën e parë të tabelës së dhënë më poshtë. Shtetet anëtare do të ofrojnë një hartë për secilin rreth të basenit ujor, duke ilustruar klasifikimin e statusit ekologjik për secilin trup ujor, i koduar sipas ngjyrës, në përputhje me kolonën e dytë të tabelës së dhënë më poshtë, për të reflektuar klasifikimin e statusit ekologjik të zonës së ujit.

| Klasifikimi i statusit ekologjik | Kodi i ngjyrës |
|---|---|
| I lartë | Blu |
| I mirë | Jeshil |
| I moderuar | I verdhë |
| I varfër | Portokalli |
| I keq | I kuq |

Për zonat ujore të modifikuara tepër dhe artificiale, klasifikimi i mundshëm ekologjik për zonën e ujit duhet të përfaqësohet nga vlerat më të ulta për rezultatet e monitorimit biologjik dhe fiziko-kimik për elementët përkatës së cilësisë, të klasifikuar në përputhje me kolonën e parë të tabelës së dhënë më poshtë. Shtetet anëtare do të përgatisin një hartë me rrethet e basenit ujor, duke ilustruar klasifikimin e potencialit ekologjik për secilin nga zonat ujore kodin e ngjyrës dhe duke pasur parasysh zonat e ujit të modifikuar tepër, dhe në përputhje me kolonën e tretë të asaj tabele.

| Klasifikimi i potencialit ekologjik | Kodi i ngjyrës<br><br>Zonat e ujit sipërfaqësor | Kodi i ngjyrës<br><br>Zonat e modifikuara epër |
|---|---|---|
| I mirë dhe më lart | Ngjyrë jeshile e njëtrajtëshme dhe rripa të hollë gri | Ngjyrë jeshile e njëtrajtshme dhe rripa gri të errët |
| I moderuar | Ngjyrë e verdhë e njëtrajtëshme | Ngjyrë e verdhë e njëtrajtëshme |

| | | |
|---|---|---|
| | dhe rripa të hollë gri | dhe rripa gri të errët |
| I varfër | Ngjyrë portokalli e njëtrajtëshme dhe rripa të hollë gri | Ngjyrë portokalli e njëtrajtëshme dhe rripa gri të errët |
| I keq | Ngjyrë e kuqe e njëtrajtëshme dhe rripa të hollë gri | Ngjyrë e kuqe e njëtrajtëshme dhe rripa gri të errët |

(ii) Shtetet anëtare duhet të dëshmojnë nëpërmjet një pike të zezë në hartë ato zona të ujit ku pamundësia për të pasur një status të mirë ose një potencial ekologjik të mirë ka ardhur si rezultat i mospërputhshmërisë me një ose më shumë standarde cilësie mjedisore, të cilat janë përcaktuar për atë zonë uji, në lidhje me ndotëset e veçantë sintetikë dhe josintetikë (në përputhje me regjimin e përcaktuar nga shtetet anëtare).

1.4.3. Paraqitja e rezultateve të monitorimit dhe klasifikimi i statusit kimik

Kur një zonë ujore i plotëson standardet e cilësisë së mjedisit të dhëna në Shtojcën IX, Neni 16, dhe në ligje të tjera të Komunitetit që përcaktojnë standarde të cilësisë së mjedisit, duhet të mbahet shënim që zona ka arritur një status të mirë kimik. Nëse jo, zona do të regjistrohet si zonë që nuk ka arritur një status të mirë kimik.

Shtetet anëtare do të ofrojnë një hartë për secilin rreth baseni ujor, duke ilustruar statusin kimik për secilën zonë të ujit, kodin e ngjyrës në përputhje më kolonën e dytë të tabelës së dhënë më poshtë për të reflektuar klasifikimin e statusit kimik të zonës ujore:

| Klasifikimi i statusit kimik | Kodi i ngjyrës |
|---|---|
| I mirë | Blu |
| Nuk arrin të klasifikohet tek kategoria “I mirë” | I kuq |

2. Uji nëntokësor

**2.1. Statusi cilësor i ujit nëntokësor**

## 2.1.1. Parametri për klasifikimin e statusit cilësor

*Regjimi i nivelit të ujit nëntokësor*

## 2.1.2. Përkufizime të statusit cilësor

| Elementët | Statusi i mirë |
|---|---|
| Niveli i ujit nëntokësor | Niveli i ujit nëntokësor në zonën e ujit nëntokësor është i tillë që burimi i disponueshëm i ujit nëntokësor nuk kalohet nga shkalla mesatare vjetore e nxjerrjes.<br><br>Si rrjedhim, niveli i ujit nëntokësor nuk është subjekt i ndryshimeve antropogjenike në mënyrë që të çojë në:<br><br>- mosrealizimin e objektivave mjedisore të specifikuara në Nenin 4 për ujërat sipërfaqësorë të asociuar;<br>- ndonjë ulje të konsiderueshme të statusit të ujërave të tillë<br>- ndonjë dëmtim të konsiderueshëm të ekosistemeve terrestiale, të cilat varen drejtpërsëdrejti tek zona e ujit nëntokësor,<br><br>dhe ndryshime ndaj drejtimit të rrjedhjes që vijnë si rezultat i ndryshimeve të nivelit mund të ndodhin përkohësisht ose vazhdimisht në një zonë pjesërisht të kufizuar, por ndryshime të tilla nuk shkaktojnë interferencën e ujit të kripur ose interferime të tjera dhe nuk dëshmojnë për një tendencë qartësisht të identifikueshme antorpogjenike në drejtimet e prurjes që ka të ngjarë të çojnë në interferenca të tilla. |

2.2. Monitorimi i statusit të cilësisë së ujit nëntokësor

2.2.1 Rrjeti i monitorimit të nivelit të ujërave nëntokësore

Rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore do të përcaktohet në përputhje me kërkesat e Nenit 7 dhe 8. Rrjeti i monitorimit do të hartohet në mënyrë që të japë një vlerësim të besueshëm të statusit cilësor të zonës ose zonave të ujit nëntokësor, duke përfshirë dhe vlerësimin e burimit të disponueshëm të ujit nentokësor. Shtetet anëtare do të ofrojnë një hartë ose harta që tregojnë rrjetin e monitorimit të ujërave sipërfaqësore në planin e menaxhimti të basenit të lumit.

2.2.2. Densiteti i pikave të monitorimit

Rrjeti do të përfshijë pika të mjaftueshme përfaqësuese për monitorimin, për të vlerësuar nivelin e ujit sipërfaqësor në secilën zonë ose zona të ujit sipërfaqësor, duke marrë parasysh ndryshimet afatshkurtra dhe afatgjata të rifurnizimit, veçanërisht:

- zonat e ujit nëntokësor të identifikuara se rrezikojnë të mos plotësojnë objektivat mjedisore sipas Nenit 4, sigurojnë densitet të mjaftueshëm dhe pika monitorimi për të vlerësuar ndikimin e nxjerrjeve dhe rifurnizimeve në nivelin e ujit nëntokësor,

- për zonat e ujit nëntokësor brenda të cilave prurjet e nëntokës kalojnë përmes kufirit të një shteti anëtar, ofrohet sigurimi i pikave të mjaftueshme të monitorimit për të vlerësuar drejtimin dhe shkallën e prurjes së ujit nëntokësor përmes kufirit të shtetit anëtar.

2.2.3. Monitorimi i frekuencës

Frekuenca e vëzhgimeve duhet të jetë e mjaftueshme në mënyrë të tillë që të lejojë vlerësimin e statusit cilësor të secilës zone ose zonash nëntokësore, duke marrë parasysh ndryshimet afatshkurtra dhe afatgjata, dhe duke marrë parasysh në veçanti:

- zonat e ujit nëntokësor të identifikuara se rrezikojnë të mos plotësojnë objektivat mjedisore sipas Nenit 4, sigurojnë frekuencë të mjaftueshme masash për të vlerësuar ndikimin e nxjerrjeve dhe rifurnizimeve në nivelin e ujit nëntokësor,

- për zonat e ujit nëntokëso,r brenda të cilave prurjet e nëntokës kalojnë përmes kufirit të një shteti anëtar, ofrohet frekuencë e mjaftueshme masash për të vlerësuar drejtimin dhe shkallën e prurjes së ujit nëntokësor përmes kufirit të shtetit anëtar.

2.2.4. Interpretimi dhe prezantimi i statusit cilësor të ujërave nëntokësore

Rezultatet e marra nga rrjeti i monitorimit për zonat e ujit nëntokësor ose grupin e zonave të ujërave nëntokësore do të përdoren për të vlerësuar statusin cilësor të asaj zone ose të atyre zonave. Sipas pikës 2..5., shtetet anëtare do të ofrojnë një hartë ku do të pasqyrohet vlerësimi përkatës i statusit cilësor të ujit nëntokësor, si dhe kodi i ngjyrave në përputhje me regjimin e mëposhtëm:

I mirë: jeshile

I varfët: ngjyrë e kuqe

**2.3. Statusi kimik i ujit nëntokësor**

2.3.1. Parametrat për përcaktimin e statusit kimik të ujit nëntokësor:

Sjellja

Përqëndrimi i ndotësve

2.3.2. Përcaktimi i statusit të mirë kimik të ujit nëntokësor

| Elementet | Statusi i mirë |
|---|---|
| Të përgjithshme | Përbërja kimike e zonës së ujit sipërfaqësor është e tillë që përqëndrimet e ndotësve:<br>- ashtu siç specifikohet më poshtë, nuk i tregojnë efektet e kripës ose të interferencave të tjera<br>- nuk i kalojnë standardet e cilësisë që janë të aplikueshme në ligje të tjera përkatëse të Komunitetit, në përputhje me Nenin 17<br>- nuk janë të tilla që të çojnë në mosrealisimin e objektivave mjedisore të specifikuara në Nenin 4 për siperfaqe ujore të shoqëruara, as në uljen e konsiderueshme të cilësisë |

| | |
|---|---|
| | ekologjike ose kimike të zonave të tilla,dhe as në dëmtime të konsiderueshme të ekosistemeve terrestiale, të cilat varen drejtpërsëdrejti në zonën e ujit nëntokësor |
| Sjellja | Ndryshimet në sjellje nuk janë treguese për kripshmërinë ose ndërhyrje të tjera që mund t'i bëhen zonës së ujit nëntokësor. |

2.4. Monitorimi i statusit kimik të ujit nëntokësor

2.4.1. Rrjeti i monitorimit të ujit nëntokësor

Rrejti i monitorimit të ujërave nëntokësore do të përcaktohet në përputhje me kërkesat e Nenit 7 dhe 8. Rrjeti i monitorimit do të hartohet në mënyrë që të japë një vlerësim të besueshëm të statusit kimik të zonës ose zonave të ujit nëntokësor, për të evidentuar praninë e tendencave afatgjata antropogjenike në rritje të ndotësve.

Në bazën e karakterizimit dhe ndikimit të vlerësimit të kryer në përputhje me Nenin 5 dhe Shtojcën II, shtetet anëtare për çdo periudhë në të cilën aplikohet plani i menaxhimit të basenit lumor, duhet të vendosin një program monitorimi. Rezultatet e këtij programi do të përdoren për të formuar një program operativ monitorimi, i cili do të përdoret për pjesën e planit që mbetet.

Vlerësimet e nivelit të besueshmërisë dhe saktësisë së rezultateve që vijnë si rezultat i programeve të monitorimit, do të pasqyrohen dhe në plan.

2.4.2 Mbikëqyrja e monitormit

Mbikëqyrja e monitorimit ose monitorimi mbikëqyrës do të realizohet në mënyrë që të:

- shtohen dhe bëhet e vlefshme procedura e vlerësimit të ndikimit,
- ofrohet informacion për përdorim në vlerësimin e tendencave afatgjata si rezultat i ndryshimeve më kushtet natyrore dhe nëpërmjet aktivitetit antropogjenik.

*Përzgjedhja e pikave të monitorimit*

Duhet të përzgjidhen pika të mjaftueshme monitormi për secilën nga elementet e mëposhtëm:

- zonat e identifikuara se kanë rrezik të mos ndjekin ushtrimin e karakterizimit të ndërmarrë në përputhje me Shtojcën II,
- zonat të cilat kalojnë përmes kufirit të një shteti anëtar

*Përzgjedhja e parametrave*

Më poshtë janë dhënë parametrat bazë, të cilat do të monitorohen në të gjitha zonat e zgjedhura të ujit nëntokësor:

- përbërja e oksigjenit

- vlera e pH
- sjellja
- nitrimi
- amoniumi

Zonat që janë identifikuar në përputhje me Shtojcën II që kanë rrezik të mos plotësojnë parametrat për statusin e mirë, do të monitorohen gjithashtu për ato paramentra, të cilët janë tregues të ndikimit të këtyre presioneve.

Zonat ndërkufitare ujore do të monitorohen për ato parametra, të cilat lidhen me mbrojtjen e të gjithë përdoruesve të mbështetur nga prurjet e ujit nëntokësor.

2.4.3. Monitorimi operativ

Objektivi

Monitorimi operativ do të ndërmerret në periudhat ndërmjet programeve të mbikëqyrjes së monitorimit në mënyrë që:

- të vendoset statusi kimik i zonave të ujit nëntokësor ose të grupeve të këtyre zonave, të përcaktuara si në rrezik;
- të vendoset prania e tendencës në rritje afatgjatë antropogjenetike në përqëndrimin e çdo ndotësi.

*Përzgjedhja e pikave të monitorimit*

Monitorimi operativ do të kryhet për të gjitha ato zona të ujit sipërfaqësor ose grupe zonash, të cilat mbi bazën e vlerësimit të ndikimit të kryer në përputhje me Shtojcën II dhe në bazë të monitorimit mbikëqyrës janë identifikuar se kanë rrezik të mos plotësojnë objektivat e Nenit 4. Përzgjedhja e pikave të monitorimit do të reflektojë gjithashtu një vlerësim të mënyrës sesi të dhënat monitoruese përfaqësuese nga ajo pikë janë të një cilësie që është e përshtatshme për zonën e zonat e ujit nëntokësor.

*Frekuenca e monitorimit*

Monitorimi operativ do të bëhet gjatë periudhave ndërmjet programeve të monitorimit mbikëqyrës me një shpeshtësi që është e mjaftueshme për të diktuar ndikimet e presioneve përkatëse, por për një minimum prej një here në vit.

2.4.4. Identifikimi i tendencave të ndotësve

Shtetet anëtare do të përdorin të dhëna si nga monitorimi mbikëqyrës dhe nga ai operativ në identifikimin e antropogjenitetit afatagjatë me tendencë në rritje të përqëndrimeve të ndotësve dhe të kundërtën e tendencave të tilla. Duhet të identifikohet viti ose periudha bazë. Llogaritja e tendencave duhet të ndërmerret për një strukturë, ose kur është e nevojshme, për një grup zonash ujore nëntokësore. Tendenca duhet që të demostrohet në mënyrë statistikore, së bashku me nivelin e besueshmërisë që lidhet me identifikimin në fjalë.

2.4.5 Interpretimi dhe prezantimi i statusit kimik të ujit nëntokësor

Në vlerësimin e statusit, rezultatet e pikave individuale të monitorimit brenda një trupi të ujit nëntokësor do të agragohen si të tëra në zonë. Pa pasur paragjykime për Direktivën në fjalë, në mënyrë që të arrihet një

status i mirë për zonën e ujit nëntokësor, për këta parametra kimikë, për të cilët standardet e cilësisë së mjedisit janë përcaktuar në legjislacionin e Komunitetit

- do të llogaritet vlera mesatare e rezultateve të monitorimit në secilën pikë në zonën ose grupin e zonave të ujërave nëntokësore, dhe

- në përputhje me Nenin 17, këto vlera mesatare do të përdoren për të demonstruar përputhshmërinë me statusin e mirë kimit.

Lidhur me pikën 2.5, shtetet anëtare do të ofrojnë një status kimik të ujërave nëntokësore, të koduar sipas ngjyrave të dhëna më poshtë:

I mirë: jeshile
I dobët: i/e kuq

Shtetet anëtare do të tregojnë nëpërmjet vendosjes së një pike të zezë në hartë, se këto zona të ujit nëntokësor janë subjekt i tendecës domethënëse dhe të qëndrueshme në përqëndrimet e çdo ndotësi që vjen si rezultat i ndikimit të aktivitetit njerëzor. Kthesa e një tendence do të tregohet nëpërmjet një pike blu në hartë.

2.5. **Prezantimi i statusit të ujit nëntokësor**

Shtetet anëtare do të ofrojnë një hartë për secilën zonë ose grup zonash për planin e menaxhimit të basenit të lumit, duke përfshirë si statusin cilësor dhe atë kimik të asaj strukture ose grupi strukturash, të koduar me ngjyra në përputhje me kërkesat e pikave 2.2.4. dhe 2.4.5. Shtetet anëtare mund të vendosin që të mos japin harta të veçanta në përputhje të pikave 2.2.4 dhe 2.4.5, po në atë rast do të japin një tregues të atyre zonave që janë subjekt i një tendence në rritje të përqëndrimit të ndotësve ose do të pasqyrojnë çdo kthim të një tendence të tillë, në përputhje me pikat 2.4.5 në hartë.

## SHTOJCA VI

## LISTA E MASAVE QË DO TË PËRFSHIHET BRENDA PROGRAMEVE TË MASAVE

### Pjesa A

Masat e kërkuara sipas Direktivave të mëposhtme:

(i) Direktiva e Ujit për Banjo (76/160/EEC)

(ii) Direktiva e Zogjve (79/409/EEC) ([1])

(iii) Direktiva e Ujit të Pijshëm (80/778/EEC), e amenduar nga Direktiva (98/83/EC)

(iv) Direktiva e Aksidenteve Kryesore (96/82/EC) ([2])

(v) Direktiva e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (85/337/EEC) ([3] )

(vi) Direktiva e Ujërave të Zeza (86/278/EEC) ([4])

(vii) Direktiva e Trajtimit të Mbetjeve Ujore Urbane (91/271/EEC)

(viii) Direktiva e Mbrojtjes së Produkteve Bimore (91/414/EEC)

(ix) Direktiva e Nitrateve (91/676/EEC);

(x) Direktiva e Kabitateve (92/43/EEC) ([5])

(xi) Direktiva e Parandalimit dhe e kontrollit të Ndotjes së Integruar (96/61/EC)

### Pjesa B

Lista e mëposhtme është një listë joekskluzive e masave shtesë të cilat shtetet anëtare brenda secilit distrikt të basenit ujor mund të zgjedhin që t'i miratojnë, si pjesë e programit të masave të kërkuara sipas Nenit 11(4):

(i) instrumentet legjislative
(ii) instrumentet adminsitrative
(iii) instrumentet ekonomike ose fiskale
(iv) marrëveshjet mjedisore të integruara
(v) kontrollet e daljeve
(vi) kodet e praktikave të mira
(vii) rikrijimi dhe ruajtja e zonave të tokave të lagura
(viii) kontrollet e nxjerrjes
(ix) masa për menaxhimin e kërkesës, *inter alia*, nxitja e prodhimit bujqësor si për shembull rritja e drithërave që nuk kërkojnë shumë ujë në zonat që preken nga thatësia

[1] OJ L 103, 25.04.1979, fq 1
[2] OJ L 10, 14.01.1997, fq 13
[3] OJ L 175, 05.07.1985, fq 6
[4] OJ L 181, 8.07.1986, fq 6
[5] OJ L 206, 22.07.1992, fq 7

(x) masa për efikasitet, *iner alia*, nxitja e teknologjive që e përdorin ujin me kursim në industri dhe teknikat ujitëse që kursejnë ujë
(xi) projektet e ndërtimit
(xii) impiantet e heqjes së kripës
(xiii) projekte rehabilitimi
(xiv) rimbushja artificiale e ujëmbajtësve
(xv) projektet edukativë
(xvi) projekte kërkimore, zhvillimi dhe demonstrimi
(xvii) masa të tjera të përkatëse

## SHTOJCA VII

## PLANET E MENAXHIMIT TË BASENEVE LUMORE

A. Planet e menaxhimit të basenit lumor duhet të mbulojnë elementët e mëposhtme:

1. Një përshkrim të përgjithshëm të karakteristikave të rrethit të basenit ujor të kërkuar në Nenin 5 dhe Shtojcën II. Këtu do të përfshihen:

1.1. për ujërat sipërfaqësore:
- skicimin e vendndodhjes dhe kufijve të zonave ujore,
- skicimin e ekorajoneve dhe tipeve të zonës së ujit sipërfaqësor brenda basenit të lumit,
- identifikim i kushteve të referencës për sipërfaqen e tipeve të zonave të ujërave sipërfaqësore

1.2. për ujrat nëntokësore

- skicimin e vendndodhjes dhe kufijve të zonave të ujit nëntokësor;

2. Një përmbledhje të presioneve dhe ndikimit të aktivitetit njerësor mbi statusin e ujt sipërfaqësor dhe ujit nëntokësor, duke përfshirë:

- vlerësimin e ndotjes së pikës burimore,
- vlerësimin e ndotjes së burimit të shpërndarë, duke përfshirë dhe një përmbledhje të përdorimit të tokës,
- vlerësimin e presioneve mbi statusin cilësor të ujit, duke përfshirë dhe nxjerrjen,
- analizimin e ndikimeve të tjera të aktivitetit njerësor mbi statusin e ujit,

3. Identifikimi i hartave të zonave të mbrojtura, ashtu siç kërkohet nga Neni 6 dhe Shtojca IV;

4. Një hartë të rrjeteve të monitorimit, të përcaktuara për qëllimet e Neneve 8 dhe Shtojcës V dhe një prezantim në formën e harte rezultatesh të monitorimit të programeve, të realizuara sipas atyre dispozitave për statusin e:

4.1. ujit sipërfaqësor (ekologjik dhe kimik);

4.2. ujit nëntokësor (kimik dhe cilësor);

4.3. zonat e mbrojtura;

5. Një listë e objektivave mjedisore të përcaktuara sipas Nenit 4 për ujin sipërfaqësor, ujërat nëntokësore dhe zonat e mbrojtura, duke përfshirë një identifikim të veçantë të rasteve kur është përdorur Neni 4(4), (5), (6), dhe (7), dhe informacioni shoqërues i kërkuar po nga ai Nen;

6. Një përmbledhje të analizës ekonomike të pëdorimit të ujit, ashtu siç kërkohet nga Neni 5 dhe Shtojca III;

7. Një përmbledhje e programit ose programeve të masave të hartuara sipas Nenit 11, duke përfshirë dhe mënyrat në të cilat objektivat e vendosura në nenin 4, do të realizohen;

7.1. një përmbledhje e masave të ndërmarra për të plotësuar kërkesat e Nenit 7;

7.2. një raport i hapave praktike dhe masave të marra për të aplikuar parimin e mbulimit të kostove të përdorimit të ujit në përputhje me Nenin 9;

7.3. një përmbledhje e masave të marra për të plotësuar kërkesat e Nenit 7;

7.4. një përmbledhje e kontrolleve për nxjerrjen dhe pompimin e ujit, duke përfshirë dhe referencën që u bëhet regjistrave dhe identifikimit të rasteve në të cilat janë bërë përjashtime sipas Nenit 11(3)(e);

7.5. një përmbledhje e kontrolleve të bëra për shkarkimet/derdhjet e burimit me një pikë dhe aktivitete të tjera që kanë ndikim mbi statusin e ujit, në përputhje me parashikimet e Nenit 11(3)(g) dhe 11(3)(i);

7.6. një identifikim të rasteve në të cilat shkarkimet direkte në ujin nëntokësor janë të autorizuara në përputhje me dispozitat e Nenit 11(3)(j);

7.7. një përmbledhje e masave të ndërmarra në përputhje me Nenin 16 për substancat përparësore;

7.8. një përmbledhje e masave të marra për të parandaluar ose ulur ndikimin e incidenteve aksidentale të ndotjes;

7.9. një përmbledhje e masave të marra sipas Nenit 11(5) për zonat e ujit, të cilat ka të ngjarë të mos arrijnë objektivat e Nenit 4;

7.10. detaje të masave të marra për të shmangur rritjen e ndotjes së ujit të marinës, në përputhje me Nenin 11(6);

7.11. detaje të masave të ndërmarra për të shmangur rritjen e ndotjes në ujërat e marinës, në përputhje me Nenin 11(6);

8. Një regjistër i programeve të tjera më të detajuara dhe i planeve të menaxhimit për rrethet e baseneve lumore që merren me nënbasene, sektorë, çështje ose tipe uji të veçanta, së bashku me një përmbledhje të përmbajtjeve të tyre;

9. Një përmbledhje e informacionit publik dhe e masave këshilluese të marra, rezultatet e tyre dhe ndryshimet e planit të bërë si rezultat;

10. Një listë e autoriteteve kompetente në përputhje me Shtojcën 1;

11. Pikat e kontaktit dhe procedurat për marrjen e dokumentacionit dhe informacionit të cilit i referohet Neni 14(1) dhe veçanërisht detajet të masave të kontrollit të miratuara në përputhje me Nenin 11(3)(g) dhe 11(3)(i) dhe të të dhënave aktuale të monitorimit të mbledhura në përputhje me Nenin 8 dhe Shtojcën V.

B. Përditësimi i parë si dhe përditësimet e tjera të planit të menaxhimit të basenit lumor duhet të përmbledhin gjithashtu dhe:

1. Një përmbledhje të të gjitha ndryshimeve ose përditësimeve që prej kohës së botimit të versionit të mëparshëm të planit të menaxhimit të basenit lumor, duke përfshirë dhe një përmbledhje të rishikimeve që do të realizohen sipas Nenit 4(4(, (5), (6) dhe (7);

2. Një vlerësim i progresit të bërë drejt arritjes së objektivave mjedisore, duke përfshirë prezantimin e rezultatit të monitorimeve për periudhën e planit të mëparshëm në formën e hartës dhe një shpjegim për çdo objektiv mjedisor që nuk është realizuar;

3. Një përmbledhje  dhe një shpjegim i masave të parashikuara në versionet e mëparshme të planit të menaxhimti të basenit ujor, të cilat nuk janë realizuar;

4. Një përmbledhje e masave shtesë të brendshme të miratuara sipas Nenit 11(5) që prej kohës së botimit të versionit të mëparshëm të planit të menaxhimit të basenit lumor.

## SHTOJCA VIII

## LISTA TREGUESE E NDOTËSVE KRYESORË

1. Përbërës dhe substanca organohalogene të cilat mund të formojnë përbërës të tillë në mjedisin ujor

2. Përbërësit organofosforike

3. Përbërësit organotine

4. Substanca dhe preparate ose nënprodukte të tilla të cilat kanë dëshmuar se përmbajnë cilësi karkinogjenike dhe mutagjenike ose kanë cilësi të cilat mund të ndikojnë funksione steriodogjenike, tiroide, të riprodhimit ose funksione të tjera të lidhura me endokrinën në ose nëpërmjet mjedisit ujor;

5. Hidrokarbure persistente; substancan toksike persistente organike biokumulative;

6. Cianide

7. Metake dhe përbërësit e tyre

8. Arsenik dhe përbërësit e tij

9. Biocide dhe produkte për mbrojtjen e bimëve

10. Materiale në suspension

11. Substanca që kontribuojnë për eutrofikimin (nitratet dhe sulfatet në veçanti)

12. Substancat që kanë një ndikim jo të favorshëm në balancën e oksigjenit (dhe që mund të përdoren në parametra të tillë si BOD, COD, etj.)

## SHTOJCA IX

### Vlerat limite të daljes dhe standardet e cilësisë së mjedisit

“Vlerat limite” dhe “objektivat e cilësisë, të përcaktuara sipas Direktivave të Direktivës 76/464/EEC, do të konsiderohen vlera limite daljeje dhe standarde të cilësisë mjedisore për qëllimet e kësaj Direktive. Ato përcaktohen në këto Direktiva:

(i) Direktiva e Shkarkimit të Mërkurit (82/176/EEC) ([1])
(ii) Direktiva e Shkarkimit të Kadmiumit (83/513/EEC)([2])
(iii) Direktiva e Mërkurit (84/156/EEC) ([3])
(iv) Direktiva e Shkarkimeve Heksaklorocikloheksane (84/491/EEC) ([4])
(v) Direktiva e Shkarkimit të Substancave të Dëmshme *86/280/EEC) ([5])

---

[1] OJ L 81, 27.03.1982, fq 29
[2] OJ L 291, 24.10.1983, fq 1
[3] OJ L 74, 17.03.1984, fq 49
[4] OJ L 274, 17.10.1984, fq 11
[5] OJ L 181, 4.07.1986, fq 16

## SHTOJCA X

Substancat parësore

## SHTOJCA XI

## HARTA A

### Sistemi A: Ekorajonet për liqenet dhe lumenjtë

1. Rajoni Iberik-Makaronezian
2. Pirenes
3. Itali, Korsika, Malta
4. Alpet
5. Ballkani perëndimor
6. Ballkani perëndimor helenik
7. Ballkani lindor
8. Malësia perëndimore
9. Malësia qendrore
10. Carpathains
11. Ultësira hungareze
12. Provinca pontike
13. Pllajat perëndimore
14. Pllajat qendrore
15. Provinca balltike
16. Pllaja lindore
17. Irlanda dhe Irlanda e Veriut
18. Britania e Madhe
19. Icelandi
20. Pllaja Borelike
21. Mburoja feno-skandinave
22. Taiga
23. Kaukazet
24. Depresioni Kaspik

# SHTOJCA XI

## HARTA A

### Sistemi A: Ekorajonet për Ujërat Tranzicionale dhe Ujërat Bregdetare

1. Oqeani Atlantik
2. Deti Norvegjez
3. Deti Barents
4. Deti i Veriut
5. Deti Balltik
6. Deti i Mesdheut